BULETINI EKONOMIK

qershor 2005

Banka e Shqipërisë

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

www.bankofalbania.org

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
E-mail: public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 640 kopje

P Ë R M B A J T J A

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, qershor 2005 7
I. Fjala e guvernatorit 7
II. Aktiviteti ekonomik 9
III. Ecuria e inflacionit 14
IV. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare 19

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2005, qershor 2005 30
I. Llogaria korente 30
II. Llogaria kapitale dhe financiare 33

Përshëndetje e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 35
Seminar "Testimi i sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut". Tiranë, 5 prill 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 39
Takim me anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Tiranë, 6 prill 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 44
Hapja, zgjerimi dhe modernizimi i tregut primar dhe sekondar të bonove të thesarit Tiranë, 8 prill 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 46
Forumi Ndërballkanik i Shoqatave të Bankave. Durrës, 20 maj 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 52
Takimi Vjetor 2005 dhe Forumi i Biznesit të BERZH-it. Beograd, 22 maj 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 55
Ditën e Biznesit të vendeve të Rajonit të Detit të Zi në Erevan, Armeni. 6 qershor 2005

Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani 63
Seminar "Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave", Tiranë, 22 qershor 2003

Fjala e Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, z. Limos Malaj 68
Seminar "Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave", Tiranë, 21 qershor 2003

Vlerësimi i standardeve të shpërndarjes së statistikave në Bankën e Shqipërisë 70

Banka e Shqipërisë dhe angazhimi i saj në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit 87

Indeksi i Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran: A ka ardhur koha që Shqipëria ta sigurojë atë? 93

Banka e Shqipërisë në harkun kohor prill-qershor 2005 99

Ngjarjet juridike, prill-qershor 2005 103

Drejtimi i Bankës së Shqipërisë, 30 qershor 2005 109

Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë 110

Banka dhe degë të bankave të huaja 110

Subjekte jobanka 113

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"" 115

Zyra të këmbimeve valutore 116

Unionet e shoqërive të kursim-kreditit 122

Zyra të përfaqësimit të bankave të huaja 122

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, Qershor 2005

Tabelë 1. Të dhëna mbi ekonomitë e disa vendeve për vitin 2004 dhe parashikimi për vitin 2005 9
Tabelë 2. Vlerësimi i prodhimit bujqësor gjatë vitit 2004 dhe parashikimi për vitin 2005 12
Tabelë 3. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje) 14
Tabelë 4. Inflacioni vjetor dhe kontributi në inflacion i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" 16
Tabelë 5. Inflacioni vjetor dhe ai mujor i marsit dhe kontributi në inflacion i grupeve kryesore 17
Tabelë 6. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje) 18
Tabelë 7. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë 20
Tabelë 8. Ecuria e treguesve monetarë në muajin nëntor (në miliardë lekë) 23
Tabelë 9. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje) 25
Tabelë 10. Ecuria e disa treguesve kryesorë 25
Tabelë 11. Ecuria e tepricës së kredisë sipas degëve kryesore të ekonomisë 26
Tabelë 12. Tregues të kredisë së re ndaj totalit (në përqindje) 26
Tabelë 13. Niveli i interesave në tregje në fund të çdo tremujori (në përqindje) 27

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2005 qershor 2005

Tabelë 1. Bilanci i pagesave (në milionë dollarë amerikanë) 34

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, Qershor 2005

Grafik 1. Ecuria e çmimit të naftës së papërpunuar për fuçi në dollarë amerikanë 11

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit usd/euro 11

Grafik 3. Bilanci i Energjisë Elektrike (në GWh) 13

Grafik 4. Rritja vjetore e të ardhurave dhe e shpenzimeve buxhetore (të dhëna kumulative) 14

Grafik 5. Inflacioni vjetor (në përqindje) 15

Grafik 6. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje) 15

Grafik 7. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje) 16

Grafik 8. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje) 18

Grafik 9. Ndryshimet vjetore të IÇP_së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004 19

Grafik 10. Ecuria e normës bazë të interesit 20

Grafik 11. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë 21

Grafik 12. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real (shkalla djathtas) 21

Grafik 13. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3 22

Grafik 14. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3 23

Grafik 15. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar 24

Grafik 16. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë) 24

Grafik 17. Ecuria e kredisë në lekë të individëve (në milionë lekë) dhe rritja vjetore e kredisë (në përqindje) 25

Grafik 18. Niveli i likuiditetit në sistemin bankar (në milionë lekë) 26

Grafik 19. Ecuria e normave të interesit (në përqindje) 27

Grafik 20. Interesat e depozitave 12-mujore në lekë dhe inflacioni në bazë vjetore 28

Grafik 21. Ecuria e interesave mesatarë të ponderuar të depozitave në valutë 28

Grafik 22. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut 29

OPINION MBI GJENDJEN E EKONOMISË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2005

QERSHOR 2005

I. FJALA E GUVERNATORIT

Muajt e parë të vitit 2005, edhe pse në kushtet e të dhënave jo të plota, duket se kanë ruajtur ritmet e verifikuara kohët e fundit. Tremujori i parë i vitit 2005 vlerësohet se ka mbajtuar të pandryshuara raportet kryesore makroekonomike të pranishme në tremujorët e fundit. Kjo na jep mundësinë për të gjykuar se ekonomia shqiptare, për pjesën tjetër të vitit 2005, pritet të vazhdojë konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, në përputhje me objektivat e përcaktuar në programin afatmesëm të zhvillimit të vendit 2005 – 2007.

Më konkretisht, gjatë vitit synohet një rritje ekonomike e qëndrueshme rreth nivelit 6 për qind, një normë vjetore e inflacionit brenda intervalit 2 – 4 për qind, një nivel i mjaftueshëm rezervash valutore dhe një ngushtim i mëtejshëm i deficitit të llogarisë korente. Rritja ekonomike për vitin 2005 pritet të mbështetet kryesisht nga rritja në sektorin e shërbimeve, të ndërtimit dhe më tej nga rritja në sektorët e transportit, të bujqësisë dhe të industrisë.

Të ardhurat buxhetore gjatë vitit 2005 pritet të shënojnë një rritje vjetore prej rreth 12 për qind në krahasim me vitin 2004, duke ruajtur të njëjtin nivel relativ ndaj PBB-së (22.5 për qind). Nga ana tjetër, në kryerjen e shpenzimeve publike synohet rritja e eficiencës dhe financimi më i mirë i sektorëve dhe i programeve prioritare. Vazhdimi i reformave në administratën tatimore dhe doganore, si pjesë e reformave strukturore të vendit, i shoqëruar me përpjekjet për të kufizuar shtrirjen e ekonomisë joformale do të rrisë nivelin e të ardhurave buxhetore dhe do të krijojë mundësi për rritjen e shpenzimeve sidomos në sektorët kryesorë të ekonomisë.

Objektivi strategjik afatmesëm i politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë është mbajtja e normës së inflacionit në nivele të ulëta pozitive. Normat e ulëta pozitive të inflacionit sigurojnë qëndrueshmëri në tregje dhe mbështesin rritjen ekonomike. Edhe për vitin 2005, objektivi për inflacionin, shprehet në ruajtjen e normës vjetore të rritjes së indeksit të çmimeve të konsumit, të matur dhe të publikuar nga INSTAT, brenda intervalit 2-4 për qind. Duke u nisur nga parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2005, nga objektivi i Bankës së Shqipërisë për normën e inflacionit, si dhe nga tendencat e zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë do të synojë të kontrollojë rritjen e ofertës monetare në nivelin 9.8 për qind për vitin 2005. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë një regjim luhatës të kursit të këmbimit. Zhvillimet makroekonomike dhe ecuria e normës së inflacionit kanë mbështetur zbutjen e mëtejshme të politikës monetare pas uljes së normës bazë në fund të vitit 2004. Presionet nga ana e kërkesës kanë patur tendenca zbehjeje, duke balancuar pothuajse plotësisht efektet e rritjes së çmimeve të naftës në tregjet

ndërkombëtare dhe të çmimeve të administruara në vend. Zbutja e presioneve inflacioniste është reflektuar në norma inflacioni të ulëta në muajt e parë të vitit. Gjithashtu, parashikimet për inflacionin në muajt e ardhshëm tregojnë se presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta në gjysmën e parë të vitit. Në këto kushte, në fund të muajit mars, Banka e Shqipërisë, uli me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin më të ulët historik prej 5 për qind. Sistemi bankar e ka reflektuar këtë ulje në uljen e normave të interesit të depozitave, të bonove të thesarit në lekë dhe, në një masë më të vogël, në rënien e normave të interesit të kredisë në lekë.

Zhvillimet e deritanishme në çmimet e konsumit kanë treguar se niveli i përgjithshëm i çmimeve gjatë vitit 2004 dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 është kushtëzuar në mënyrë të ndjeshme nga ecuria e çmimeve të mallrave ushqimorë, nga rritja e çmimit të administruar të energjisë elektrike si edhe nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Çmimet në rënie të produkteve ushqimore, të shkaktuara nga rritja e ofertës së prodhimit bujqësor, kanë ushtruar presione në rënie mbi normën vjetore të inflacionit që nga muaji maj i vitit 2004. Rënia në bazë vjetore e çmimeve të këtyre produkteve është regjistruar edhe në tremujorin e parë të vitit 2005, gjë që nuk është karakteristike për këtë periudhë të vitit. Rritja në muajin janar e çmimit të energjisë elektrike, bëri që të rritej inflacioni i grupit përkatës si edhe inflacioni vjetor total i këtij muaji. Deri në momentin e shuarjes së efektit të rritjes së çmimit, pra deri në janar të vitit 2006, pritet që kontributi i rritjes së çmimit të energjisë të mbetet në nivelin 2.4-2.5 pikë përqindjeje. Nga ana tjetër, rritja e çmimit të naftës nuk ka shkaktuar rritje të ndjeshme të inflacionit për shkak të peshës së vogël të grupit "transport" në shportën e konsumit dhe të efektit pozitiv të forcimit të lekut kundrejt dollarit amerikan. Gjatë vitit 2005, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të synojë të nxisë aktivitetin ekonomik nëpërmjet mbështetjes së investimeve nga ana e sektorit privat, pa cënuar përmbushjen e objektivit të inflacionit dhe stabilitetin financiar të sistemit në të ardhmen.

Gjatë vitit 2005, politikat makroekonomike do të fokusohen edhe në zhvillimet në sektorin e jashtëm dhe sidomos në ecurinë e deficitit të llogarisë korente, i cili për vitin 2004 qëndronte në nivelin 5.3 për qind të PBB-së. Deficiti korent ndaj PBB-së ka ardhur në rënie gjatë tre viteve të fundit. Arritja e objektivit për ngushtimin e deficitit korent gjatë vitit 2005, mund të vështirësohet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit, ndërkohë që pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave do të vazhdojë të jetë i lidhur ngushtë me financimin nëpërmjet të ardhurave nga privatizimi. Një sinjal pozitiv i marrë nga viti 2004 ishte qëndrueshmëria relative e importeve, megjithë forcimin e lekut ndaj euros dhe dollarit amerikan përgjatë pjesës më të madhe të vitit. Nga ana tjetër, eksportet shqiptare janë rritur me ritme më të shpejta se importet, duke treguar rritje të lehtë kompetitiviteti në tregun evropian. Viti 2005 ka filluar me një pozicion të shëndoshë të rezervave valutore, të cilat mbulojnë 5.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh diçka më shumë se objektivi ynë për fundin e vitit.

Në tërësi, viti 2005 parashikohet të jetë një tjetër vit zhvillimi për ekonominë shqiptare. Rritja e të ardhurave tatimore dhe rritja e kreditimit të ekonomisë

gjatë tremujorit të parë të vitit tregojnë për një ecuri pozitive të aktivitetit ekonomik. Stabiliteti i treguesve monetarë, kushtet e favorshme financiare në ekonomi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i sistemit bankar do të nxitin më tej këtë aktivitet gjatë vitit 2005, duke bërë të mundur shfrytëzimin më të plotë të potencialit financiar të ekonomisë shqiptare. Banka e Shqipërisë gjykon se është momenti i duhur për autoritetet politike të kapitalizojnë mbi këtë moment, duke ruajtur ritmin e reformave strukturore dhe duke hartuar politika e strategji konkrete zhvillimi. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ketë në fokusin e saj hartimin dhe ndjekjen e politikave monetare të përshtatshme për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në vend si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e sistemit financiar sipas standardeve më të përparuara.

II. AKTIVITETI EKONOMIK

II.1 EKONOMIA BOTËRORE GJATË TREMUJORIT TË PARË 2005

Viti 2005 pritet të karakterizohet nga zhvillime pozitive dhe deri-diku të përafërta me ato të vitit 2004. Politikat mbështetëse, forcimi i gjendjes financiare të korporatave dhe kushtet lehtësuese të financimit do të ndikojnë pozitivisht në ritmin e rritjes ekonomike. Megjithë zhvillimet përgjithësisht pozitive, rritja ekonomike globale po bëhet gjithnjë e më pak e balancuar. Rritja e ekonomisë botërore vazhdon të mbështetet nga rritja në Shtetet e Bashkuara dhe në Kinë, ndërkohë që aktiviteti ekonomik në Eurozonë dhe në Japoni vazhdon të jetë i ngadaltë dhe larg niveleve të pritura.

	PBB		Norma e papunësisë		IÇK		Deficiti buxhetor (% pbb-së)	
	2004	2005*	2004	2005*	2004	2005*	2004	2005*
USA	4.4	3.6	5.5	5.3	2.7	2.7	-4.3	-4.4
Eurozona	2.0	1.6	8.8	8.7	2.2	1.9	-2.7	-2.6
Franca	2.3	2.0	9.7	9.5	2.3	2.0	-3.7	-3.1
Gjermania	1.7	0.8	9.2	9.4	1.8	1.5	-3.7	-3.5
Italia	1.2	1.2	8.3	8.0	2.3	1.8	-3.0	-3.5
Britania e Madhe	3.1	2.6	4.8	4.7	1.3	1.7	-3.0	-3.1
Japonia	2.6	0.8	4.7	4.5	-	-0.2	-7.1	-6.9
Kina	9.5	8.5	-	-	3.9	3.0	-	-

*Parashikime të Fondit Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook, prill 2005.

Tabelë 1. Të dhëna mbi ekonomitë e disa vendeve për vitin 2004 dhe parashikimi për vitin 2005.

Të dhënat për fillimvitin 2005 tregojnë se ekonomia amerikane do të vazhdojë të shënojë zhvillime pozitive gjatë këtij viti, pavarësisht se ritmi i rritjes pritet të jetë më i ulët sesa ai i vitit 2004[1]. Rritja reale e prodhimit të brendshëm bruto pritet të luhatet rreth vlerave 3.5-4.0 për qind duke qenë më modeste sesa rritja e regjistruar gjatë vitit 2004[2]. Indeksi i çmimeve të mallrave të konsumit personal, duke përjashtuar ushqimin dhe energjinë, parashikohet të jetë rreth 1.5-1.75 për qind më i lartë se një vit më parë. Tregu i punës pritet të shfaqë përmirësime përgjatë vitit 2005. Zhvillime modeste për fillimvitin 2005 janë vënë re në normën e rritjes së prodhimit industrial, në shpenzimet

[1] *Për ekonominë amerikane vlerësimet janë bërë nga stafi i Federal Reserve, shkurt 2005.*
[2] *Norma e rritjes së PBB-së për vitin 2004 ishte 4.4 për qind.*

për konsum dhe në deficitin tregtar, i cili, në muajin janar ishte rreth 5 për qind më i lartë sesa në muajin dhjetor të vitit 2004.

Politika monetare e SHBA ka ardhur duke u shtrënguar gjatë muajve të parë të vitit 2005. FOMC-ja ka rritur në të trija mbledhjet e këtij viti normën bazë të interesit me nga 25 pikë përqindjeje, duke e çuar në nivelin 3.0 për qind. Në projektbuxhetin për vitin fiskal 2006 u ritheksua objektivi i përgjysmimit të deficitit fiskal në vitin 2009. Supozimi bazë mbi të cilin u mbështet reduktimi i deficitit është ndërprerja e shpenzimeve të mëtejshme të mbrojtjes për veprimet luftarake në Irak dhe Afganistan.

Rritja ekonomike e Eurozonës gjatë vitit 2004 ka qenë modeste. Parashikimet për vitin 2005, e vendosin rritjen ekonomike në intervalin 1.2-2.0 për qind ose diçka më pak sesa rritja e vitit 2004[3]. Norma mesatare e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICP) parashikohet të luhatet midis kufijve 1.6 – 2.2 për qind. Rritja e eksporteve, bazuar në forcimin e kërkesës së jashtme, do të vazhdojë të jetë baza e zhvillimit ekonomik. Gjatë këtij viti pritet një forcim gradual i kërkesës së brendshme dhe i tregut të punës. Të dhënat e fundit dhe anketimet e ndryshme të aktivitetit ekonomik për Eurozonën, tregojnë se aktiviteti ekonomik ka shënuar një rritje modeste gjatë muajve të parë të vitit 2005. Indekset e besimit japin sinjale të ndryshme. Indeksi industrial dhe indeksi i sektorit të shërbimeve kanë shënuar ulje gjatë muajve të parë të vitit, ndërkohë që indeksi i besimit konsumator ka mbetur i pandryshuar.

Normat e ulëta të interesit, të përcaktuara kryesisht nga norma bazë e interesit e cila ka qëndruar në nivelin 2 për qind që nga muaji qershor i vitit 2003, kanë nxitur ekspansionin monetar në Eurozonë. Megjithatë, të dhënat e fundit monetare dhe ato të kredisë, tregojnë një ngadalësim të këtij ekspansioni gjatë muajve të parë të vitit 2005. Situata fiskale vazhdon të jetë shqetësuese. Perspektiva fiskale për disa vende të Eurozonës është përkeqësuar, pasi deficitet fiskale jo vetëm nuk janë projektuar që të ulen, por në disa vende parashikohet një rritje e mëtejshme.

Çmimi i naftës ka vazhduar të rritet në muajt e parë të vitit 2005, duke kaluar edhe pikun që arriti në muajin tetor të vitit të kaluar. Në muajin mars 2005, një fuçi naftë e papërpunuar[4] kushtoi mbi 57 dollarë. Efektet e rritjes së deritanishme të çmimit të naftës, mbi rritjen globale dhe mbi inflacionin, kanë qenë të administrueshme, pjesërisht për shkak të rritjes së fortë të kërkesës botërore, dhe pjesërisht për shkak të përmirësimit të besueshmërisë së bankave qendrore në politikat e tyre antiinflacioniste.

Në muajin mars, Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës vendosi që të rrisë prodhimin me 500,000 fuçi në ditë dhe marrëveshja hyri në fuqi menjëherë. Konsumi botëror i naftës pritet që të rritet në 86.1 milionë fuçi në ditë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005, periudhë gjatë së cilës regjistrohet edhe piku i kërkesës[5].

[3] *Për ekonominë e Eurozonës vlerësimet janë bërë nga stafi i Bankës Qendrore Evropiane.*
[4] *US light crude.*
[5] *Parashikim i International Energy Agency.*

Tregjet e kurseve të këmbimit kanë shënuar luhatje gjatë muajve të parë të vitit. Euro dhe dollari amerikan janë zhvlerësuar dhe rivlerësuar gjatë muajve të fundit duke reflektuar sinjalet që kanë ardhur nga ekonomitë përkatëse. Dollari amerikan është vlerësuar kundrejt euros gjatë muajit mars dhe gjatë fillimit të muajit prill, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të ndryshimit midis normave të interesit në Eurozonë dhe në Shtetet e Bashkuara. Por, sinjalet që erdhën nga ekonomia amerikane gjatë gjysmës së parë muajit prill për një ngadalësim të mundshëm të aktivitetit ekonomik, ndikuan në uljen e *yield*-it të tregut të aksioneve dhe të borxhit afatgjatë. Kjo ulje mendohet se ka ndikuar negativisht, të paktën përkohësisht, në ecurinë e dollarit. Në gjysmën e dytë të muajit prill dollari i rifitoi pikët e humbura pasi edhe parashikimet për rritjen ekonomike në Eurozonë u rivlerësuarn si më të ulëta se sa ishin menduar fillimisht. Në fillim të muajit maj 1 euro është këmbyer me 1.28 dollarë amerikanë, rreth 4 për qind më pak se vlera e euros në fillim të vitit 2005.

Grafik 1. Ecuria e çmimit të naftës së papërpunuar për fuçi në dollarë amerikanë.



*Burimi: Bloomberg.com

Grafik 2. Ecuria e kursit të këmbimit USD/EURO.



*Burimi: Banka Qendrore Evropiane, maj 2005.

II.2 EKONOMIA SHQIPTARE GJATË TREMUJORIT TË PARË 2005

II.2.1 Sektori real

II.2.1.1 Dega e bujqësisë

Dega e bujqësisë është rritur me 4.4 për qind gjatë vitit 2004. Kjo rritje ishte më e lartë se parashikimi i fillimvitit dhe më e lartë se rritja e tre viteve të mëparshme. Viti 2005 pritet të shënojë një rritje akoma më të lartë (4.7 për qind) duke iu afruar normës së rritjes së vitit 1998. Ndikimin më të madh në këtë rritje pritet ta japë përsëri sektori i agroindustrisë, i cili vlerësohet të jetë rritur me 10.2 për qind gjatë vitit 2004. Konkretisht për vitin 2005, parashikohet që sektori i bujqësisë të rritet me 3.1 për qind, sektori i agroindustrisë me 12 për qind dhe sektori i peshkimit me 10 për qind. Kjo rritje do të mbështetet në politika të ndryshme nxitëse. Ndihma nëpërmjet uljes së çmimit të karburantit që përdoret në bujqësi do të ndikojë në uljen e kostos së punimeve bujqësore, në rritjen e shkallës së mekanizimit dhe në rritjen e interesit të fermerëve për prodhimin bujqësor. Po ashtu, rritja e madhësisë së parcelave, përmirësimi i cilësisë së farës dhe interesi në rritje i fermerëve për të pasr një normë më të lartë fitimi, duke zbatuar teknologji përherë e më të përparuara, mbështet pritjet për një prodhim bujqësor në rritje. Bazuar në këto parashikime, pritet që gjatë vitit 2005 të rritet prania e prodhimit bujqësor vendas në treg, gjë që do të ushtrojë presion rënës në nivelin e çmimeve të produkteve bujqësore.

Tabelë 2. Vlerësimi i prodhimit bujqësor gjatë vitit 2004 dhe parashikimi për vitin 2005.

	Rritja 2004 (%)	Rritja 2005 (%)	Pesha (%)
Bujqësia	3.2	3.1	81.6
Bimët	3.3	2.5	44.2
Blegoria	3.1	3.8	37.4
Agroindustria	10.2	12.0	17.3
Peshkimi	7.9	10.0	1.1
Total	4.4	4.7	100.0

*Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, vlerësimet e deritanishme tregojnë se fermerët janë orientuar drejt kultivimit të perimeve, kryesisht atyre në serra, të drufrutorëve dhe në prodhimin blegtoral, ndërkohë që interesi për prodhimin e drithërave ka një tendencë në rënie. Kushtet e këqija të motit dhe temperaturat e ulëta edhe gjatë pranverës, kanë shtyrë në kohë mbjelljen e bimëve pranverore, proces i cili po vazhdon edhe gjatë muajit maj. Sidoqoftë, mendohet se shtyrja e kohës së mbjelljeve nuk do të ndikojë në nivelin e prodhimit për vitin 2005, pasi ritmet e mbjelljes janë të shpejta.

Rritja e prodhimit bujqësor gjatë vitit 2004, u bazua kryesisht në rritjen e prodhimit të frutave, në dyfishimin e prodhimit të ullirit dhe në rritjen e prodhimit blegtoral. Rritja me 3.1 për qind e prodhimit në sektorin e blegtorisë erdhi si pasojë e rritjes së madhe në prodhimin e vezëve dhe të qumështit, gjë që ka mundësuar përmbushjen e nevojave të tregut me këto produkte. Rritja e rendimentit mbetet faktori kryesor që ka ndikuar rritjen e prodhimit blegtoral.

Investimet për vitin 2004 u mbështetën në masën 36 për qind nga investimet e huaja, 23 për qind nga buxheti i shtetit dhe 41 për qind nga vetë fermerët. Fermerët kanë përdorur fondet e tyre në masën 90 për qind, ndërkohë që 10 për qind e këtyre investimeve janë financuar nëpërmjet kredive bankare. Financimi nga ana e bankave, ka zënë një vend të konsiderueshëm në investimet e bëra në sektorin e agroindustrisë. Gjatë vitit 2004, për herë të parë u vlerësua se masa që zë përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale nga vetë fermerët është 75 për qind e prodhimit të industrisë përpunuese.

II.2.1.2 Energjitika

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 vendi është furnizuar me rreth 25 për qind më tepër energji elektrike sesa gjatë tremujorit të katërt të vitit të kaluar, ndërkohë që në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2004, sasia e furnizuar ka qenë rreth 7.4 për qind më e madhe. Prodhimi në vend i energjisë elektrike shënoi rritje me rreth 6 për qind në krahasim me prodhimin e tremujorit të parë të vitit 2004. Hidrocentralet mbeten prodhuesit më të mëdhenj në vend duke mbuluar rreth 99 për qind të prodhimit gjithsej. Importet gjatë këtij tremujori shënuan një rritje prej rreth 14 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit 2004, ndërkohë që eksportet e energjisë elektrike kanë qenë në një nivel mjaft të lartë, duke përfaqësuar rreth 17 për qind të prodhimit gjithsej. Raporti i humbjeve në rrjet ndaj sasisë së energjisë së përdorur ka qenë më i ulët sesa në tremujorin e parë të vitit 2004.

II.2.1.3 Transporti

Investimet në sektorin e transportit, gjatë tremujorit të parë të këtij viti, kanë kapur shifrën 2 miliardë lekë dhe kanë shënuar një rënie prej rreth 10 për qind në krahasim me investimet e bëra në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Rënia ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies së investimeve të brendshme me rreth 26 për qind, ndërkohë që investimet e huaja janë rritur me 24 për qind duke u afruar në nivelin e investimeve të brendshme.

Grafik 3. Bilanci i Energjisë Elektrike (në GWh).



Si transporti ajror, ashtu edhe ai detar kanë shënuar rritje të treguesve të aktivitetit gjatë tremujorit të parë të vitit. Në këtë periudhë, numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar transportin ajror është rritur me 15 për qind ndërkohë që numri i fluturimeve është rritur me 23 për qind. Transporti detar ka shënuar një rritje prej rreth 5 për qind gjatë këtij tremujori. Sipas regjistrimeve në portet kryesore të vendit, vëllimi i importeve është rritur me 4 për qind dhe ai i eksporteve me 12 për qind. Vëllimi i transportit të mallrave në Portin e Durrësit, i cili është porti kryesor në vend dhe përpunon rreth 77 për qind të vëllimit të përgjithshëm të mallrave në porte, ka rënë me 3 për qind. Nga ana tjetër, transporti në portet e Vlorës, të Sarandës dhe të Shëngjinit është rritur me përkatësisht 41, 79 dhe 41 për qind. Transporti hekurudhor ka shënuar rënie të lehtë në drejtim të transportit të mallrave dhe një rënie më të theksuar në numrin e pasagjerëve të transportuar.

II.2.2 Sektori fiskal

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 buxheti i shtetit ka arkëtuar 45.4 miliardë lekë, rreth 1.2 për qind më shumë se plani i tremujorit, ndërkohë që edhe shpenzimet janë realizuar në masë të lartë rreth 98.4 për qind të planit ose 46.8 miliardë lekë në terma absolutë. Në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet në terma absolutë nominalë kanë njohur rritje.

Të ardhurat tatimore, të cilat sigurojnë rreth 90 për qind të të ardhurave të përgjithshme, kanë shënuar një rritje prej 9 për qind në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2004, gjatë tremujorit të parë të këtij viti, janë siguruar më shumë të ardhura nga kategoritë më të mëdha të taksave si: taksa mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi fitimin dhe akciza. Të ardhurat nga buxheti i pavarur, kryesisht falë rritjes së të ardhurave nga sigurimet shoqërore, ishin rreth 12 për qind më të larta sesa ato të tremujorit të parë të vitit 2004, ndërkohë që niveli i të ardhurave jotatimore dhe i atyre nga pushteti lokal nuk kanë shënuar ndryshime të ndjeshme.



Shpenzimet e përgjithshme, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, ishin rreth 8 për qind më të larta sesa shpenzimet e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në terma vjetorë, shpenzimet korente dhe ato kapitale kanë shënuar ritme të njëjta rritjeje. Në kategorinë e shpenzimeve korente zërat kryesorë që kanë shënuar rritje vjetore gjatë tremujorit të parë janë: shpenzimet e personelit (12 për qind), shpenzimet operative (10 për qind) dhe shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (12 për qind).

Shpenzimet kapitale në total, ato me financim të huaj dhe ato me financim të brendshëm, kanë arritur shifrën rreth 5 miliardë lekë ose rreth 3 herë më shumë sesa në tremujorin e parë të vitit 2004.

Financimi i deficitit gjatë tremujorit të parë është përballuar kryesisht me burime të huaja afatgjata. Rritja e shpenzimeve për personelin në formën e pagave dhe të pagesave për sigurimet shoqërore si pasojë e rritjes së pagës minimale, e pensionit minimal, e pagesës së papunësisë etj., gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004, nuk duket të ketë shkaktuar presione inflacioniste gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004 dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2005.

III. ECURIA E INFLACIONIT

Në tremujorin e parë të vitit 2005, norma vjetore e ndryshimit të çmimeve të konsumit u luhat rreth kufirit të poshtëm të intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë. Pasi shënoi një normë rritjeje prej 3.3 për qind në muajin janar, inflacioni vjetor në muajt në vazhdim zbriti nën nivelin 2 për qind. Inflacioni vjetor në muajin mars arriti normën 1.6 për qind, ndërsa norma vjetore mesatare e inflacionit për tremujorin e parë rezultoi 2.5 për qind.

Tabelë 3. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.5

*Burimi: INSTAT.

Normat e ulëta vjetore të inflacionit kanë nisur të vihen re që nga mesi i vitit të kaluar. Rënia e çmimeve të produkteve ushqimore e kombinuar me zbutjen e presioneve inflacioniste nga ana e çmimeve të administruara, bënë që normat vjetore të inflacionit për këtë periudhë të ishin më të ulëta sesa ato të regjistruara vjet në të njëjtën kohë. Qëndrueshmëria e normës së inflacionit është nxitur nga një politikë fiskale e kujdesshme, ndërkohë që uljet e herëpashershme të normës bazë të interesit, janë ndërmarrë në masën dhe në momentet e përshtatshme duke mos rrezikuar objektivin e inflacionit. Ritmet e ulëta të rritjes së normës së inflacionit në vend, shpjegohen pjesërisht edhe nga zhvillimet e favorshme në tregun valutor. Mbiçmimi i vazhdueshëm i monedhës vendase, lekut, ka ndihmuar thithjen e presioneve inflacioniste nga ana e çmimeve të importit.

III.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, faktorët që kanë ushtruar presion mbi nivelin e çmimeve të konsumit kanë qenë të ngjashëm, në natyrë dhe në madhësi, me ata që kanë vepruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ashtu si edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2004, norma vjetore e inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2005, është përcaktuar ndjeshëm nga kontributi i grupeve "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji", "Ushqime dhe pije joalkolike" dhe "Komunikim" (grafiku 6). Në ndryshim nga vjet, dy grupet e fundit kanë shënuar norma vjetore negative duke ushtruar presion në rënie ndaj nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Grafik 5. Inflacioni vjetor (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Prej mëse dhjetë muajsh (maj '04 – mars '05), me përjashtim të muajit dhjetor 2004, grupi "Ushqime dhe pije joalkolike" ka regjistruar norma negative të inflacionit vjetor. Çmimet më të ulëta të mallrave ushqimorë kanë ardhur si rrjedhojë e situatës së mirë në tregun bujqësor. Viti 2004 ka qenë një vit veçanërisht i mirë për prodhimin bujqësor, i cili u vlerësua të jetë rritur me rreth 4.4 për qind në krahasim me prodhimin e vitit 2003. Prodhimi i bollshëm vendas, rënia e çmimeve të produkteve ushqimore në vendet partnere, si edhe zhvillimet e favorshme në kursin e këmbimit, kanë bërë që çmimet e produkteve ushqimore, kryesisht bujqësore, të konsumuara në vend, të shënojnë rënie të theksuar gjatë kësaj periudhe. Gjatë periudhës janar – mars 2005, grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" ka ndikuar mesatarisht në normën vjetore të inflacionit me – 0. 5 pikë

Grafik 6. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

përqindjeje, ndërkohë që kontributi i po këtij grupi, gjatë tremujorit të parë të vitit 2004, ka qenë mesatarisht 1.2 pikë përqindjeje. Në inflacionin vjetor dhe mujor të muajit mars 2005, ky grup kontribuoi përkatësisht me – 0.7 dhe -0.1 pikë përqindjeje.

Prej mëse një viti, grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" ka dhënë kontributin kryesor në formimin e normës vjetore të inflacionit. Rritja e tarifës së energjisë elektrike për konsumatorët familjarë në muajin janar, bëri që norma vjetore e inflacionit të kërcente në vlerën 3.3 për qind. Rritja e çmimit të energjisë elektrike bëri që kontributi i normës së inflacionit të këtij grupi në normën e përgjithshme të inflacionit të ishte i konsiderueshëm dhe më i lartë sesa kontributi i dhënë në tremujorin e parë të vitit 2004, gjatë të cilit, gjithashtu u shënua një rritje e çmimit të energjisë elektrike.

Tabelë 4. Inflacioni vjetor dhe kontributi në inflacion i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji".

Grupi	Inflacioni vjetor (%)		Kontributi në (pp)	
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	2004	2005	2004	2005
Janar	3.7	15.2	0.9	3.6
Shkurt	8.5	9.8	2.0	2.4
Mars	8.3	9.9	1.9	2.4

Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Që nga muaji maj i vitit 2004, deri në mars të këtij viti, presionet rritëse të ushtruara nga grupi "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" janë kundërbalancuar nga normat negative të inflacionit të grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" ndërkohë që, që nga muaji dhjetor'04 presion në rënie mbi normën vjetore ka ushtruar edhe grupi "Komunikim". Ky grup ka dhënë një kontribut të qëndrueshëm negativ prej – 0.5 pikë përqindjeje në inflacionin vjetor të periudhës dhjetor'04 – mars'05. Për muajt në vazhdim pritet që grupi "Komunikim" të japë një ndikim pozitiv, duke qenë se efekti i rritjes së tarifave (në muajin dhjetor'03) shuhet në muajin prill të këtij viti.

Grafik 7. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në përqindje).



Burimi: INSTAT.

Gjatë periudhës janar – mars'05, çmimet e grupeve të tjera të shportës së konsumit janë luhatur në mënyrë të moderuar, duke mos shkaktuar ndryshime në strukturën e inflacionit. Grupet "Veshje dhe këpucë", "Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje" kanë ndjekur trendin e tyre rënës, ndërsa grupet e tjera të shportës kanë shënuar norma të ulëta pozitive inflacioni.

Në inflacionin vjetor të muajit mars, këto grupe[6] kanë dhënë një kontribut prej 0.3 pikë përqindjeje. Në zhvillimet e këtij muaji, përveç grupeve të sipërpërmendura mund të veçohet grupi "Transport", i cili shënoi një inflacion

[6] *Grupet e shportës pa grupet "Ushqime dhe pije joalkolike", "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" dhe "Komunikim".*

vjetor prej 2.5 për qind. Brenda këtij grupi, rritjen më të madhe e regjistroi nëngrupi "Shërbime ndaj mjeteve personale"[7], me inflacion vjetor dhe mujor përkatësisht 7.3 dhe 1.6 për qind. Rritja e indeksit të çmimit të këtij grupi është shkaktuar nga rritja e çmimit të naftës.

	Inflacioni në (%)		Kontributi në (pp)	
	Mujor	Vjetor	Mujor	Vjetor
Ushqime dhe pije joalkolike	-0.2	-1.7	-0.08	-0.7
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji	0.0	9.9	0.00	2.4
Komunikim	0.0	-24.4	0.00	-0.5
Të tjera			0.04	0.3
Transport	0.8	2.5	0.04	0.1
Hotele, kafene dhe restorante	0.6	1.9	0.00	0.1
Totali	4.0	1.6	4.0	1.6

Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 5. Inflacioni vjetor dhe ai mujor i marsit dhe kontributi në inflacion i grupeve kryesore.

III.2 FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË ÇMIMET E KONSUMIT

Norma mesatare e inflacionit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, ka qenë 2.5 për qind. Muaji janar shënoi normën më të lartë vjetore (3.3 për qind) ndërkohë që dy muajt e tjerë u karakterizuan nga norma inflacioni më të ulëta se 2 për qind. Zhvillimet në faktorët e kërkesës dhe ofertës kanë ruajtur përgjithësisht karakteristikat e vitit të kaluar gjë që do të thotë që ky tremujor nuk u karakterizua nga ndryshime strukturore të rëndësishme.

III.2.1 Faktorët e kërkesës.

Faktorët e kërkesës, ashtu si dhe vitin e kaluar kanë mundësuar krijimin e një klime të favorshme për kontrollimin e normës së inflacionit, duke mos ushtruar presione inflacioniste.

Gjatë vitit 2004, politika fiskale ka ecur me hapa të matur, duke treguar kujdes në zbatimin e programit të saj fiskal. Treguesit fiskalë kanë respektuar nivelet e parashikuara dhe janë realizuar në mënyrë të njëtrajtshme, duke mos lënë vend për goditje të papritura. Shpenzimet buxhetore gjatë tremujorit të parë të vitit kanë shënuar rritje në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, por kjo rritje është përqëndruar në muajt shkurt dhe mars. Rritja e shpenzimeve, e cila ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente, nuk ka ushtruar presione inflacioniste gjatë periudhës në fjalë. Harmonizimi i politikës monetare me atë fiskale ka ndihmuar në krijimin e një ambienti makroekonomik të sigurt për kontrollimin dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së normës së inflacionit.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të ndjekë një politikë monetare zbutëse, e cila është reflektuar në uljet e kontrolluara të normës bazë të interesit. Norma bazë e interesit është një nga kanalet kryesore të përcjelljes së ndikimit të

[7] *Në këtë grup përfshihet dhe çmimi i produktit të naftës.*

politikës monetare në ekonominë reale. Uljet në normën e interesit synojnë uljen e kostos së huamarrjes në ekonomi. Në sajë të normës së ulët të inflacionit interesi real vazhdon të jetë pozitiv, duke u kthyer në një mjet tërheqës për të thithur fondet e lira dhe për t'i përqëndruar ato në sistemin bankar, gjë që është reflektuar në uljen e raportit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare. Gjithashtu, rritja e ofertës monetare ka qenë e kontrolluar, gjë që ka mundësuar ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë dhe mbajtjen nën kontroll të presioneve inflacioniste.

Grafik 8. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Leku ka ruajtur pozita të forta ndaj monedhave të huaja - euros dhe dollarit amerikan - edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2005. Tendenca mbiçmuese e lekut gjatë kësaj periudhe, ka ardhur në rënie. Mbiçmimi i lekut vepron si një faktor anti – inflacionist, duke qenë se zbut presionet inflacioniste të inflacionit të importuar. Përveç kësaj, mbiçmimi i lekut ndaj valutave, ka bërë që të rritet besimi në monedhën vendase, gjë që ka ankoruar pritshmëritë për inflacionin në nivele të ulëta.

Rritja e kërkesës së brendshme[8], situata e mirë në tregun e pakicës[9], si dhe rritja e pagave në sektorin publik nuk gjeneruan presione inflacioniste në vend.

III.2.2 Faktorët e ofertës.

Faktorët e ofertës kanë patur një ndikim stabilizues në zhvillimet e çmimeve të konsumit. Gjatë këtij tremujori ekonomia shqiptare nuk është karakterizuar nga goditje të brendshme ose të jashtme që mund të çekuilibronin stabilitetin e treguesve makroekonomikë.

Normat e ulëta të inflacionit në vendet kryesore partnere të shkëmbimeve tregtare flasin për një ambient të jashtëm, ekonomiko – tregtar me tendenca joinflacioniste. Varësia e ekonomisë shqiptare nga importet, nënkupton një varësi të ndjeshme të saj ndaj çmimeve të huaja dhe ndaj zhvillimeve në kursin e këmbimit. Rritja modeste e çmimeve të konsumit në vendet partnere është dobësuar si pasojë e forcimit të lekut ndaj monedhave të huaja, gjë që do të thotë që presionet nga ana e inflacionit të importuar kanë qenë të pakëta.

Tabelë 6. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).

	Qershor	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor'04	Janar' 05	Shkurt
Greqi	3.0	2.9	3.3	3.2	3.1	4.2	3.2
Itali	2.4	2.1	2.1	2.0	2.4	2.0	2.0

*Burimi: Eurostat News Release.

[8] *E vlerësuar nga indeksi i shitjes me pakicë, i cili shënoi një rritje vjetore, në tremujorin e katërt të vitit 2004 me 14.6 për qind.*
[9] *Indeksi i vëllimit të shitjeve me pakicë, në tremujorin e katërt të vitit 2004 regjistroi një rritje vjetore prej 16.4 për qind.*

Prodhimi bujqësor në vend ka luajtur një rol përcaktues në ecurinë e çmimeve të mallrave ushqimorë. Në sajë të peshës së konsiderueshme në shportën e konsumit, ecuria e çmimeve të këtyre mallrave ka formuar, në një masë të madhe, profilin e normës së inflacionit edhe gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Rritja e sipërfaqes së mbjellë dhe rritja e investimeve në serra kanë ndikuar dhe pritet të ndikojnë pozitivisht në vëllimin e prodhimit bujqësor dhe në ofertën e këtyre produkteve në tregun vendas. Rënia vjetore e çmimeve të këtyre mallrave ka shërbyer si faktor balancues për rritjen e çmimit të energjisë në fillim të këtij viti.

Gjatë gjithë vitit 2004, çmimet e prodhimit kanë shënuar ritme të larta rritjeje, të cilat nuk janë përcjellë në çmimet e konsumit. Një shpjegim përtej mospërputhjeve statistikore ose matjeve të pasakta, mund të jetë argumenti që ekonomia jonë po vepron poshtë potencialit të saj. Rritja dhe forcimi i konkurrencës mund të ketë detyruar gjithashtu prodhuesit të vonojnë apo të zbusin transferimin e rritjes së kostos së prodhimit në çmimet e produkteve përfundimtare.

Një rrezik i mundshëm për inflacionin në vend, si gjatë vitit 2004, ashtu dhe gjatë këtij tremujori ishte rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Ashtu siç është shpjeguar dhe në raportet e mëparshme, një sërë faktorësh kanë zbehur pasqyrimin e plotë të kësaj rritjeje. Pesha e vogël që zë ky produkt[10] në shportën e konsumit, mbiçmimi i lekut ndaj dollarit si dhe përshtatja e kërkesës në vend për këtë produkt[11], kanë shërbyer si barriera për transmetimin e plotë të rritjes së çmimit të këtij produkti në tregun vendas.

Grafik 9. Ndryshimet vjetore të IÇP-së dhe IÇK-së për vitet 2002-2004.



Burimi: INSTAT.

IV. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

VI.1 POLITIKA MONETARE DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare lehtësuese përgjatë gjithë vitit 2004 duke ulur disa herë normën bazë të interesit. Inflacioni vjetor gjatë tremujorit të parë të këtij viti, pavarësisht nga presioni i shkaktuar prej rritjes së çmimit të energjisë elektrike, nuk e ka tejkaluar kufirin e sipërm prej 4 për qind të objektivit për inflacionin. Në kushtet e mungesës së presioneve inflacioniste gjatë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë, ka mbajtur një qëndrim neutral duke u kujdesur që të krijojë kushte të përshtatshme për uljen e normave të interesit në tregun bankar. Lehtësimi monetar gjatë kësaj periudhe është mbështetur në reagimin e favorshëm të treguesve monetarë, të reflektuar në ecurinë e kontrolluar të ekuilibrave dhe të ritmeve të rritjes së agregatëve monetarë.

[10] *Nëngrupi "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", ku përfshihet dhe çmimi i naftës ka një peshë prej 1.6 për qind në shportën e IÇK-së.*
[11] *Gjatë vitit 2004 importi i naftës në vend u ul me 2.4 për qind në krahasim me vitin 2003.*

Gjatë tremujorit të parë tregu ndërbankar është karakterizuar nga nivele të larta likuiditeti. Ndryshe nga ç'është vepruar në tremujorin e parë të vitit të kaluar, kur presionet inflacioniste ishin më të larta, në këtë tremujor Banka e Shqipërisë ka tërhequr vetëm përkohësisht likuiditetin e tepërt sezonal duke përdorur instrumentin e repove njëjavore. Lejimi i niveleve të larta të likuiditetit në tregun ndërbankar ka synuar krijimin e presioneve rënëse mbi normat e interesit. Këto të fundit kanë reaguar në drejtimin e pritur. Rënia e normave të interesit ka qenë veçanërisht e dukshme për instrumentet afatgjata, duke sjellë sheshimin e kurbës kohore të normave të interesit.

Grafik 10. Ecuria e normës bazë të interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të muajit mars, Banka e Shqipërisë vendosi të ulte normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje duke e çuar atë në nivelin më të ulët historik prej 5 për qind. Ky vendim u mor në bazë të nevojës së përshtatjes së kushteve monetare aktuale me objektivin e inflacionit në kushtet e zhvillimeve pozitive të treguesve monetarë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 në muajin mars zbriti në 24.8 për qind, duke shënuar nivelin më të ulët historik në 12 vitet e fundit. Ky tregues ka pësuar një rënie të ndjeshme prej 2.4 pikë përqindjeje gjatë tre muajve të parë të vitit. Ulja e fundit e normës bazë të interesit pritet të reflektohet në uljen e mëtejshme të normave të interesit në tregun e bonove të thesarit, të depozitave dhe të kredive në lekë. Lehtësimi i kushteve monetare do të shërbejë si faktor nxitës për rritjen e aktivitetit ekonomik në pjesën e mbetur të vitit. Politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka bërë të mundur respektimin e objektivave sasiorë të saj deri në muajin mars të këtij viti.

Tabelë 7. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Dhjetor'04	Janar '05	Shkurt '05	Mars'05
Rezerva ndërkombëtare neto e BSH (në milionë dollarë)				
Objektivi	941.7	985.3	1,029.0	1,072.7
Aktuale	1,105.2	1,108.8	1,108.7	1,107.4
Diferenca	163.5	123.5	79.7	34.8
Mjetet e brendshme neto të BSH (në miliardë lekë)				
Objektivi	79.0	72.3	67.2	61.3
Aktuale	61.0	56.3	56.5	53.3
Diferenca	-18.0	-16.0	-10.7	-7.9
Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë)				
Objektivi	286.4	288.3	290.2	292.1
Aktuale	286.1	286.9	288.9	287.8
Diferenca	-0.3	-1.4	-1.3	-4.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

VI.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Ritmi i rritjes vjetore të ofertës monetarë ka shfaqur një tendencë rritëse gjatë tremujorit të parë të vitit. Norma vjetore e rritjes së agregatit M3 arriti në 14.4

për qind në muajin mars, duke shënuar një rritje prej 1.3 pikësh përqindjeje kundrejt nivelit të regjistruar në muajin dhjetor. Përshpejtimi i ritmit të rritjes së ofertës monetare i dedikohet rritjes më të lartë të depozitave në valutë. Agregati M2, komponenti në lekë i ofertës monetare, ka patur një rritje të qëndrueshme, si pasojë e përshpejtimit të rritjes së kredisë për ekonominë e cila ka kompensuar kërkesën e ulët të qeverisë për mjete monetare.

Struktura kohore e ofertës monetare ka vazhduar të zhvendoset drejt afateve më të gjata të maturimit, duke reflektuar rritjen e besimit në sistemin bankar si dhe rritjen e atraktivitetit të instrumenteve financiare dhe të shërbimeve të ofruara prej sistemit. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 në muajin mars zbriti në 24.8 për qind, duke shënuar nivelin më të ulët historik në 12 vitet e fundit. Ky tregues ka pësuar një rënie të ndjeshme prej 2.4 pikë përqindjeje, gjatë tre muajve të parë të vitit.

Grafik 11. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pas rritjes sezonale të saj në muajt e fundit të vitit, paraja jashtë bankave është kthyer me ritme të shpejta në sistem. Niveli i saj ka shënuar një rënie prej 8.7 miliardë lekësh ose 6.3 për qind, gjatë tremujorit të parë të vitit. Kthimi në sistem i parasë jashtë bankave reflekton kanalizimin e transaksioneve financiare gjithnjë e më shumë në sistemin bankar. Në këtë drejtim një impuls të rëndësishëm ka dhënë edhe kalimi i pagave të punonjësve të sektorit publik në sistemin bankar. Në të njëjtën kohë, ruajtja e normave reale të interesit në nivele të qëndrueshme pozitive ka qenë një faktor përcaktues për mbajtjen në ekuilibër të strukturës së likuiditetit të ofertës monetare.

Grafik 12. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real (shkalla djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kthimi i parasë në sistem ka sjellë rritjen e depozitave në lekë. Niveli i tyre është rritur me rreth 11.2 miliardë lekë ose me 4.4 për qind gjatë tremujorit të parë të vitit. Normat e rritjes vjetore të depozitave në lekë kanë qenë të qëndrueshme gjatë kësaj periudhe, duke u luhatur në një nivel mesatar prej 12.8 për qind. Stabilizimi i normave vjetore të rritjes së depozitave në lekë reflekton qëndrueshmërinë e kthimit të parasë jashtë bankave në sistem dhe moderimin e kërkesës për instrumentet financiare në lekë (depozita dhe bono thesari), kërkesë e cila motivohej nga diferencat e normave të interesit në lekë dhe valutë.

Rritja e depozitave në lekë ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së depozitave me afat të individëve, norma vjetore e rritjes së të cilave ka patur një trend të

lehtë rritës gjatë tremujorit të parë. Gjithashtu, edhe depozitat pa afat në lekë të individëve dhe të sektorit privat kanë vazhduar të rriten me ritme të larta, duke reflektuar zhvillimet pozitive në mjetet e pagesave bankare dhe rritjen e shkallës së përdorimit të tyre nga publiku. Megjithatë, pesha e vogël e këtyre depozitave në totalin e depozitave në lekë, bën që kontributi i tyre në rritjen e depozitave në lekë të mbetet ende në nivele modeste.

Ritmet e qëndrueshme të rritjes së parasë jashtë bankave dhe të depozitave pa afat në lekë, kanë rezultuar në stabilizimin e ecurisë së agregatit monetar më likuid, M1. Norma e rritjes vjetore së agregatit M1 është luhatur rreth një niveli mesatar prej 20.6 për qind, gjatë tre muajve të parë të vitit. Megjithatë, kjo normë e lartë rritjeje nuk vlerësohet të përbëjë burim për presione inflacioniste, duke qenë se ajo reflekton një ecuri më normale të normës së rritjes së këtij agregati dhe mbart në vetvete edhe disa efekte riklasifikimi[12].

Grafik 13. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat në valutë kanë regjistruar normën më të lartë të rritjes në krahasim me treguesit e tjerë monetarë. Norma vjetore e rritjes së tyre në fund të muajit mars arriti në 23.9 për qind, nga 17.1 për qind që ishte në fund të muajit dhjetor. Përshpejtimi i ritmit i rritjes së depozitave në valutë mund të konsiderohet pjesërisht si një rikthim i normave vjetore të tyre në nivelet historike të viteve të mëparshme. Ajo bëhet më e qartë me zbehjen e efektit negativ të kursit të këmbimit gjatë muajve të fundit[13]. Megjithatë, edhe duke përjashtuar nga analiza efektin e kursit të këmbimit, depozitat në valutë kanë shfaqur një tendencë të qartë rritëse në tremujorin e parë të vitit 2005. Norma vjetore e rritjes së tyre me kurse këmbimi të fiksuara, në muajin mars, përllogaritet në rreth 31.2 për qind, kundrejt 28.0 për qind që ishte në muajin dhjetor. Kjo ecuri në rritje e depozitave në valutë tregon për nivelin e lartë të flukseve hyrëse të valutës në vend, me burim kryesor dërgesat e emigrantëve nga jashtë. Gjithashtu, ecuria e depozitave në valutë është ndikuar edhe nga ngushtimi i *spread*-it të normave të interesit lekë – valutë.

Me përshpejtimin e ritmeve të rritjes së depozitave në valutë, raporti i depozitave në valutë ndaj M3 i është rikthyer tendencës së tij rritëse. Niveli i këtij treguesi në fund të muajit mars u rrit në 24.5 për qind, nga 22.8 për qind që ishte në fund të vitit. Ritmi i lartë i rritjes së depozitave në valutë është mbështetur kryesisht në rritjen e depozitave në valutë me afat (rreth 90 për qind e të cilave zotërohen nga individët). Kontributi i rritjes së depozitave me afat në rritjen vjetore të depozitave valutore totale në muajin mars ishte rreth

[12] *Përjashtimi i efektit të riklasifikimit të depozitave nga banka "Raiffeisen" e ul në 14.4 për qind normën e rritjes vjetore të agregatit M1, duke e vendosur atë në linjë me rritjen e përgjithshme të ofertës monetare.*
[13] *Mbiçmimi i lekut ndaj usd dhe euros ka ulur nivelin e depozitave në valutë të shprehura në lekë, duke rezultuar në norma të ulëta të rritjes së tyre vjetore gjatë dy viteve të fundit.*

73 për qind, duke shënuar një rritje me 8 pikë përqindje në krahasim me tre muaj më parë.

Tabelë 8. Ecuria e treguesve monetarë në muajin nëntor (në miliardë lekë).

	Mars	Ndryshimi 3-mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Para jashtë bankave	129.4	-8.7	-6.3	12.2	10.4
Depozita totale	392.2	23.1	6.3	53.4	15.8
- në lekë	264.5	11.2	4.4	28.8	12.2
- në valutë	127.7	11.9	10.3	24.6	23.9
Depozita pa afat	88.0	10.4	13.4	23.8	37.0
- në lekë	40.8	6.1	17.6	17.1	72.1
- në valutë	47.1	4.3	10.0	6.7	16.4
Depozita me afat	304.2	12.7	4.3	29.6	10.8
- në lekë	223.7	5.1	2.3	11.7	5.5
- në valutë	80.5	7.6	10.4	18.0	28.7
M1	170.2	-2.6	-1.5	29.3	20.8
M2	393.9	2.5	0.6	41.0	11.6
M3	521.6	14.4	2.8	65.6	14.4
Baza monetare	171.2	-7.4	-4.2	16.7	10.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

IV.3. KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

IV.3.1 Pozicioni valutor i sistemit bankar

Megjithëse më i lartë se në fundin e vitit 2004, kontributi i rritjes vjetore të mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të ofertës monetare ka ardhur në rënie, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005. Kontributi i mjeteve valutore në rritjen e ofertës monetare arriti në 48.1 për qind në muajin mars.

Niveli i mjeteve valutore të sistemit është rritur gjatë muajve janar dhe shkurt ndërsa, në muajin mars, krahasuar me muajin dhjetor 2004, ka pësuar rënie prej 3.4 milionë usd. Pakësimi i tyre është rezultat i uljes së rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë me 18.4 milionë usd. Kjo ulje ka ardhur si pasojë e nënçmimit të euros ndaj dollarit gjatë tremujorit të parë me 4.85 për qind, që uli vlerën e investimeve në euro të shprehura në dollarë. Gjatë këtij tremujori ka patur ndërhyrje në tregun valutor nga Banka e Shqipërisë por në nivele të ulëta. Gjithësesi, rritja me 15 milionë usd e mjeteve valutore neto të bankave tregtare ka mbuluar, në pjesën më të madhe, pakësimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë. Bankat e nivelit të dytë kanë regjistruar rritje të depozitave në valutë në nivele më të larta se kreditimi në valutë, duke ndikuar në rritjen e mjeteve valutore neto të tyre.

Grafik 14. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, për tremujorin e parë të vitit 2005, mjetet valutore të sistemit bankar rezultojnë me rritje rreth 43.3 milionë usd. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes si të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me 30.3 milionë usd ashtu dhe nga rritja e këtyre mjeteve për Bankën e Shqipërisë, me 13 milionë usd.

Grafik 15. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

VII.1.1 Krediti i brendshëm

IV.3.2.1 Kërkesa e qeverisë për para

Kërkesa e qeverisë për mjete monetare ka qenë në nivele të ulëta gjatë tremujorit të parë të vitit 2005. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë[14], deficiti buxhetor arriti në 1.76 miliardë lekë në muajin mars, ndërkohë që huamarrja e qeverisë arriti në 4.6 miliardë lekë[15]. Emetimi i obligacioneve dyvjeçare ka përbërë formën kryesore të financimit të deficitit buxhetor, me rreth 4.3 miliardë lekë. Emetimi i bonove të thesarit ka qenë në nivele të ulëta, rreth 0.3 miliardë lekë.

Bankat e nivelit të dytë kanë zvogëluar portofolin e tyre të bonove të thesarit krahasuar me fundin e vitit 2004, me rreth 2.9 miliardë lekë. Individët kanë shtuar portofolet e tyre të bonove me rreth 1.5 miliardë lekë ndërsa rritja e portofoleve të institucioneve dhe Bankës së Shqipërisë është në nivele të ulëta.

IV.3.2.2 Kredia për ekonominë nga sistemi bankar

Kreditimi i ekonomisë ka njohur zhvillime mjaft pozitive gjatë tremujorit të parë të vitit. Teprica e kredisë është rritur me rreth 10 miliardë lekë gjatë kësaj periudhe ose rreth tre herë më shumë se sa gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Boom-i i vënë re gjatë muajve të fundit në kreditimin e ekonomisë i dedikohet ndryshimeve në strukturën kohore të kredisë, e në veçanti rritjes së kredisë me afat të gjatë maturimi.

[14] *Këto të dhëna ndryshojnë nga ato të Ministrisë së Financave, e cila e mban bilancin e saj me bazë cash-i.*
[15] *Diferenca midis deficitit buxhetor dhe financimit të brendshëm të deficitit buxhetor përfaqëson gjendjen e llogarisë të qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë.*

	2002	2003	2004				2005
			T-1	T-2	T-3	T-4	T1
Teprica e kredisë (në mld lekë)	38.7	50.7	53.4	56.8	61.0	70.0	79.7
Kredi afatshkurtër	53.8	46.0	41.6	35.4	33.9	34.0	34.1
Kredi afatmesme	30.1	33.3	35.4	37.8	37.2	36.0	34.5
Kredi afatgjatë	16.1	20.7	23.0	26.8	28.9	30.0	31.4
Lekë	21.3	19.6	17	17	17	20.0	20.0
Valutë	73.7	80.4	83	83	83	80.0	80.0
Burimi: Banka e Shqipërisë.							

Tabelë 9. Tregues të tepricës së kredisë ndaj totalit (në përqindje).

Hyrja e bankës "Raiffeissen" në tregun e kredidhënies, i ka nxitur bankat të tregohen më aktive në tregun e kredisë duke shfrytëzuar mundësi të reja. Një rol të rëndësishëm në rritjen e vëllimit të kredisë afatgjatë mendohet që të ketë luajtur dhe forcimi i marrëdhënieve midis bankave dhe klientëve të tyre, bizneseve edhe individëve. Këtyre të fundit po iu kushtohet më shumë vëmendje nga bankat, sikurse konstatohet edhe nga rritja e vazhdueshme e portofolit të kredisë për individët.

Krahas kredisë totale ritëm pozitiv rritjeje ka regjistruar edhe ecuria e kredisë në lekë, por pa mundur të fitojë terren kundrejt kredisë në valutë, e cila vazhdon të përbëjë rreth 80 për qind të portofolit të kredisë së sistemit bankar.

Zhvillimet pozitive në tregun e kredidhënies janë pasqyruar në përmirësimin e gjithë treguesve makroekonomikë të lidhur me kredinë, gjë që dëshmon për një angazhim në rritje dhe në përmirësim të bankave për ndërmjetësimin e fondeve.

Grafik 17. Ecuria e kredisë në lekë të individëve (në milionë lekë) dhe rritja vjetore e kredisë (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	2002	2003				2004	2005
			T-1	T-2	T-3	T-4	T1
Oferta e paraë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	456.0	458.2	487.6	507.2	521.6
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	71.6	69.5	67.4	68.9	68.3
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	59.9	57.1	54.8	55.1	53.4
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	11.7	12.4	12.6	13.8	15.2
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	13.7	14.6	14.7	16.9	17.7
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	7.1	7.4	8.0	9.0	10.0
Depozita gjithsej (në % ndaj PBB)	42.2	43.4	44.1	44.1	44.4	47.2	48.6
Raporti kredi/depozita (në %)	13.5	15.7	15.8	16.7	16.9	19.0	20.3
Burimi: Banka e Shqipërisë.							

Tabelë 10. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

Tremujori i parë i vitit 2005, ka përforcuar më tej tendencën rënëse të kredisë për sektorin e tregtisë, e cila u vu re që në pjesën e dytë të vitit 2004. Po kështu vihet re një mbështetje më e madhe me kredi e sektorëve prodhues dhe e blerjes së pasurive të paluajtshme. Një zhvendosje e tillë pasqyron tendencën e bankave për të ofruar produkte të reja, në përshtatje me kërkesat e bizneseve dhe të individëve.

Tabelë 11. Ecuria e tepricës së kredisë sipas degëve kryesore të ekonomisë.

				2004				2005
		2002	2003	T1	T2	T3	T4	T1
1	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	1	0.9	1.2	1.6	1.5	1.5
2	Industria përpunuese	17	17	16.9	18.4	18.2	17.1	16.7
3	Ndërtimi	8.6	10	9.7	10.7	10.2	9.8	11.2
4	Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	40.4	34	31.4	23.5	21.9	23.3	20.6
5	Hotele dhe restorante	6	6	7.1	8.3	8.3	8.3	5.2
6	Pasuritë e patundshme	9.1	13	13.7	14.8	15.6	9.8	14.7
7	Të tjera	18.1	19	20.3	23.1	24.2	30.2	30.1
	Totali	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 është akorduar në tërësi rreth 22 miliardë lekë kredi, në nivel disi më të ulët se sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ky fakt nënvizon idenë se rritja e lartë e tepricës së kredisë ka ardhur kryesisht nga ndryshimi i strukturës së kredisë akorduar drejt afateve më të gjata të maturimit.

Tabelë 12. Tregues të kredisë së re ndaj totalit (në përqindje).

	2002	2003	2004				2005
			T-1	T-2	T-3	T-4	T-1
Kredia e re (në mld lekë)	62.6	92.6	27.9	28.5	18.0	25.4	21.8
Kredi afatshkurtër	44.7	63.1	67.1	63.6	61.1	57.5	53.3
Kredi afatmesme	13	22.2	20.3	23.9	21.7	24.0	22.4
Kredi afatgjatë	4.8	7.4	12.7	12.5	17.2	18.5	24.4
Lekë	20.8	30.8	31.4	31.3	33.6	34.6	30.4
Valutë	41.8	61.8	68.6	68.7	66.4	65.4	69.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

IV.4 TREGJET FINANCIARE DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

IV.4.1 Tregjet financiare

Niveli mesatar ditor i likuiditetit gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, vlerësohet të ketë qenë rreth 8.5 miliardë lekë ose 2 herë më i lartë se likuiditeti mesatar ditor i tremujorit të katërt të vitit 2004. Teprica e likuiditetit gjatë këtij tremujori është krijuar nga ulja e nivelit të parasë jashtë bankave dhe rritja e nivelit të depozitave në lekë. Rritja e nivelit të likuiditetit gjatë muajve të parë të vitit, tashmë përbën një tendencë të përsëritur gjatë këtyre viteve të fundit.

Grafik 18. Niveli i likuiditetit në sistemin bankar (në milionë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për të tërhequr likuiditetin e tepërt gjatë këtij tremujori janë përdorur repot njëjavore me çmim fiks, niveli mesatar javor i të cilave arriti vlerën e 6.5 miliardë lekëve nga 3.5 miliardë në tremujorin e mëparshëm.

Përdorim më të gjerë në tremujorin e parë ka gjetur dhe lehtësia e depozitës njëditore, niveli mesatar i të cilës arriti në 0.9 miliardë lekë nga

0.4 miliardë në tremujorin fundit 2004. Tërheqja e përkohshme e likuiditetit për një periudhë më afatgjatë është realizuar me repo njëmujore, gjë që ka zbutur nivelin e lartë të likuiditetit në tregun ndërbankar, por nuk e ka eliminuar në mënyrë të përhershme atë, duke krijuar presion për ulje të normave të interesit. Kredia njëditore nuk është përdorur pothuajse fare gjatë këtij tremujori.

Në tregun ndërbankar, niveli mesatar ditor i transaksioneve njëditore gjatë këtij tremujori ishte 0.65 miliardë lekë nga 0.59 miliardë lekë në tremujorin e kaluar, ndërsa niveli mesatar ditor i transaksioneve njëjavore ka mbetur i pandryshuar në vlerën e 86 milionë lekëve.

Në tregun primar, portofoli i bankave tregtare në letra me vlerë qeveritare, bono thesari dhe obligacione dyvjeçare, është rritur me 1.4 miliardë lekë krahasuar me tremujorin e kaluar. Rritja e portofolit është shkaktuar nga rritja e financimit të qeverisë me obligacione dyvjeçare, ndërkohë që financimi me bono thesari është ulur. Kërkesa e lojtarëve të tregut për të investuar në letra me vlerë qeveritare edhe gjatë këtij tremujori, ka vazhduar të jetë më e madhe se shuma e shpallur fituese në këto ankande, duke ndikuar në rritjen e konkurrencës dhe në uljen e *yield*-eve të bonove të thesarit .

IV.4.2 Ecuria e normave të interesit

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2005, norma bazë e interesit u ul me 0.25 pikë përqindje, duke arritur në nivelin më të ulët historik prej 5.0 për për qind. Normat e interesit në tregun e parasë në përgjithësi, ndoqën të njëjtën tendencë duke rezultuar në fund të tremujorit të tretë në vlerat më të ulëta historike të tyre. Rënia e normave të interesit u mbështet dhe nga një tepricë likuiditeti në nivele të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës.

Nga njëri tremujor në tjetrin, *spread*-i i normave të interesit me interesin bazë ka qëndruar në përgjithësi, në nivele konstante me një tendencë të lehtë ngushtimi. Tregu bankar ka reaguar si ndaj sinjaleve të politikës monetare ashtu dhe ndaj zhvillimeve brenda tregut si rritja e konkurrencës, niveli i kontrolluar i inflacionit, stabiliteti financiar i agjentëve në treg etj..

Grafik 19. Ecuria e normave të interesit (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

	Interesi bazë	Tregu primar			Tregu i depozitave në lekë			Tregu ndërbankar
	REPO	b.th. 3-m	b.th. 6-m	b.th. 12-m	3-m	6-m	12-m	1 ditor
mars-04	6.50	7.04	8.36	9.26	5.21	6.57	7.03	3.70
qershor-04	5.75	6.82	8.18	9.00	4.89	6.10	6.52	3.27
shtator-04	5.50	6.30	7.56	8.43	4.83	5.79	6.26	3.07
dhjetor-04	5.25	6.09	7.22	8.10	4.48	5.41	5.99	3.42
mars -05	5.00*	5.24	6.51	7.14	4.16	4.85	5.44	2.95

*Ndryshimi i repos nga 5.25 për qind në 5.00 për qind u bë në fund të muajit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 13. Niveli i interesave në tregje në fund të çdo tremujori (në përqindje).

Ndonëse interesat nominalë në lekë kanë patur tendencë të ulen, interesat realë gjatë tremujorit të parë 2005 janë rritur, si pasojë e uljes së mëtejshme të normës së inflacionit. Në fund të tremujorit të parë 2005, interesi real arriti në 4.1 për qind, nga 2.9 për qind që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Grafik 20. Interesat e depozitave 12-mujore në lekë dhe inflacioni në bazë vjetore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i kredive në lekë, ndryshe nga tregjet e tjera është karakterizuar nga luhatjet e normave të interesave. Luhatje të tilla shkaktohen kryesisht nga ndryshimi i strukturës së kredidhënies dhe nga niveli i ulët i konkurrencës. Megjithatë, në muajin mars u vu re një prirje e sistemit bankar drejt uljes së normës së interesit për kreditë në lekë, duke zbritur në 14.62 për qind, rreth 0.41 pikë përqindjeje më e ulët se sa norma e muajit shkurt.

Në tregun e depozitave në valutë ka patur një tendencë rritëse të normave të interesit në dollarë, të cilat janë ndikuar nga politika shtrënguese e Fed-it dhe nga rritja e interesave libor në tregjet ndërkombëtare. Norma vjetore e interesave të depozitave në usd arriti në 2.49 për qind duke qenë 0.22 pikë përqindjeje më e lartë se ajo në muajin dhjetor 04.

Interesat e depozitave në euro, kanë qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele, me pak luhatje sipas afateve, të ndikuara nga ecuria e interesave euribor, në tregjet ndërkombëtare. Norma vjetore e interesave të depozitave në euro arriti në 1.90 për qind ose 0.07 pikë përqindjeje më e ulët se në dhjetor. Ulja e normave të interesit në lekë ka çuar në ngushtimin e diferencës midis normave të interesit në lekë dhe atyre në valutë. Në fund të muajit mars, ka patur një përafrim midis interesave të depozitave në lekë me ato në valutë dhe një ngushtim të *spread*-it midis tyre.

Grafik 21. Ecuria e interesave mesatarë të ponderuar të depozitave në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të parë 2005, ka patur një tendencë rënëse të interesave të kredive në dollarë në të gjitha afatet dhe të kredive në euro. Në fund të muajit mars, interesi mesatar i ponderuar i kredive në euro arriti në 8.06 për qind nga 8.17 për qind që ishte në fundi të vitit të kaluar, ndërsa interesi i kredive në usd arriti në 7.18 për qind nga 7.79 për qind.

IV.4.3 Kursi i këmbimit

Pavarësisht disa luhajtjeve në kursin e këmbimit, përgjithësisht tregu valutor i këmbimit ka qenë i stabilizuar gjatë muajve të parë të vitit. Për tremujorin

e parë leku është nënçmuar lehtë, përkatësisht me 0.43 për qind kundrejt euros dhe me 2.55 për qind kundrejt dollarit amerikan. Vihet re që leku është stabilizuar në nivelet e fundvitit 2004, duke mos thelluar mbiçmimin kundrejt dollarit dhe nënçmimin kundrejt euros.

Megjithëse kjo periudhë viti zakonisht njeh një rritje të kërkesës për valutë të huaj, këtë vit është vërejtur një kërkesë dhe ofertë e balancuar. Në terma vjetorë leku ka vazhduar të jetë i mbiçmuar kundrejt të dyja monedhave kryesore, usd dhe euro. Për muajin mars, mbiçmimi vjetor i lekut kundrejt dollarit është 9.82 për qind ndërsa kundrejt euros është 3.11 për qind.

Grafik 22. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2005

QERSHOR 2005

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2004 rezultoi me një tepricë prej 12.7 milionë usd. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Rritje të deficitit korent, në krahasim[1] me një vit më parë.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të investimeve të portofolit me jashtë.
- Rënie e nivelit të huamarrjes shtetërore dhe private, në krahasim me një vit më parë.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar si dhe e koeficientit të mjaftueshmërisë së rezervave valutore për importe mallrash dhe shërbimesh.
- Zhvlerësim i dollarit amerikan si ndaj monedhës evropiane, ashtu edhe ndaj lekut. Efekti i zhvlerësimit të dollarit duhet të merret parasysh sidomos në transaksionet e kryera në monedha të tjera (euro). Kështu, deficiti tregtar i matur në euro, gjatë këtij tremujori, rezulton 9 për qind më i lartë sesa ai i vitit të kaluar, ndërsa i matur në usd deficiti është thelluar me rreth 16 për qind.

I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, vlerësohen në rreth 1.7 miliardë usd ose 26 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 95 për qind e shpenzimeve kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 41 për qind e të ardhurave kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 33 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave. Të ardhurat faktoriale neto janë rritur me rreth 32 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004, megjithatë nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar (mallra dhe shërbime). Ky i fundit është rritur ndjeshëm ndaj vitit të kaluar (rreth 31 për qind) ndikuar nga pozicioni deficit i shërbimeve si dhe nga thellimit të deficitit që shoqëron aktivitetin e tregtisë së jashtme në mallra. Si rezultat i këtyre lëvizjeve, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 56 milionë usd, me rritje vjetore prej rreth 23 për qind.

[1] *Të gjitha krahasimet bëhen me tremujorin e parë të vitit 2004.*

I. 1. TREGTIA E JASHTME.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme flasin për tendenca në rritje të vëllimit të përgjithshëm tregtar, i cili arriti nivelin 680 milionë usd dhe vlerësohet 15 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shkëmbimet tregtare në mallra përfaqësuan rreth 41 për qind të vëllimit të transaksioneve korente. Ekonomia shqiptare dhe tregu i brendshëm mbeten të orientuar drejt importit, i cili gjatë këtij tremujori ishte rreth 3 herë më i lartë se eksporti. Kërkesa e brendshme vazhdoi të nxiste rritjen e importeve, ndërkohë që ecuria pozitive e eksporteve nuk ka mjaftuar për të ngushtuar deficitin tregtar. Shpenzimet për importe shënuan afërsisht vlerën 521 milionë usd ose rreth 67 milionë usd më shumë, krahasuar me vitin 2004. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 16 për qind, duke arritur në 159 milionë dollarë.

Deficiti tregtar, në mbyllje të tremujorit, ishte 363 milionë usd ose 14 për qind më i lartë sesa ai i periudhës korresponduese të vitit paraardhës. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme tërheq vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.

Struktura e importeve dominohet prej mallrave të ndërmjetëm, të cilët gjatë këtij tremujori përfaqësuan rreth 46 për qind të totalit të importeve. Vëllimi në rritje i këtyre të fundit flet për ecuri pozitive të industrisë së përpunimit në vend. Gjithashtu, pozitivisht vlerësohet ecuria e mallrave kapitalë, si një tregues optimist për nivelin e investimeve, për rinovinim e bazës teknologjike si dhe të produktivitetit të sektorit privat. Vërejmë që, kategoria e mallrave të konsumit vazhdon të ruajë një peshë të konsiderueshme në importet totale, rreth 32 për qind.

Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë rieksportet (eksporte me material porositësi), të cilat vazhdojnë të jenë dominuese në eksportet shqiptare, duke zënë aktualisht 81 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Të ardhurat nga eksportet e kësaj kategorie vlerësohen 16 për qind më të larta kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Tregtia në shërbime është shndërruar në një element të rëndësishëm të integrimit global. Transaksionet tregtare në shërbime, gjatë këtij tremujori arritën në rreth 566 milionë usd dhe vlerësohen 32 për qind më të larta krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004. Përshpejtimi i aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve të ofruara dhe/apo të kërkuara jorezidentëve, përbën një tregues pozitiv në ecurinë e hapjes dhe të integrimit të ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Llogaria e shërbimeve për tremujorin e parë të vitit 2005 u mbyll me një bilanc negativ prej 37 milionë dollarësh, ndryshe nga ecuria në periudhën korresponduese të vitit të kaluar që rezultoi me suficit prej 12 milionë usd. Deficiti i këtij fillimviti ka ardhur kryesisht si pasojë e ngushtimit të suficitit të zërit "udhëtime" dhe e ndryshimit të kahut të bilancit në "shërbimet e tjera".

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve influencohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për "turizëm" (udhëtime). Aktualisht, aktiviteti i turizmit përfaqëson një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005 ka gjeneruar rreth 196 milionë usd flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 24 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi është influencuar kryesisht nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin, si edhe nga rritja e lehtë e shpenzimeve të tyre ditore. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 15 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Aktivitet i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 189 milionë usd ose sa 74 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Shqiptarët shpenzojnë më shumë për qëllime personale, kategori e cila ka regjistruar një rritje prej rreth 67 për qind, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2004. Rritja në shpenzimet e udhëtarëve shqiptarë jashtë është dukshëm më e lartë sesa rritja në të ardhura, duke shkaktuar ngushtimin e bilancit pozitiv të kësaj kategorie në 7 nga 33 milionë usd në tremujorin e parë të vitit 2005.

Kategoria "shërbime të tjera" rezulton me deficit prej 13 milionë dollarësh, ndryshe nga suficiti (8 milionë usd) në tremujorin e vitit 2004. Gjatë këtij tremujori janë rritur ndjeshëm shpenzimet në kategoritë "shërbime kulturore dhe biznesi" si dhe në "asistencë teknike". Ndërkohë që, të ardhurat që gjenerohen nga shërbimet e telekomunikacionit vazhdojnë të kenë ecuri pozitive, duke çuar në rritje të suficiteve të kësaj kategorie. Këtë tremujor bilanci pozitiv i "shërbimeve të telekomunikacionit" vlerësohet 4 milionë usd më i lartë krahasuar me vitin e kaluar.

Llogaria e të ardhurave është mbyllur me një bilanc pozitiv prej 46 milionë dollarësh, duke shënuar një rritje prej 24 për qind krahasuar me tremujorin e parë 2004. Rritja më e madhe në hyrjet (kredi) e kësaj llogarie është regjistruar në "kompensimin e punonjësve". Të ardhurat nga kompensimi i punonjësve rezidentë të punësuar sezonalisht jashtë Shqipërisë janë vlerësuar në 29 milionë usd, me rritje vjetore prer rreth 26 për qind. Të ardhurat nga interesat e rrjedhur prej investimit të rezervës valutore vlerësohen në rritje, ndërkohë që interesat mbi investimet e portofolit të rezidentëve jashtë kanë rënë konsiderueshëm (rreth 2 herë). Shqipëria gjatë këtij tremujori ka paguar rreth 3.4 milionë usd për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh dhe janë vlerësuar në nivelin 255 milionë usd duke qenë 25 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transferta, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (17 milionë usd), të cilat vlerësohen në rritje (17 për qind). Kontributi i transfertave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 70 për qind.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2005, rezultuan në një fluks neto prej rreth 66 milionë usd, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent si dhe kanë çuar në rritje të rezervave valutore. Importi i kapitaleve këtë fillim viti ka ardhur në rënie (5 milionë usd) krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë. Ndërkohë që, transfertat kapitale u rritën me rreth 13 milionë usd për të arritur në nivelin e 47 milionë usd, bilanci pozitiv i llogarisë financiare vlerësohet në rënie ndaj një viti më parë (me rreth 17 milionë). Pozicioni i llogarisë financiare këtë tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 64 milionë usd) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 44 milionë usd). Megjithatë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet më i ulët, rreth 18 milionë usd. Ndërkohë, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës kanë ruajtur të njëjtin nivel të një viti më parë.

Struktura e importeve neto të kapitalit këtë tremujor dominohet nga hyrja e kapitaleve të huaja në formën e investimeve direkte. Investimet e huaja direkte, për tremujorin e parë të vitit 2005, vlerësohen në nivelin 54 milionë usd, me një fluks tremujor rreth 19 milionë usd më shumë kundrejt të njëjtës periudhë në vitin 2004.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës mbeten lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 22.4 milionë usd. Në këtë borxh, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond, prej 6.1 milionë usd. Ndërsa përgjatë vitit të kaluar është vënë re prania e sektorit privat në huamarrjen afatgjatë, këtë tremujor disbursimet e huave të këtij sektori kanë qenë shumë të ulëta. Fluksi i huamarrjes gjatë këtij tremujori vlerësohet rreth 40 për qind më i ulët, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2004. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 10 milionë usd, të barasvlefshme me 6.5 për qind të eksportit të mallrave.

Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar, gjatë këtij tremujori, kanë rënë me rreth 5.8 milionë usd. Gjithashtu në rënie vlerësohet fluksi i detyrimeve në formën e kredisë tregtare (rreth 13 milionë usd).

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 44 milionë usd, duke ruajtur të njëjtën tendencë të vërejtur në fillim të vitit të kaluar. Kjo rritje është pasojë e rritjes së fluksit të investimeve të portofolit.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të tremujorit të parë të vitit 2005, kapi shumën 201 milionë dollarë, me një fluks tremujor në rritje prej 56 milionë dollarësh. Mjetet valutore, të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, kanë rënë me rreth 10 milionë dollarë. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, 55 për qind e tyre janë në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është në euro (41 për qind) dhe stërlina angleze (3 për qind). Gjithashtu, në rënie vlerësohen mjetet valutore *cash*. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, mjetet valutore *cash* në dollarë amerikanë zinin 42 për qind dhe ato në euro 52 për qind, stërlina angleze 5 për qind dhe franga zviceriane 1 për qind.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 13 milionë usd. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 350 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 4.9 muaj importe mallrash dhe shërbimesh nga 4.6 në tremujorin e parë të vitit 2004.

Tabelë 1. Bilanci i pagesave (në milionë dollarë amerikanë)

Bilanci i pagesave në milionë dollarë amerikanë	3m-I 2004	3m-II 2004	3m-III 2004	3m-IV 2004	3m-I 2005
Llogaria korente	-45.8	-114.2	-30.8	-167.3	-56.2
Eksporti i mallrave	136.5	156.5	148.7	161.7	158.5
Importi i mallrave	-454.4	-514.6	-554.5	-671.5	-521.5
Bilanci tregtar	-317.9	-358.0	-405.8	-509.8	-362.9
Shërbimet: Kredi	220.4	248.3	273.6	261.1	264.7
Shërbimet: Debi	-208.2	-267.4	-280.0	-299.2	-301.7
Të ardhurat: Kredi	42.8	41.8	68.1	51.0	51.4
Të ardhurat: Debi	-5.3	-8.3	-6.1	-8.6	-5.0
Transferta private pashpërblim	207.8	212.9	298.9	314.3	280.2
Transferta shtetërore pashpërblim	14.6	16.7	20.4	23.9	17.1
Llogaria kapitale	34.0	25.7	35.6	37.0	46.6
Llogaria financiare	31.0	220.4	-16.4	151.8	13.4
Investime direkte	35.0	176.7	71.9	57.7	54.0
Investime portofoli	-1.3	4.0	119.8	-126.1	-56.3
Kapitale të tjera*	-2.7	39.7	-208.0	220.2	15.7
Gabime dhe harresa neto	-10.2	-14.6	101.1	39.1	2.8
Bilanci i përgjithshëm	14.9	117.4	95.3	60.6	12.7
Rezervat dhe zëra të lidhur me to					
Mjetet e rezervës	-14.9	-117.4	-95.3	-60.6	-12.7
Përdorim huash e kredish nga FMN	6.0	0.0	5.9	0.0	6.1
Për t'u mbajtur në vëmendje					
Ndryshimi total në rezerva	-2.6	-113.9	-103.2	-123.4	20.6
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-12.3	-3.6	7.8	62.8	-33.3

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.
*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

PËRSHËNDETJE E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Seminar "Testimi i sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut"
Tiranë, 5 prill 2005

Pranova me kënaqësi ftesën për të hapur këtë seminar mbi "Testimin e sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut" (Stress-Testing), duke patur parasysh se tema rreth së cilës ju do të diskutoni gjatë këtyre tre ditëve është një çështje e rëndësishme për pasurimin e instrumenteve të institucionit mbikëqyrës, për të identifikuar paraprakisht fushat ose zhvillimet që mund të jenë të brishta dhe për të vepruar siç duhet për të parandaluar situatat e pafavorshme për institucionet e licencuara.

Jeta na tregon se rreziku është i pranishëm kudo. Disa gjëra nuk janë aspak të sigurta që ndodhin, disa të tjera nuk dihet me siguri se kur do të ndodhin ose ku. Aktiviteti i individëve, i familjeve, i bizneseve, i qeverisë ndikohet në mënyrë të ndjeshme nga ajo që do të ndodhë në një moment, nesër, pasnesër dhe kështu me radhë. A ka ndonjë mënyrë për të shmangur plotësisht rrezikun, në jetën tonë, në aktivitetin tonë? Përgjigja ndaj këtyre pyetjeve është një nga të paktat deklarata absolute: jo, nuk ekziston asnjë mënyrë. Atëherë është e pashmangshme të jetosh me rrezikun, ta kuptosh dhe ta pranosh, me qëllim që ta administrosh atë.

Bankingu është një aktivitet biznesi ku rreziku është i pandarë. Kjo është e qartë kur mendohet për përbërjen normale të një bilanci banke ose kur dikush fillon të llogarisë disa raporte të caktuara gjatë vlerësimit të pozicionit të tyre të likuiditetit. Bankat ndërmjetësojnë midis subjekteve që zotërojnë likuiditetet e tyre për një periudhë të caktuar kohe dhe të tjerëve, që kanë nevojë për likuiditet për të vijuar ekzistencën dhe për të ofruar shërbimet dhe veprimtaritë e tyre. Këto grupe kanë një qëndrim të ndryshëm ndaj rrezikut, i cili formohet si pjesë e përvojës së tyre të mëparshme. Ata e shprehin këtë qëndrim përmes zgjedhjes që i bëjnë një banke të caktuar, një produkti të caktuar, një strukture maturimi të caktuar, një monedhe të caktuar ose duke qëndruar tërësisht larg bankave. Për shumë nga ne, në rastin e tregjeve financiare dhe të sistemeve bankare të pazhvilluara, këto zgjedhje mund të mos jenë të logjikshme. Ato vijnë më tepër si rrjedhojë e një zgjedhjeje të kufizuar, dhe në shumë raste, e njohurive të kufizuara. Si të tilla, ato nënkuptojnë pak vetëdije ndaj rrezikut nga ana e klientëve, dhe për pasojë, motivim të pakët nga vetë bankat për të monitoruar rreziqet e tyre në mënyrë të kujdesshme.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që bankat (dhe institucionet e tjera financiare) të ndërtojnë sistemet e tyre për të identifikuar, për të matur, për të monitoruar dhe për të administruar rreziqet. Me sisteme këtu kuptojmë para së gjithash ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe ndërtimin e procedurave, të cilat janë një tregues se sa mirë administratorët e bankës, përfshirë dhe bordin e drejtorëve, i kuptojnë rreziqet që lidhen me natyrën dhe me shkallën e biznesit të tyre. Sigurisht, kjo punë bëhet më efikase nëse mbështetet nga teknologjia e informacionit, në një shkallë të mjaftueshme për madhësinë dhe

për kompleksitetin e biznesit bankar. Nga pikëpamja praktike, në sistemet financiare ku madhësia e disa institucioneve financiare është e një rëndësie sistemike, zhvillimi i një programi të administrimit të rrezikut është parësor. Përveç drejtuesve të bankave, përgjegjësia e të cilëve, e përsëris, është e një natyre parësore, autoriteti mbikëqyrës ka një interes dhe përgjegjësi të qartë për të siguruar që bankat e veçanta (dhe institucione të tjera financiare) kuptojnë atë çfarë bëjnë. Ky interes rrjedh jo vetëm nga detyrimi ligjor, por është gjithashtu një instrument për të siguruar publikun që institucionet financiare drejtohen në mënyrë të sigurtë. Në fund, e gjithë kjo jep një kontribut themelor drejt realizimit të objektivit për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Historia dhe praktika kanë treguar se të kesh një mirëfunksionim të mbikëqyrjes është e rëndësishme, por jo e mjaftueshme. Është tregu ai që mund të zbulojë shumë mirë dhe në kohën e duhur qëndrimet që tregojnë një sipërmarrje rreziku të pakujdesshme nga ana e institucioneve financiare. Në një treg që funksionon në kushte normale, faktorët konkurrues i detyrojnë aktorët të vështrojnë tek njëri-tjetri për të identifikuar se çfarë mund të bëhet më mirë. Ky element forcohet ndjeshëm nëse shoqërohet nga kërkesat për një transparencë dhe përgjegjshmëri më të lartë. Në kushtet e një tregu të zhvilluar, puna e mbikëqyrësve, nga pikëpamja e identifikimit në kohë të sipërmarrjeve të pakujdesshme të rreziqeve nga ana e institucioneve financiare, bëhet më e lehtë. Nga ana tjetër, tregjet e hapura dhe të zhvilluara, zakonisht nënkuptojnë më shumë produkte të reja me karakteristika rreziku komplekse, që kërkojnë sisteme po të tilla për t'i mbështetur dhe për t'i monitoruar ato. Sigurisht, kjo kërkon një mbikëqyrje më të aftë dhe më të zhdërvjellët.

Ndërsa mirëfunksionimi dhe transparenca e tregjeve janë elemente që ndihmojnë mbikëqyrjen, ato në asnjë rast nuk e zëvendësojnë atë. Së pari, ndërsa tregjet e zhvilluara nënkuptojnë më shumë kapacitete për të analizuar ngjarje të kaluara dhe të ardhme, rreziku qëndron në mundësinë që ato të humbasin pamjen e përgjithshme globale, meqenëse institucionet e veçanta nuk disponojnë të dhëna dhe, në mjaft raste, nuk e ndiejnë nevojën për të analizuar stabilitetin financiar të sistemit në tërësi. Së dyti, ajo që institucionet financiare individuale analizojnë dhe presin nga zhvillimet e ardhshme, është shpesh ajo që ata duan. Duhet të rikujtojmë gjithashtu se institucionet financiare të një madhësie të rëndësishme që presin zhvillime të ngjashme, e kanë pushtetin për të lëvizur tregun drejt një drejtimi të caktuar. Mbështetur në elemente specifike të çdo tregu kombëtar ose rajonal, kjo nuk tregon domosdoshmërisht një pakësim në nivelin e rrezikut. Për më tepër, rreziku sistemik është ende shumë i lartë, në këtë rast.

Në këto kushte, është e rëndësishme të pajisen mbikëqyrësit me mjetet analitike të nevojshme, për të përdorur të dhënat globale të institucioneve financiare të mbikëqyrura, për të ndërtuar modele që do të sigurojnë një analizë globale. Si mbikëqyrës, nëpërmjet asaj çfarë bëjmë dhe se kush jemi, ne jemi më të interesuar për atë që do të ndodhë nëse krijohet një situatë ekstreme. Çfarë ndodh nëse kursi i këmbimit lëviz në drejtim të kundërt? Si ndikon kjo mbi portofolin e kredisë së bankës X, e cila krediton kryesisht në valutë? Sa e madhe është kjo çështje për sistemin bankar në tërësi? Cilat janë

zhvillimet në kursin e këmbimit që mund të ndikonin negativisht ndaj bilancit të një institucioni financiar dhe ndaj mbarë sistemit? Cili është kombinimi midis rrezikut të kursit të këmbimit dhe rrezikut të përqëndrimit, dhe ndikimi ndaj një institucioni që i mban shumicën e letrave me vlerë të qeverisë në qarkullim?

Të gjitha këto çështje janë të rëndësishme për rastin e Shqipërisë. Tregu financiar është në zhvillim, por kemi rrugë të gjatë për të bërë. Sektori bankar është pjesa më e rëndësishme, me aktivet e tij që llogariten në afërsisht 90 për qind të sistemit financiar. Duke parë madhësinë e bankave, sistemi vazhdon të jetë asimetrik. Megjithatë, kur vërehen produktet dhe shërbimet që bankat ofrojnë për publikun, pamja është më e balancuar. Kreditimi është ende i ulët krahasuar me vende të tjera të rajonit, por është duke u rritur me shpejtësi. Rreth 80 për qind e portofolit të kreditimit është në valutë. Investimet e likuiditetit në letrat me vlerë janë në rritje. Në fund të vitit 2004, kthimi mbi kapitalin qëndronte në nivelin 21.1 për qind, ndërsa kthimi mbi aktivet ishte 1.28 për qind. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në nivelin 21.6 për qind. Që nga fillimi i vitit 2004, shteti nuk ushtron më kontroll mbi kapitalin bankar. Ndonëse ekonomia shqiptare është e vogël, mundësitë për zgjerim janë reale meqenëse ekonomia është shumë e hapur dhe rajoni është duke u integruar gjithnjë e më shumë në zonën ekonomike të Bashkimit Evropian. Në kushte të tilla, ne presim zhvillime më pozitive në sektorin financiar dhe në atë bankar, në veçanti. Ndërsa situata për sistemin në tërësi është e kënaqshme, ka disa sfida që duhen përballuar, të cilat kërkojnë nevojën e një ndërgjegjësimi më të madh në industri dhe një monitorim më të kujdesshëm nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Kështu, për shkak të strukturës së sistemit bankar dhe mjedisit të një konkurrence në rritje, pritet që bankat e vogla individuale të kalojnë kohë më të vështira në të ardhmen. Ne parashikojmë të shohim një ulje të kufijve të fitimit të tyre, që mund të pengojë përpjekjet e tyre për t'u pozicionuar më mirë në treg. Nga ana tjetër, ato do të detyrohen të gjejnë rrugë të reja për të rritur financimet dhe të ardhurat e tyre. Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë këtyre bankave, meqenëse në këto kohë të vështira, procedurat dhe kontrollet në aktivitetet bankare me normë fitimi të lartë (si kreditimi), synojnë të zbuten. Në të njëjtën kohë, si bankë qendrore, ne besojmë se ka mundësi për konsolidim të sistemit bankar. Ne besojmë se nëpërmjet këtij procesi, bankat me profil të lartë ndërkombëtar mund të hynin në tregun shqiptar në rritje ose bankat ekzistuese të vogla dhe të mëdha mund të pozicionoheshin më mirë në treg.

Banka e Shqipërisë dëshiron të shohë një nivel më të lartë ndërmjetësimi të sistemit bankar dhe një ndikim më të madh mbi zhvillimin ekonomik të vendit. Ne do të inkurajojmë sistemin bankar për të kredituar më shumë ndaj bizneseve të shëndosha dhe ndaj atyre fushave të ekonomisë që tërheqin me një progres të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm. Megjithatë, në çdo rast, ne do të këmbëngulim që bankat të ruajnë të forta proceset e garantimit dhe të administrimit të kredisë, në mënyrë që të sigurohet një rritje e balancuar dhe e fortë e aktivitetit. Për shkak të kompozimit monetar të portofolit të kredisë,

është e rëndësishme që bankat t'i kushtojnë vëmendje të veçantë hyrjeve në *cash* të huamarrësve të tyre, meqë këto mund të mos shprehen gjithnjë në të njëjtën monedhë si dhe kredia. Çdo ndryshim i papritur, në kah të kundërt, i kursit të këmbimit mund të nënkuptojë probleme, nëse nuk jemi të përgatitur paraprakisht për t'u bërë ballë atyre. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë dëshiron të shohë nivele më të larta kreditimi në monedhën vendase. Kjo, së bashku me informacione të tjera, do të përmirësojë aftësinë e saj për të parashikuar më mirë zhvillimet në mekanizmin e transmisionit dhe në drejtimin e politikës së saj monetare. Duke parë në një këndvështrim makrofinanciar më të gjerë, Banka e Shqipërisë ka kontribuar për këtë qëllim duke ulur normën e repove në nivele të ulta historike dhe duke mbyllur diferencialin e normës së interesit të kreditimit midis monedhës vendase dhe valutës.

Zhvillimet e reja të sistemit bankar dhe financiar, shtrojnë sfida të reja. Është e rëndësishme që këto sfida të mirëidentifikohen dhe të mirëkuptohen duke vepruar siç duhet ndaj tyre. Ne duam ta bëjmë këtë në bashkëpunim me sistemin bankar. Linjat e hapura të komunikimit dhe diskutimi transparent dhe i frytshëm mbi zhvillimet e reja do të ndihmojnë secilën palë për të kuptuar më mirë problemet dhe për të vepruar sa më shpejt për ndryshimin e situatës, brenda kuadrit rregullator. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë proceset tona mbikëqyrëse, me synimin për ta bërë mbikëqyrjen proaktive dhe tërësisht të orientuar drejt çështjeve të rrezikut. Ne do të investojmë kohë dhe para të konsiderueshme për të rritur cilësinë e personelit tonë. Ne synojmë ta bëjmë kuadrin tonë rregullator sa më në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, duke patur në konsideratë edhe kushtet tona specifike.

Unë besoj se ky seminar do të na ndihmojë për të shtrirë njohjen tonë lidhur me rrezikun në sektorin financiar dhe bankar, si dhe për të promovuar "stress-testing" si një nga teknikat e vlerësimit të tij. "Stress-testing", i përdorur më vete dhe së bashku me teknika të tjera, është një mjet për të verifikuar rezistencën e institucioneve tona financiare dhe të sistemit financiar. Në Bankën e Shqipërisë, ne kemi shumë interes të njohim përvojat tuaja. Prandaj do të doja t'ju inkurajoja për të sjellë në këtë seminar shembujt tuaj realë. Unë besoj se juve gjithashtu, do t'ju pëlqejë Tirana, një qytet që po ndryshon me shpejtësi, edhe për ata që jetojnë këtu. Ju do të kuptoni diçka më shumë rreth këtij vendi dhe popullit të tij, dhe kjo mund të jetë aq interesante sa ju mund të dëshironi të vinit përsëri. E fundit por jo më pak e rëndësishme, do të doja të falenderoja Fondin Monetar Ndërkombëtar, z. Driessen dhe kolegët e tij, për mbështetjen e dhënë për zhvillimin e këtij seminari të përbashkët në Tiranë, si dhe për dhënien e ekspertizës së tyre të çmuar në planin teorik dhe praktik.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Takim me anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,
Tiranë, 6 prill 2005

Ndodhem sot para jush në prezantimin tim të parë si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, për të ndarë me ju vlerësimet e Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike të vitit 2004, për të paraqitur pikëpamjet tona për perspektivën e ekonomisë shqiptare në vijim, si dhe për të prezantuar aspekte të tjera të rëndësishme të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë në këtë periudhë. Banka e Shqipërisë është një institucion me një rol kyç në fushën e vendimmarrjes së politikave ekonomike dhe financiare, si dhe në drejtim të krijimit dhe të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit. Për këtë qëllim, në emër të institucionit që unë drejtoj, mirëpres çdo opinion, koment apo sugjerim në lidhje me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e zhvillimit institucional, politikës monetare dhe mbikëqyrjes bankare.

EKONOMIA SHQIPTARE GJATË VITIT 2004

Zhvillimi i ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2004, sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë, ka qenë në përputhje me objektivat e strategjisë së zhvillimit ekonomik të vendit. Ekonomia shqiptare rezulton të jetë rritur me 6.0 për qind në terma realë, duke ruajtur ritmin mesatar të zhvillimit të pesë viteve të fundit.

Rritja e ekonomisë shqiptare vazhdon të gjenerohet nga zhvillimi dinamik i sektorit privat. Sektorët që kanë dhënë kontributin më të madh në normën e rritjes vjetore vlerësohet të jenë: shërbimet, ndërtimi dhe transporti, të cilët kanë kontribuar rreth 75 për qind të rritjes ekonomike. Megjithëse ndryshimet demografike gjatë viteve të fundit e bëjnë të vështirë pasqyrimin statistikor të zhvendosjes së forcave të punës, sipas të dhënave zyrtare, norma e papunësisë vlerësohet të ketë rënë nga niveli 15 për qind në fund të vitit 2003, në nivelin 14.6 për qind në fund të vitit 2004.

Gjatë vitit 2004, investimet në ekonomi kanë qenë në të njëjtin nivel relativ me vitin 2003, duke përbërë rreth 25.4 për qind të PBB-së. Këto investime përfaqësohen kryesisht nga investimet private, të cilat përbëjnë rreth 80 për qind të investimeve totale. Sektori financiar i ka dhënë një mbështetje gjithnjë e më të madhe këtij zhvillimi, nëpërmjet rritjes së kreditimit dhe të gamës së shërbimeve të ofruara. Kredia për ekonominë është rritur mesatarisht me 34 për qind gjatë dy viteve të fundit duke u shoqëruar njëkohësisht me rritje të afatit të maturimit.

Treguesit fiskalë evidentojnë se politika fiskale e ndjekur gjatë vitit 2004 ka qenë një politikë e kujdesshme, e mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2004-2006. Të shprehur në terma të PBB-së, treguesit buxhetorë janë në nivele të përafërta me ato të vitit 2003, ku veçohet shifra e pandryshuar e deficitit buxhetor, në masën 4.9 për qind. Këta tregues kanë mbetur nën nivelet e parashikuara në buxhetin e vitit 2004, duke shtruar

nevojën e një ndjekjeje më të kujdesshme të buxhetit në dy fazat kryesore të tij; atë të hartimit dhe atë të zbatimit. Gjithashtu, realizimi i shpenzimeve kapitale mbetet një problem i cili meriton një vëmendje më të madhe në të ardhmen, duke u nisur nga rëndësia që ka ai për zhvillimin e kapaciteteve të infrastrukturës së vendit.

Situata e favorshme ekonomike në vend është reflektuar edhe në fushën e transaksioneve me jashtë. Deficiti korent shënoi një rënie të dukshme ndaj dy viteve paraardhës, duke arritur në 5.3 për qind të PBB-së. Ky zhvillim rezulton të jetë pasojë e ngushtimit të deficitit tregtar, i cili zbriti në nivelin 21 për qind të PBB-së në vitin 2004, nga 23.4 për qind të PBB-së në vitin 2003. Rezerva valutore e Shqipërisë mjafton për të mbuluar rreth 5.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Viti 2004 është shoqëruar me presione mbiçmuese për lekun, të ndikuara nga stabiliteti makroekonomik i vendit, nga rritja e besimit në monedhën vendase dhe nga ndikimi më i madh i efekteve sezonale. Krahasuar me një vit më parë, leku është mbiçmuar mesatarisht me 7.2 për qind kundrejt euros dhe 15.7 për qind kundrejt dollarit. Sipas vlerësimeve tona mendohet se shkaqet kryesore në forcimin e vlerës së lekut duhen kërkuar te: konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit ekonomik të vendit; diferenca e normave të interesit midis lekut dhe valutave; konsolidimi i financave publike dhe i deficitit buxhetor ka diktuar një kërkesë të ulët të qeverisë për mjete monetare dhe dërgesat e qëndrueshme të emigrantëve shqiptarë që punojnë jashtë vendit.

Megjithë zhvillimet pozitive të viteve të fundit, rritja ekonomike dhe stabiliteti makroekonomik i vendit janë dy parametra të cilët, në vlerësimin tonë, nuk mund dhe nuk duhet të merren si çështje të përfunduara. Deficiti i lartë tregtar kërkon gjetjen e burimeve të qëndrueshme afatgjata të mbulimit, veçanërisht nxitjen e investimeve të huaja direkte.

Politika fiskale duhet të vazhdojë të ruajë kontributin e saj pozitiv në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik, kontribut ky i shprehur në reduktimin e deficitit buxhetor, në shtimin e të ardhurave dhe në vendosjen e prioriteteve sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social në kryerjen e shpenzimeve buxhetore. Zhvillimi i sektorit financiar gjykojmë se duhet të balancohet në të gjitha segmentet e tij, çka kërkon përfundimin e procesit të privatizimit dhe harmonizimin e legjislacionit rregullues dhe mbikëqyrës, në përputhje me praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara.

ZHVILLIMET NË INFLACION DHE NË POLITIKËN MONETARE

Sipas zhvillimeve të faktuara, Banka e Shqipërisë e ka përmbushur objektivin e saj për kontrollin e inflacionit në intervalin 2-4 për qind. Inflacioni vjetor në fund të vitit 2004 rezultoi 2.2 për qind ndërsa norma mesatare e inflacionit vjetor për vitin 2004 ishte 2.9 për qind.

Zhvillimet e favorshme makroekonomike gjatë vitit 2004 kanë krijuar një bazë të përshtatshme për kontrollin e inflacionit. Dy politikat makroekonomike

bazë, politika monetare dhe ajo fiskale, kanë kontribuar në drejtim të stabilizimit të aktivitetit ekonomik, duke mos ushtruar presione në rritje mbi normën e inflacionit. Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2004 kanë qenë relativisht të njëtrajtshme përgjatë vitit, duke mos rrezikuar shtimin e presioneve inflacioniste në ekonomi në periudha të caktuara. Huamarrja e brendshme e qeverisë ka qenë në nivelin 2.0 për qind të PBB-së gjatë vitit 2004, në krahasim me vlerën 2.9 për qind të shënuar në vitin 2003.

Politika monetare, e ndjekur gjatë vitit 2004, ka ruajtur të njëjtin kah zbutës të politikës së ndjekur gjatë vitit 2003. Banka e Shqipërisë ka ulur 5 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2004, me një efekt total prej 1.25 pikësh përqindjeje, duke qëndruar në fund të vitit në nivelin 5.25 për qind. Politika monetare zbutëse ka qenë në përputhje me zhvillimet në inflacion gjatë vitit 2004 dhe me pritshmëritë pozitive për këtë tregues në të ardhmen. Vlen të theksoj, se këto zhvillime janë perceptuar drejt nga publiku, i cili është duke i ankoruar gjithnjë e më tepër pritjet e tij inflacioniste në objektivin e inflacionit të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Kjo është reflektuar në rritjen e interesimit të publikut për depozitimin e kursimeve të tyre në lekë, duke gjeneruar edhe presione mbiçmuese mbi kursin e këmbimit të lekut.

Presionet e dobëta inflacioniste nga ana e politikës fiskale, administrimi i mirë i ofertës monetare, si dhe mbiçmimi i lekut kanë krijuar kushte për një rritje të moderuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2004. Në përgjithësi, Banka e Shqipërisë gjykon se kjo situatë e favorshme do të vazhdojë të manifestohet edhe gjatë vitit në vazhdim. Ajo do të mbështetet nga kushtet e favorshme monetare të ekonomisë dhe nga zhvillimi i kontrolluar i kërkesës së brendshme. Duke gjykuar mbi informacionin në dispozicion dhe në mungesë të fenomeneve *shock*, rritja e çmimeve të konsumit për vitin 2005 parashikohet të jetë brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë, 2-4 për qind.

Niveli i kontrolluar i inflacionit ka bërë të mundur ruajtjen e një norme reale interesi në terma pozitivë, megjithë reduktimin e vazhdueshëm të normave nominale të interesit në minimume historike. Norma reale pozitive e interesit ka ruajtur interesin e qytetarëve për depozitimin e kursimeve të tyre në sistemin bankar, duke sjellë reduktime të mëtejshme të nivelit relativ të parasë jashtë bankave që qarkullon në ekonomi.

ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Gjendja financiare e sistemit bankar në fund të vitit 2004, paraqitet e mirë. Sistemi bankar evidenton të ardhura pozitive neto për vitin 2004, rreth 5.11 miliardë lekë apo rreth 0.66 miliardë më i lartë se një vit më parë. Rritja e rezultatit neto nuk ka ardhur vetëm nga rritja e aktiveve të sistemit bankar, por edhe si shkak i rritjes së produktivitetit të aktiveve dhe të kapitalit, gjë që pasqyrohet në vlerën e lartë të treguesve kryesorë të rentabilitetit (RoA dhe RoE). Treguesi i cilësisë së kreditimit (raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë) llogaritet 4.2 për qind nga 4.6 për qind në fundvitin 2003. Niveli më i ulët i këtij treguesi evidenton përmirësim të cilësisë së kreditimit dhe ekspozim të kufizuar të sistemit bankar ndaj rrezikut të kreditit.

Procesi i mbikëqyrjes ka vënë në qendër të tij vlerësimin e rrezikut të veprimtarisë së bankave, duke u përpjekur të jetë proaktiv dhe i vazhdueshëm. Si pjesë e kërkesave të Planit të Zhvillimit të Mbikëqyrjes, një dokument i hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore, është hartuar dhe miratuar dokumenti i "Politikës Operative të Mbikëqyrjes", ku përcaktohen parimet e mbikëqyrjes së bankave.

Gjatë vitit 2004, sistemi bankar në Shqipëri u karakterizua nga zhvillime dinamike si në drejtim të rritjes së numrit të bankave që veprojnë në treg ashtu edhe në drejtim të zgjerimit të rrjetit bankar në zona të ndryshme të vendit. Në fund të vitit 2004, numri i bankave në Shqipëri ishte 16, nga të cilat 2 banka janë me kapital tërësisht vendas dhe në 14 bankat e tjera mbizotëron kapitali i huaj. Sistemi bankar u konsolidua më tej me miratimin, në prill të vitit 2004, e transferimit të 100 për qind të pronësisë së aksioneve të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank, si kurorëzim i procesit të privatizimit të kësaj banke. Gjithashtu, në tregun shqiptar hyri edhe Banka Popullore sh.a., banka e dytë me kapital tërësisht shqiptar, si edhe është paraqitur aplikimi për krijimin e një banke të re me kapital tërësisht shqiptar. Ky aplikim ka marrë së fundi miratimin paraprak për licencë sipas kërkesave të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Gjatë vitit 2004 statusi ligjor i Bankës së Shqipërisë mbeti i pandryshuar. Ndërkohë, ka filluar rishikimi i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me qëllim përsosjen e mëtejshme të kuadrit ligjor të aktivitetit të bankave të nivelit të dytë, në përputhje edhe me aspiratat e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në vjeshtën e vitit të kaluar Banka e Shqipërisë ripërtëriti pjesën dërrmuese të Këshillit Mbikëqyrës (7 anëtarë) si dhe u zgjodhën edhe administratorët e rinj të këtij institucioni. Ky proces nuk ndikoi në rrjedhën normale të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë duke përbërë një tregues të konsolidimit të saj.

Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë një tipar tjetër që ka karakterizuar performancën e Bankës së Shqipërisë. Në këtë drejtim, kemi qenë të hapur dhe të gatshëm në ideimin dhe zbatimin e programeve të zhvillimit të vendit, në këshillimin e ekzekutivit shqiptar për çështje të ndryshme të karakterit ekonomik si dhe kemi marrë pjesë aktive në të gjitha tryezat e negociatave me faktorin ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, duhet të theksoj se kemi organizuar edhe takime me përfaqësi dhe grupe të ndryshme interesi ekonomik, të cilat jo vetëm na kanë ndihmuar në të kuptuarit më mirë të pikave të dobëta por kanë shërbyer edhe për të sqaruar të pranishmit në to mbi përparësitë dhe përfitimet e ndërsjellta.

Ne jemi të vendosur që t'i vazhdojmë përpjekjet tona në drejtim të bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2005. Për këtë qëllim, po punojmë që të përfundojmë në kohën e duhur

projektin e pagesave të vogla, për të nisur një bashkëpunim tjetër me Bankën Botërore, për krijimin e regjistrit të informacionit të kredive. Nga ana tjetër, po mbajmë vazhdimisht nën presion sistemin bankar jo vetëm për t`u shtrirë më tej gjeografikisht, por edhe për të rritur cilësinë dhe inventarin e instrumenteve të pagesave.

Më lejoni që në përfundim të fjalës time të ritheksoj edhe një herë gatishmërinë e institucionit që unë drejtoj në drejtim të përmbushjes të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga ligji "Për Bankën e Shqipërisë". Kjo do të arrihet nëpërmjet përsosjes së mëtejshme të kuadrit të politikës dhe të operacioneve monetare si dhe njëkohësisht, nëpërmjet thellimit të njohurive tona në lidhje me funksionimin dhe ndërvarësitë shkakësore që karakterizojnë ekonominë e Shqipërisë. Viti 2005, besoj se do të jetë vit i suksesshëm në drejtim të punës kërkimore, veçanërisht në drejtim të rritjes së fuqisë parashikuese për zhvillimet inflacioniste dhe të përmirësimit të qeverisjes së Bankës së Shqipërisë. Dëshiroj të citoj se aspirata jonë politike mbetet adoptimi i regjimit të inflacionit të shënjestruar, fakt ky që na imponon të angazhohemi seriozisht në qëmtimin e kujdesshëm të parakushteve përkatëse. Për këtë qëllim, ne do të zhvillojmë tezat përkatëse për të cilat kemi nevojë që të gjejmë mirëkuptimin dhe mbështetjen e duhur të Kuvendit dhe të institucioneve të tjera shtetërore.

Dëshiroj të garantoj Kuvendin e Shqipërisë se hapat tanë të kohëve të fundit ashtu sikurse edhe ata të pritshëm mbajnë parasysh edhe aspiratën tonë kombëtare për një integrim sa më të shpejtë me Bashkimin Evropian.

Ne tashmë e kemi kuptuar se pa integrim financiar nuk mund të ketë integrim të vërtetë. Vendi ka nevojë për më shumë të ardhura, për më shumë stabilitet politik, për më shumë integrim kulturor dhe social, por sigurisht që po kaq i rëndësishëm është dhe integrimi financiar. E në këtë vështrim, mendoj se roli i institucionit që unë drejtoj, roli i sistemit bankar, i sektorit financiar është shumë parësor dhe sfidat që kemi përpara janë të shumta.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Hapja, zgjerimi dhe modernizimi i tregut primar dhe sekondar të bonove të thesarit

Tiranë, 8 prill 2005

Fillimisht kam kënaqësinë t'iu falenderoj për gatishmërinë e treguar nga ana juaj që gjetët kohën e nevojshme të merrnit pjesë në këtë takim pune. Gjithashtu, nuk do të lija pa falenderuar edhe personelin tuaj teknik, për impenjimin e treguar në trajtimin e kësaj çështjeje, e cila për Bankën e Shqipërisë përbën një nga prioritetet.

Në konferencën e Bankës së Shqipërisë me titull "Banka qendrore në kohën e integrimit", ndër të tjera hodha idenë e nevojës së zhvillimeve cilësore në sistemin bankar dhe financiar, dhe kjo e parë ngushtë edhe me nevojën e rritjes së shkallës së ndërmjetësit të këtij sistemi në ekonomi. Kuptohet që realizimi i kësaj ideje do të kërkonte njëkohësisht dhe dhënien e më shumë mundësive sistemit bankar, në mënyrë që ky sistem të kryente më mirë e më aktivisht rolin e tij.

Në këtë linjë është dhe tema që do të diskutojmë sot. Mund të them me plot gojën që trajtimi i kësaj çështjeje nuk vjen si diçka e papritur, por është rezultat logjik i zhvillimeve pozitive të vërejtura deri tani si dhe i ndërgjegjësimit të sistemit bankar për të qenë më aktiv në rolin që ai mund të luajë në rritjen e besimit të publikut ndaj tij. Nëse vazhdojmë logjikën, kjo rritje besimi do të sillte efektet e veta pozitive dhe në rritjen e aktivitetit bankar të tyre, gjë e cila është në përputhje dhe me objektivin e tyre për të qenë sa më denjësisht në treg.

Në këtë diskutim, nuk do të përqendrohem tek ana teknike e shpjegimit të shkaqeve si dhe të realizimit të procesit, të cilën e quaj të mbuluar nga diskutimet e bëra midis stafeve teknike respektive, por do të fokusohem tek ajo se çfarë ne synojmë të arrijmë dhe rrugën më të shkurtër dhe më të sigurtë, për ta mbyllur me sukses këtë proces. Gjithashtu, do të doja të sqaroja se individët do të vazhdojnë të marrin pjesë në tregun primar të letrave me vlerë si dhe ky treg do të vazhdojë të organizohet nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Çfarë ne synojmë që të arrijmë nëpërmjet këtij procesi:

1. Realizmin e një procesi tranzicioni të butë dhe me më pak kosto në drejtim të ruajtjes së pjesëmarrjes së individëve në tregun primar.
2. Shkurtimin e kohës së realizimit të ankandit të tregut primar të bonove të thesarit.
3. Mundësinë e realizimit në praktikë të parimit "Delivery versus payment" për veprimet që do të kryhen në tregun sekondar dhe me pakicë me bonot e thesarit. Këtu kam parasysh si lehtësimin e procedurave edhe rritjen e sigurisë për përdorimin e këtyre letrave me vlerë si kolateral, nxitjen e tregut ndërbankar dhe të atij të kreditit.
4. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, rritjen e mundësisë së bankave

të nivelit të dytë për të qenë më të pranishme në treg. Bërja e tregut sa më likuid dhe solvent.

Si ne mendojmë që mund të realizohet ky proces:

1. Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë duhet të rishikojnë bazën rregullative që mbulon pjesën e emetimit të bonove të thesarit. Më konkretisht, marrëveshjen midis tyre "Mbi emetimin e bonove të thesarit me formë regjistrimi".
2. Banka e Shqipërisë do të rishikojë rregulloren "Mbi tregun sekondar dhe me pakicë të bonove të thesarit në Shqipëri".
3. Komisioni i Letrave me Vlerë duhet të rishikojë bazën rregullative që lidhet me pjesën e licencimit të regjistruesve të letrave me vlerë.
4. Bankat e nivelit të dytë duhet të procedojnë me Komisionin e Letrave me Vlerë, me qëllim sigurimin e licencës për mbajtjen e regjistrit të letrave me vlerë për individët. Kjo kërkon vullnet të mirë dhe investim.
5. Banka e Shqipërisë, pas përfundimit të këtij procesi, do të përgatisë planin strategjik për kalimin e individëve nga sportelet të saj në drejtim të sporteleve të bankave të nivelit të dytë. Koha që do të ketë në dispozicion Banka e Shqipërisë do të shfrytëzohet edhe për të testuar paraprakisht mendimin e investitorëve "individë".

Në këtë kuadër, do të donim t'iu informonim gjithashtu, se Banka e Shqipërisë po punon që, në një kohë sa më të shkurtër të shohë mundësinë e rritjes së shumës së pjesëmarrjes së individëve, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në tregun primar të bonove të thesarit si edhe vendosjen e një komisioni për veprimet e reja që ata do të kryejnë me të. Niveli i ri si dhe komisioni, do të ndikojnë vetëm individët që do të dëshirojnë të përdorin Bankën e Shqipërisë për të marrë pjesë në tregun primar.

Duke ju falenderuar përsëri për vëmendjen e treguar, do të doja të vazhdonim me diskutime lidhur me hapat që ne mendojmë se duhen hedhur. Në fund të këtij takimi, propozoj të dalim me një plan veprimi konkret për realizimin me sukses të këtij procesi.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Forumi Ndërballkanik i Shoqatave të Bankave
Durrës, 20 maj 2005

Është një kënaqësi e veçantë pjesëmarrja ime në këtë eveniment prestigjioz të sistemit bankar të Rajonit Ballkanik. Kënaqësia është e madhe edhe për një shkak tjetër, sepse për vite me rradhë kam drejtuar Shoqatën e Bankierëve të Shqipërisë dhe për më tepër kam dhënë kontributin tim personal në ideimin dhe organizimin e këtij takimi në Shqipëri. Për këtë, do të doja t'ju falenderoja edhe një herë sot që pranuat ftesën time vitin e kaluar për të organizuar këtë takim në Shqipëri. Natyrisht, gëzimi por edhe përgjegjësia është më e madhe sot që ju drejtohem si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, por për këtë ju lutem të më konsideroni si një prej jush.

Nisur nga ky këndvështrim, sinqerisht do të doja ta filloja fjalën time me urimin: punime të mbara dhe të frytshme të këtij takimi!

Një çështje me rëndësi të veçantë që dëshiroj të diskutoj në këtë takim është ajo e bashkëpunimit rajonal. Ky bashkëpunim është një pararendës i rëndësishëm i procesit të integrimit të rajonit me pjesën tjetër të Evropës.

Besoj se edhe ju ndani të njëjtin mendim me mua, se në këtë mënyrë, rajoni ynë do të jetë më i besueshëm dhe më eficient në realizimin e ëndrrës së tij evropiane.

Në vazhdim të fjalës time do të dëshiroja të adresoja disa çështje të ndryshme me rëndësi për ardhmërinë e sistemit bankar në Shqipëri. Në takimet e ndryshme që ka organizuar Banka e Shqipërisë me komunitetin bankar dhe me aktorë të tjerë sipas rastit, janë theksuar dhe evidentuar një sërë problemesh për të cilat mendoj se ka vend për angazhim të përbashkët, të Bankës së Shqipërisë dhe sigurisht të sistemit bankar.

Nga pozicioni i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, dëshiroj të siguroj komunitetin bankar se institucioni që unë drejtoj është i hapur për një bashkëpunim të institucionalizuar me sistemin bankar, duke e kanalizuar atë nëpërmjet Shoqatës së Bankave të Shqipërisë. Ne e vlerësojmë këtë të fundit dhe shpresojmë se roli i saj në të ardhmen sa do të vijë e do të rritet, veçanërisht në diskutimet parimore që do të karakterizojnë zhvillimin e sistemit bankar dhe të atij financiar në përgjithësi, gjatë viteve të ardhshme.

Besoj se ndani të njëjtin mendim me mua që këto kohët e fundit po bëhemi dëshmitarë të një zhvillimi cilësor të sistemit bankar në Shqipëri. Përfitoj nga ky eveniment që të shpreh se vlerësime pozitive rreth sistemit bankar janë dhënë edhe në raportin e përgatitur nga Banka Botërore dhe FMN, në përfundim të vlerësimit që ata bënë për sektorin financiar në Shqipëri (FSAP). Sigurisht që ky është një lajm i mirë.

Konkluzionet e FSAP, të kësaj pasaporte të rëndësishme ndërkombëtare, janë një tregues i konkluzioneve tona se sistemi financiar në Shqipëri është i karakterizuar nga një sistem bankar i mbikëqyrur dhe efektiv si dhe nga segmentet e tjera, të cilat ende janë në fazat e para të zhvillimit ku kryegjëja mbetet rregullimi dhe mbikëqyrja e tyre. Pavarësisht sa thashë më sipër, sinqerisht duke e ndjerë veten palë me ju, do t'ju bëja apel që të motivohemi akoma më mirë, në mënyrë që më shpejt të arrijmë standarde më të larta bashkëkohore në të gjitha aspektet e akvitetit bankar.

Sistemi bankar gjatë vitit 2004 pësoi zhvillime të spikatura. Pas licencimit të Bankës Popullore, numri i bankave u rrit nga 15 në 16 si dhe është dhënë një licencë paraprake për Union Banka me kapital tërësisht shqiptar, çka mendohet ta rrisë në 17 numrin e bankave gjatë vitit 2005. Aktivet e sistemit u rritën më tej me 14 për qind, ndërkohë që pati shtim të produkteve bankare dhe zgjerim të rrjetit të tyre. Gjatë këtij viti do të shiten aksionet shtetërore në Bankën Italo-Shqiptare dhe në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, gjë që do të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit dhe të konkurrencës bankare, duke hapur rrugën e proceseve të shitblerjeve, të bashkimeve apo të shkrirjeve drejt një konsolidimi të ri të sistemit bankar. Aktiviteti kreditues u rrit me 38 për qind, ku ndër të tjera spikat dhe rritja e ndjeshme e peshës së kredive afatmesme dhe afatgjata kundrejt kredive afatshkurtra.

Harta e mbulimit të vendit me biznes bankar u zgjerua më tej, duke përfshirë rajone të reja të pambuluara më parë. Në fund të vitit 2004, numri total i degëve arriti në 88 ose 11 degë më shumë se fundi i vitit paraardhës, ndërkohë që numri i agjencive për herë të parë regjistroi një numër të plotë treshifror, 100 dhe numri i të punësuarve u rrit me rreth 26 për qind. Rritja e madhe e numrit të degëve krahasimisht me atë të agjencive, tregon se tashmë bankat nuk janë të interesuara vetëm për ofrimin e shërbimit të mbledhjes së depozitave, por edhe për ofrimin e produkteve të tjera si kreditimi i ekonomisë. Këto zhvillime, përveç kontributit pozitiv në rritjen e ndërmjetësimit financiar, tregojnë për një perceptim më të mirë nga ana e bankave të potencialit investues në Shqipëri.

Një zhvillim i spikatur i takon shërbimit të klientelës, i cili nëpërmjet terminaleve elektronike natyrshëm është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të kartave elektronike në qarkullim. Tashmë bankat ofrojnë karta debiti dhe krediti në bashkëpunim me kompanitë ndërkombëtare Visa dhe MasterCard. Gjashtë banka ofrojnë shërbimin e ATM dhe numri i këtyre të fundit, në fund të muajit shkurt 2005, arriti në 108.

Sistemi bankar shfaqet me një nivel fitimi që ka ardhur në rritje në masën 5.1 miliardë lekë. Kthimi mbi kapitalin (ROE) rezultoi në nivelin 21 për qind, ndërkohë që cilësia e kreditit është vetëm në nivelin 4.2 për qind nga 4.6 për qind një vit më parë. Gjithsesi, duhet thënë që kreditë janë ende të reja dhe nuk kanë një histori të mjaftueshme për të treguar ecurinë e tyre.

Megjithatë, problemet dhe sfidat me të cilat përballet sistemi ende janë të shumta dhe roli i shoqatës së bankave mendoj se do të jetë i rëndësishëm në kapërcimin e tyre.

KREDITIMI I EKONOMISË DHE REGJISTRI I KREDIVE

Kredia për ekonominë kohët e fundit ka marrë një zhvillim të madh. Ritmet e larta të rritjes na diktojnë që të jemi të kujdesshëm në drejtimin tjetër, cilësinë e portofolit. Rritja e konkurrencës dhe si pasojë, rritja e shpejtë e nivelit të kredive po mundëson një prirje në rritje të aktiveve të ponderuara me rrezik dhe disa banka tashmë janë pranë nivelit minimum prej 12 për qind.

Identifikimi i klientit, përsa i përket marrjes dhe përdorimit të kreditit si dhe detyrimet e tjera që ai ka ndaj tregut bankar është i vakët, jo i plotë duke mos i dhënë mundësi sistemit bankar të ketë një histori të aktivitetit të klientelës. Prandaj, besoj se ka nevojë për një regjistër të centralizuar të kredive, i cili në ndryshim nga disa më vite më parë sot është kthyer në domosdoshmëri.

Dëshiroj t'ju kujtoj se Banka e Shqipërisë e ka përfshirë projektin e ndërtimit të regjistrit të kredive në planet e saj afatshkurtra dhe jemi thellësisht të angazhuar që ta përfundojmë atë brenda vitit të ardhshëm. Përfitoj nga rasti të theksoj se ky regjistër do të jetë nën administrimin e Bankës së Shqipërisë dhe pjesëmarrja e bankave anëtare të sistemit do të jetë e detyruar. Vetëm kështu, do të shmanget plotësisht evazioni në informacionin statistikor, do të sigurohet integriteti i tij dhe njëkohësisht do të ishte i disponueshëm për secilën nga bankat anëtare të sistemit.

Nga ana tjetër, ne jemi të ndërgjegjshëm se problematika në lidhje me kreditin është më komplekse. Ajo ka të bëjë edhe me pengesa të tjera, që burojnë nga titulli për tokën, nga problemet me regjistrin e kolateralit, me hipotekën, si dhe nga mosnjohja dhe moszbatimi korrekt i proceseve që lidhen me titujt ekzekutivë, veçanërisht në problemet teknike për njohjen dhe ekzekutimin e kolateralit. Për këtë qëllim, ne do të marrim iniciativën për të ngritur një komunikim të vazhdueshëm me sistemin e drejtësisë, duke synuar mbajtjen e një konference të hapur nga vjeshta e këtij viti. Qëllimi kryesor mbetet imponimi i iniciativave ligjore që do të çonin në modifikimin e bazës ligjore dhe të asaj nënligjore, për t'i dhënë një përmasë të re kreditimit të ekonomisë.

MODIFIKIMI I BAZËS RREGULLATORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

E kam deklruar edhe më parë se Banka e Shqipërisë synon të rishikojë bazën e saj rregullatore me qëllimin e vetëm thjeshtimin e saj për të qenë më e lehtë në zbatim.

Për këtë qëllim, kam këmbëngulur vazhdimisht që të vendoseshin kontaktet e para midis stafeve teknike reciproke, për të mbledhur shqetësimet e sistemit bankar lidhur me zbatimin e kuadrit rregullativ.

Pas diskutimeve të shumta është arritur në përfundimin se grupi i rregulloreve të mëposhtme duhet t'i nënshtrohet modifikimeve të nevojshme dhe dua t'ju siguroj se në Bankën e Shqipërisë ka filluar puna për këtë qëllim.

UDHËZIMI METODIK "PËR RREZIQET NGA KËMBIMET VALUTORE";

Vërejtjet: përfshirja në llogaritjen e pozicionit të hapur të garancive jashtë bilancit, të cilat përfshijnë si kufirin e papërdorur të kredisë, angazhimet e financimeve të dhëna dhe të marra, dhe regjistrimet e kolateraleve të vlerësuara në valutë, të marra për garantimin e kredisë (të gjitha bankat në matricë).

Këto janë angazhime, të cilat mbeten në potencë dhe për të cilat, sipas intepretimit të kuadrit rregullativ aktual, bankës i kërkohet të krijojë një pozicion real (brenda bilancit).

Propozohet: të ribëhet udhëzimi metodik duke përjashtuar garancitë.

UDHËZIMI "PËR KAPITALIN RREGULLATOR TË BANKËS";

Vërejtjet: Të bëhet një sistemim më i qartë për zërat që zbriten nga kapitali shtesë se mbi cilën madhësi duhet të llogariten zbritjet. Të dalë qartë në rregullore lidhur me përfshirjen e fitimit të fundit të vitit në kapitalin rregullator, vetëm pas saktësimit nga eksperti i jashtëm kontabël i autorizuar si dhe miratimi i Komitetit të Kontrollit.

Propozohet: të merren në konsideratë të dyja vërejtjet dhe të paraqitet projektvendimi për ndryshimin e rregullores.

RREGULLORJA "PËR MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT";

Vërejtje: Është pak konfuz klasifikimi i vendeve. Një herë referimi bëhet për vendet e OECD dhe një herë tjetër jepet një listë me 29 anëtarë, ndërkohë që kolaterali në formë *cash*-i nuk merret në konsideratë si element zbritës në llogaritjen e aktiveve të ponderuara me rrezikun. Koncepti i kredive hipotekare që ponderohen me 50 për qind është shumë i ngushtë dhe krijon konfuzion.

Propozohet: të merren në konsideratë vërejtjet dhe të paraqitet projektvendimi për ndryshimin e rregullores.

RREGULLORJA "PËR RREZIQET E TREGUT";

Propozohet: të rishikohet në kuadër edhe të rekomandimeve të reja të Bazel II.

Duke qëndruar edhe një herë tek problemi i mbikëqyrjes bankare, dëshiroj të theksoj se ne si institucion mbikëqyrës jemi të vendosur që të kemi në maksimumin e mundshëm një mbikëqyrje të fortë, të thjeshtë dhe të lehtë për t'u zbatuar, të shoqëruar këtë me një përmirësim të ndjeshëm të inspektimit në vend. Ne do të synojmë që fuqia parashikuese dhe parandaluese e mbikëqyrjes sonë të fitojë një përmasë tjetër. Për këtë qëllim, ne jemi duke përfunduar negociatat me institucionet evropiane partnere, për lançimin e një projekti binjakëzimi për fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë.

FUSHATA ANTI-*CASH*

Zhvillimet e kohëve të fundit kanë patur efektet e tyre në reduktimin e sasisë së parasë *cash* në ekonomi. Nga ana tjetër, kemi zhvilluar një aktivitet të dendur publik, me karakter sqarues dhe promovues, ku nuk kanë munguar edhe takimet e një natyre tjetër, ku ne si sistem bankar së bashku jemi angazhuar konkretisht. Më lejoni t'ju kujtoj takimet e hapura që kemi bërë me biznesin e shërbimeve utilitare si dhe atë në lidhje me veprimtarinë e tregut primar të bonove të thesarit.

Duke përfituar nga ky rast do të dëshiroja që të sillja edhe një herë në vëmendjen tuaj problemet e ngritura edhe më herët. Shpresoj që tashmë, në prag të përfundimit të projektit të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël, secila bankë më vete dhe shoqata nga ana e saj, po mendojnë seriozisht për të rritur shkallën e përfitimit nga kjo lehtësi e re që po ofron Banka e Shqipërisë në këtë moment. Do të isha i ndihmuar nëse nga ana e shoqatës do të kisha komente apo reagime të mundshme në lidhje me përgatitjet e sistemit si dhe me asistencën e bashkëpunimin mundshëm të Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim.

Pas përfundimit të këtij projekti, them se duhet të mendojmë më me seriozitet për shtimin numerik dhe cilësor të pagesave elektronike. Për këtë qëllim, do t'ju bëj thirrje që të filloni të mendoni që tani, në lidhje me projektet e ardhme në infrastrukturën e pagesave. Unë personalisht do të këmbëngul që edhe në këtë drejtim ne si sistem bankar të hedhim sytë nga direktivat e Bashkimit Evropian, me qëllim që çdo hap i yni në të arshmen të jetë i prirur drejt integrimit të vendit me Bashkimin Evropian.

Pak kohë më parë jam njohur me një iniciativë të re të Bashkimit Evropian, e cila kërkon që brenda një periudhe kohe të caktuar, ndërmjet të tjerash të ndërtohet një sistem i unifikuar i pagesave brenda Eurozonës, duke përfshirë edhe pagesat me kartë. Aktualisht, sot bizneset e vogla dhe të mesme në Eurozonë nuk kanë të njëjtat mundësi për pagesa sikurse kanë në vendet e tyre në nivel kombëtar. Një rast i tillë është edhe me kartat e kreditit, të cilat nuk mund të përdoren njëlloj përtej kufijve. Për këtë qëllim, do të sugjeroja që specialistët përkatës nga shoqata dhe Banka e Shqipërisë të njihen sa më shpejt me këtë projekt, duke na sjellë dhe sugjerimet e tyre në këtë drejtim.

Unë personalisht, mbetem konstant në qëndrimin tim se ne në Shqipëri duhet të adoptojmë zgjidhjet më të përparuara në të gjitha projektet infrastrukturore që do të zbatojmë. Besoj se nuk kemi pse të marim në shqyrtim modele të vjetëruara tashmë, të cilat përveç kostos fillestare do të kërkonin vazhdimisht fonde të tjera për mirëmbajtjen dhe modifikimin e tyre.

Përveç zhvillimeve në fushën e pagesave do të kërkoja angazhimin tuaj më të madh edhe në drejtime të tjera. Mendoj se sistemi duhet ta shtrijë më tej mbulimin e tij gjeografik, duke synuar edhe zona të cilat ndonëse në pamje të parë duken të fjetura, mbartin potenciale të mëdha financiare në formën e kursimeve të thesarizuara jashtë sistemit.

Po kështu, edhe niveli i shërbimeve duhet të përmirësohet më tej. Tashmë që administrata publike është bërë kliente e sistemit, mendoj se ka mundësi reale për të zgjidhur nëpërmjet sistemit bankar pagesat e shërbimeve utilitare.

Shpresoj që sistemi do të jetë agresiv dhe do t'i mbajë premtimet e tij publike për të vënë sportelet e tij në shërbim të shitjes së bonove thesarit, drejtpërdrejt publikut të interesuar. Ne si Bankë e Shqipërisë i kemi mbajtur premtimet e tona dhe shumë shpejt, si hap të parë, do të paraqesim një komision, i cili presupozon mbulimin e kostos së transaksionit, ndërkohë që këtë masë do ta shoqërojmë me ndalimin e arkëtimit të prurjeve *cash* në sportelet e Bankës së Shqipërisë. Ne do t'u kërkojmë individëve që pjesëmarrja e tyre në ankand, nëpërmjet sportelit të Bankës së Shqipërisë, do të bëhet e mundur vetëm nëpërmjet paraqitjes së një dokumenti bankar, që tregon se klienti ka ngurtësuar një shumë të caktuar në njërën nga bankat e sistemit.

Një drejtim tjetër ku bankat duhet të përqëndrohen më shumë, ka të bëjë me një agresivitet më të madh propagandistik dhe sqarues. Mendoj se ende shumica e njerëzve të thjeshtë, shfaq një lloj hezitimi për t'iu drejtuar bankës. Besoj se ata kanë një ndjenjë mosbesimi se banka nuk do t'ua zgjidhë hallin atyre. Shumë individë, ndonëse në mënyrë absurde, ende janë në kërkim të "një miku" për të negociuar me bankën.

Për çfarë thashë më sipër, e kuptoj që mbi të gjitha, shkak mund të jetë tradita jonë e varfër shtoi kësaj dhe shkallën e lartë të informalitetit e plot shkaqe të tjera objektive e subjektive. Megjithatë, mendoj se shkak mund të jetë edhe mungesa e sqarimeve të detajuara të rastit, edhe mungesa e publikimeve edukative, edhe mungesa e propagandës në ambiente publike si dhe në media.

Mendoj se në hapësirat propaganduese në media më shumë vend duhet të zërë sqarimi i produkteve të veçanta, ndërkohë që edhe lançimi i produkteve të reja duhet shoqëruar me fushata publicitare standarde.

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni që në mbyllje të fjalës time, të shpreh edhe një herë konsideratën e lartë që unë kam për Shoqatën e Bankierëve të Shqipërisë, duke e garantuar atë se tek Guvernatori i Bankës së Shqipërisë do të gjejë një partner të denjë në rrugën e gjatë të bashkëpunimit institucional.

Sinqerisht, shpresoj se kjo mbledhje e shoqatave të rajonit është një hap i rëndësishëm në drejtim të instalimit të një bashkëpunimi dhe kooperimi të frytshëm rajonal.

Unë personalisht, angazhohem që në kontaktet e mija me kolegët e rajonit do t'i lë një vend të veçantë këtij kooperimi, duke shpresuar se do të gjej mirëkuptimin dhe mbështetjen e plotë të tyre.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Takimi Vjetor 2005 dhe Forumi i Biznesit të BERZH-it
Beograd, 22 maj 2005

Është një kënaqësi e veçantë pjesëmarrja ime në këtë eveniment prestigjioz të Takimit Vjetor 2005 dhe Forumit të Biznesit të BERZH-it. Për këtë, do të doja të falenderoja organizatorët e këtij takimi që na krijuan këtë mundësi për të paraqitur arritjet si dhe ambiciet tona për të ardhmen.

Më lejoni që së pari të prek një çështje të rëndësishme, që në kontekstin e këtij takimi vlerësoj se merr një rëndësi të veçantë. E kam fjalën për bashkëpunimin rajonal, një iniciativë që ka gjetur mbështetjen e plotë të Bankës Qendrore Evropiane. Ne kemi hedhur hapat e parë në këtë drejtim nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve në fushën e mbikëqyrjes bankare me Bankën Kombëtare të Maqedonisë, Bankën Qendrore të Malit të Zi dhe me Autoritetin e Bankave dhe Pagesave të Kosovës. Ndërkohë, jemi në proces negocimi me Bankën Kombëtare të Bosnjës dhe Hercegovinës, atë të Serbisë etj.. Vlerësoj se bashkëpunimi rajonal është një pararendës i rëndësishëm i procesit të integrimit të rajonit me pjesën tjetër të Evropës, prandaj nuk do të rresht së punuari për të nxitur krijimin e standardeve të larta në bashkëpunimin rajonal midis sistemeve financiare të vendeve të Ballkanit.

Besoj se edhe ju ndani të njëjtin qëndrim me mua, se vetëm kështu, rajoni ynë do të jetë më i besueshëm dhe më eficient në realizimin e ëndrrës së tij evropiane. Nga ana tjetër, një rajon i zhvilluar dhe i integruar financiarisht do të jetë më atraktiv për investitorët e huaj strategjikë, duke iu hapur rrugën projekteve rajonale të zhvillimit, veçanërisht atyre infrastrukturore, ku bankat e rajonit mund të jenë edhe financuese ose bashkëfinancuese.

Në vazhdim të fjalës time do të dëshiroja të përshkruaja shkurtimisht disa çështje që kanë të bëjnë me arritjet e kohëve të fundit të sistemit bankar në Shqipëri. Pas shumë vitesh tranzicioni të vështirë, në këtë pranverë të vitit 2005 sistemi ynë bankar është duke u zhvilluar mbi baza të shëndosha.

Do të doja t'ju siguroja se këto kohët e fundit ka patur mjaft zhvillime cilësore të sistemit bankar në Shqipëri. Përfitoj nga ky eveniment që të shpreh se vlerësime pozitive rreth sistemit bankar janë dhënë edhe në raportin e përgatitur nga Banka Botërore dhe FMN, në përfundim të vlerësimit që ata bënë për sektorin financiar në Shqipëri (FSAP). Sigurisht që ky është një lajm i mirë.

Konkluzionet e FSAP, të kësaj pasaporte të rëndësishme ndërkombëtare, janë një tregues i konkluzioneve tona se sistemi financiar në Shqipëri është i karakterizuar nga një sistem bankar i mbikëqyrur dhe efektiv. Pavarësisht sa thashë më sipër, sinqerisht duke e ndjerë veten pjesë të sistemit bankar do të vlerësoja se ai ka nevojë të motivohet akoma më mirë, në mënyrë që të arrijmë më shpejt standarde më të larta bashkëkohore në të gjitha aspektet e akvitetit bankar.

Sistemi bankar ka njohur zhvillime të spikatura kohët e fundit. Pas licencimit të Bankës Popullore, me kapital shqiptar, numri i bankave u rrit nga 15 në 16, si dhe është dhënë një licencë paraprake për Union Bank me kapital tërësisht shqiptar, çka mendohet ta rrisë në 17 numrin e bankave gjatë vitit 2005. Aktivet e sistemit u rritën më tej me 14 për qind, ndërkohë që pati shtim të produkteve bankare dhe zgjerim të rrjetit të tyre pas privatizimit të suksesshëm të Bankës së Kursimeve nga Reiffeisen Bank, Austri. Gjatë këtij viti do të shiten aksionet shtetërore në Bankën Italo-Shqiptare dhe në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, gjë do të bëjë të mundur rritjen e efektivitetit dhe të konkurrencës bankare, duke hapur rrugën e proceseve të shitblerjeve, të bashkimeve apo të shkrirjeve drejt një konsolidimi të ri të sistemit bankar.

Aktiviteti kreditues u rrit me 38 për qind, ku ndër të tjera spikat dhe rritja e ndjeshme e peshës së kredive afatmesme dhe afatgjata kundrejt kredive afatshkurtra.

Harta e mbulimit të vendit me biznes bankar u zgjerua më tej, duke përfshirë rajone të reja të pambuluara më parë. Në fund të vitit 2004, numri total i degëve arriti në 88 ose 11 degë më shumë se fundi i vitit paraardhës, ndërkohë që numri i agjencive për herë të parë regjistroi një numër të plotë treshifror, 100 dhe numri i të punësuarve u rrit me rreth 26 për qind.

Rritja e madhe e numrit të degëve krahasimisht me atë të agjencive, tregon se tashmë bankat nuk janë të interesuara vetëm për ofrimin e shërbimit të mbledhjes së depozitave, por edhe për ofrimin e produkteve të tjera si kreditimi i ekonomisë. Këto zhvillime, përveç kontributit pozitiv në rritjen e ndërmjetësimit financiar, tregojnë për një perceptim më të mirë nga ana e bankave të potencialit investues në Shqipëri.

Një zhvillim i spikatur i takon shërbimit të klientelës, i cili nëpërmjet terminaleve elektronike natyrshëm është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të kartave elektronike në qarkullim. Tashmë bankat ofrojnë karta debiti dhe krediti në bashkëpunim me kompanitë ndërkombëtare Visa dhe MasterCard. Gjashtë banka ofrojnë shërbimin e ATM dhe numri i këtyre të fundit, në fund të muajit shkurt 2005, arriti në 108.

Sistemi bankar shfaqet me një nivel fitimi që ka ardhur në rritje në masën 5.1 miliardë lekë. Kthimi mbi kapitalin (ROE) rezultoi në nivelin 21 për qind, ndërkohë që cilësia e kreditit është vetëm në nivelin 4.2 për qind nga 4.6 për qind një vit më parë.

Këto zhvillime pozitive të sistemit bankar janë shoqëruar nga një mjedis të shëndoshë makroekonomik. Për disa vite rritja ekonomike ka qenë në nivelin 6 për qind, ndërsa inflacioni është mbajtur nën kontroll brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë në intervalin 2-4 për qind. Konsolidimi fiskal ka qenë në rrugë të mbarë, ndërsa deficiti tregtar aktual është financuar kryesisht nga remitancat dhe hyrjet e investimeve të huaja direkte. Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol kryesor për të siguruar këtë mjedis makroekonomik. Që nga fillimi i vitit 2003, ne kemi ulur disa herë normën bazë të interesit, duke e

sjellë atë në minimumin e saj historik, në nivelin 5 për qind. Në marrjen e çdo vendimi të politikës monetare, ne kemi patur parasysh gjallërimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik, duke u kujdesur gjithmonë për zhvillimet inflacioniste dhe për stabilitetin financiar.

Siç do të doja ta përmendja shpesh, në kancelaritë e FMN-së Shqipëria konsiderohet si një histori e suksesshme. Bordi i drejtorëve ka deklaruar kohët e fundit se Shqipëria është e maturuar sa duhet për të nënshkruar një marrëveshje trevjeçare nga fundi i këtij viti. Marrëveshja e re do të jetë më fleksibël, duke i krijuar Shqipërisë mundësinë për një akses më të mirë në tregun financiar ndërkombëtar.

Sigurisht, ajo që përmenda më lart është thjesht një përmbledhje e shkurtër e situatës së tanishme të sistemit bankar dhe të zhvillimit ekonomik në tërësi. Nuk ka dyshim që atraktiviteti i Shqipërisë është shtuar dhe kjo pjesërisht, pasqyron edhe rritjen e besimit në sistemin bankar në Shqipëri.

Duke përfituar nga rasti i mbajtjes së këtij forumi prestigjioz, do të doja të bashkoja zërin tim me zërin e përfaqësuesve shqiptarë të pranishëm në këtë panel, duke shprehur që vendi im është më i hapur, më i konsoliduar, i gatshëm për të thithur projekte edhe më ambicioze dhe, sigurisht, projekte globale.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Ditën e Biznesit të vendeve të Rajonit të Detit të Zi në Erevan, Armeni
6 qershor 2005

Është një kënaqësi e veçantë për mua që më jepet rasti të marr pjesë në këtë takim rajonal të vendeve të Detit të Zi. Gjithmonë e kam vlerësuar këtë nismë si një mundësi të jashtëzakonshme për të gjitha vendet e përfshira në të.

Në karrierën time të gjatë, kam kuptuar se suksesi i këtij biznesi në përgjithësi, qëndron në aftësinë e tij për të krijuar besim tek publiku. Megjithatë, një rol po kaq të rëndësishëm luan edhe ambienti i përgjithshëm ekonomik, politik dhe social i vendit. Gjatë karrierës time kam qenë dëshmitar i shumë ngjarjeve, të cilat kanë dëmtuar sistemin bankar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Kolapsi monetar i sistemit bankar në fund të periudhës së komunizmit, lulëzimi dhe degjenerimi i skemave mashtruese të investimit, si dhe shumë probleme të tjera sociale, politike dhe ekonomike që kanë shoqëruar tranzicionin në Shqipëri, kanë bërë që reputacioni i sistemit bankar të fitohet me vështirësi në kalimin e viteve. Por, ai u fitua. Mjafton t'i referohem episodit më të fundit problematik në Shqipëri, pranverës së vitit 2002, kur si rezultat i mosinformimit të publikut dhe spekulimit politik me ligjin "Për sigurimin e depozitave", u krijua një tronditje e besimit të depozituesve të thjeshtë, që çoi në një rrjedhje të konsiderueshme të depozitave nga sistemi bankar.

E pra, duke parë të gjithë treguesit statistikorë, rezulton se sistemi bankar në atë kohë ishte i shëndoshë dhe në rritje të vazhdueshme. Por, e gjitha kjo ishte e pamjaftueshme përderisa gjurmët e vitit '97 (kolapsi i skemave piramidale) ishin afër dhe sensibiliteti i qytetarëve të thjeshtë ndaj tyre ishte shumë i lartë.

Pavarësisht arritjeve të admirueshme të kohëve të fundit do të dëshiroja të theksoja faktin që ekonomia jonë dhe gjithë rajoni është ende i brishtë. Si rrjedhojë, mendoj që ne duhet të jemi shumë më të matur dhe shumë më të kujdesshëm kur flasim për stabilitetin financiar të vendit. Ndër të tjera, ky episod tregon domosdoshmërinë e shoqërimit të reformave me hapa konkretë parapërgatitorë dhe sigurisht të kombinuar edhe me plane mbështetjeje (back up plan) në rast dështimi. Për këtë qëllim, tregu ka nevojë që të përgatitet intensivisht që në fazat e para të zbatimit të reformave. Është e rëndësishme që vetë vendimmarrësit të njohin paraprikisht sjelljen dhe ndjenjat e tregut.

Pranverën e fundit Shqipëria iu nënshtrua vlerësimit të sektorit të saj financiar nga ana e një misioni të përbashkët të FMN-së dhe BB-së (FSAP). Në raportin përkatës të përgatitur prej këtij misioni thuhet se sektori financiar konsiston kryesisht në një sistem bankar të rregulluar dhe të mbikëqyrur. Ky konkluzion mbështetet edhe nga rezultatet e stress testit bërë sistemit, nga ku

rezulton se shkalla e ekspozimit të sistemit ndaj rreziqeve të ndryshme është relativisht e ulët.

Sistemi bankar ka shënuar zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2004. Pas lincencimit të Bankës Popullore, me një kapital shqiptar, numri i bankave u rrit nga 15 në 16, dhe një licencë paraprake dhënë Bankës Union pritet ta rrisë këtë numër në 17, gjatë vitit 2005. Asetet e sistemit janë rritur me 14 për qind[1], ndërkohë që ka pasur edhe një rritje të produkteve bankare dhe një zgjerim të degëve të tyre. Gjatë këtij viti do të privatizohen aksionet shtetërore të Bankës Italo-Shqiptare dhe të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, duke i hapur rrugën procesit të shitjes, të bashkimit dhe të përvetësimit drejt një konsolidimi të ri të sistemit bankar.

Aktiviteti kreditues është rritur me 38 për qind, ku mund të vihet re ndër të tjera rritja e rëndësishme e kredive afatmesme dhe afatgjata krahasuar me ato afatshkurtra.

Harta e mbulimit të vendit me sistem bankar ka ardhur duke u zgjeruar, duke përfshirë zona të reja të pambuluara më parë. Në fund të vitit 2004, numri i përgjithshëm i degëve arriti 88 ose 11 degë më shumë se ai i një fundviti më parë, ndërsa numri i agjencive të regjistruara për herë të parë arriti një numër treshifror, 100 dhe numri i të punësuarve u rrit me 26 për qind.

Rritja e lartë e numrit të degëve sipas agjencive tregon se bankat nuk janë të interesuara vetëm të sigurojnë shërbimin e mbledhjes së depozitave, por gjithashtu edhe në sigurimin e produkteve si për shembull, kreditimi i ekonomisë. Këto zhvillime, përveç kontributit të tyre pozitiv në përforcimin e ndërmjetësimit financiar, flasin edhe për një perceptim më të mirë të potencialit investues të bankave në Shqipëri.

Një zhvillim i rëndësishëm mbetet ai në lidhje me shërbimin e klientit, i cili shoqërohet me terminale elektronike duke rritur numrin e kartave elektronike në qarkullim. Bankat tashmë ofrojnë karta debiti dhe krediti në bashkëpunim me kompanitë ndërkombëtare si për shembull, Visa dhe MasterCard. Gjashtë banka sigurojnë shërbimin ATM dhe numri i ATM-ve, ka arritur në 108, në fund të muajit shkurt të vitit 2005.

Sistemi bankar rezulton se ka një nivel fitimi me një vlerë prej 5.1 bilionë lekësh. Fitimi mbi kapitalin vlerësohet të ketë qenë në nivelin 21 për qind, ndërsa cilësia e kredisë ka qenë vetëm 4.2 për qind, nga 4.6 për qind e një viti më parë. Nga ana tjetër, ne duhet të themi se kreditë janë relativisht të reja dhe nuk kanë një histori të përshtatshme për të shfaqur performancën e tyre.

Ndërkohë, për pjesën tjetër të sistemit financiar, raportet e FSAP vlerësojnë se problematika është e madhe dhe ka të bëjë me shumë çështje njëherësh

[1] *Shifrat e përdorura në këtë fjalim janë marrë nga burime të ndryshme: Banka e Shqipërisë "Raporti i Mbikëqyrjes Bankare, tremujori i katërt 2004"; Komisioni Evropian "Ballkani Perëndimor në tranzicion", Materiali i zgjerimit Nr. 23, dhjetor 2004; BERZH, "Raporti i tranzicionit 2004".*

përfshi dhe çështje thelbësore si mbikëqyrja e tyre. Ndonëse aktualisht për shkak të përmasave të vogla, kjo problematikë nuk paraqet rreziqe të menjëhershme, përsëri ato duhen analizuar dhe kuruar me kujdes.

Duke iu kthyer edhe FSAP-ve të kryera në vendet të tjera të ngjashme me Shqipërinë (kryesisht i referohem vendeve të Evropës Juglindore) si dhe shumë raporteve të tjera financiare kuptohet se kjo problematikë është e ngjashme dhe pak a shumë këto vende vuajnë nga simptoma të njëjta. Nuk ka si të ndodhë ndryshe po të kthejmë kokën e të shohim në historinë e vjetër dhe atë më të afërt. Tradita rajonale është e varfër, me trashëgimi të pakët në institucione, në rregulla, sjellje të tregut dhe ndërmjetësim financiar. Megjithatë, sot rreth 15 vjet pas shthurjes së madhe të sistemit komunist duket se vendet e Evropës Juglindore kanë hyrë në një proces të pakthyeshëm të stabilizimit dhe të integrimit të tyre me pjesën tjetër të Evropës.

Në vazhdim do të përpiqem të bëj një përmbledhje të disa prej karakteristikave kryesore që dallojnë sistemet financiare të këtyre vendeve.

- Sistemi financiar në të gjitha vendet e rajonit dominohet nga bankat tregtare. Segmentet e tjera të tij, përfshirë si institucionet ashtu dhe tregjet luajnë një rol të dorës së dytë. Mjeti më i preferuar i financimit mbetet ende kredia bankare, ndërkohë që shkalla e ndërmjetësimit financiar vazhdon të jetë e ulët.

Sektori i sigurimeve është akoma në një fazë fillestare dhe nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin financiar. Aktualisht, ky sektor mbizotërohet nga sigurime të tjera të ndryshme nga sigurimi i jetës, veçanërisht ato të mjeteve motorike. Në të njëjtën kohë, duke marrë në konsideratë madhësinë e tregut, ai paraqitet mjaft i copëtuar, por me një numër gjithnjë e në rritje të ofruesve të këtij shërbimi (88 kompani sigurimi në gjithë rajonin në vitin 2003).

Tregjet e kapitalit në rajon janë ende në një zhvillim embrional. Gjashtë bursa operojnë në rajon ndërkohë që ajo e Tiranës ende nuk po arrin të bëhet efektive. Sidoqoftë, të gjitha këto bursa janë shumë të vogla për sa i përket nivelit të kapitalizimit si dhe akoma edhe më të vogla për sa i përket likuiditetit të tregut. Edhe fondet e pensionit nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm, pasi shumica e vendeve të rajonit nuk kanë futur në përdorim skemat e pensionit me tre shtylla. Rëndësia mjaft e kufizuar e shërbimeve financiare jobankare shfaqet edhe në vlerësimin[2] e BERZH-it për sektorin financiar jobankar në vendet e rajonit gjatë vitit 2004, i cili i ka vlerësuar këto vende mesatarisht me notën 2, një vlerë kjo diku në mes të niveleve ekstrem.

- Privatizimi i sektorit bankar ka përparuar gjatë viteve të fundit dhe gradualisht një pjesë e madhe e këtij sektori ka kaluar në pronësi të huaj, edhe pse jo në mënyrë të barabartë ndërmjet vendeve.

[2] *Treguesit e tranzicionit të BERZH-it lëvizin nga 1 deri tek 4+, ku 1 tregon pak progres në reformën e sektorit financiar. Për sektorin bankar, 4+ përfaqëson përshtatje të plotë të ligjeve dhe të rregulloreve bankare me standardet e BIS-it si dhe një grup të plotë dhe të zhvilluar të shërbimeve bankare. Për sektorin jobankar, 4+ përfaqëson përshtatjen e plotë të ligjeve dhe rregullave të letrave me vlerë me standardet ndërkombëtare si dhe një ndërmjetësim financiar plotësisht të zhvilluar.*

Deri në fillim të vitit 2004, me përjashtim të Serbisë dhe Malit të Zi, pronësia shtetërore përbënte më pak se 15 për qind të kapitalit të përgjithshëm. Kjo ulje e ndjeshme e kapitalit shtetëror në sistemin bankar ka ardhur kryesisht si pasojë e privatizimeve, të cilat në pjesën më të madhe janë blerë nga investitorë strategjikë të huaj. Personalisht, jam i mendimit se privatizimi i sistemit bankar ka rritur ndjeshëm eficiencën e politikave tona monetare, duke i bërë ato të orientuara më shumë drejt tregut.

Nga ana tjetër, duket qartë se numri i bankave në rajonin tonë është ende i lartë. Në vitin 2002, numri mesatar i bankave në vendet e Ballkanit Perëndimor ishte 26, shumë i ngjashëm me atë të vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian, ku kjo mesatare ishte 27. Duke krahasuar madhësinë e ekonomive të vendeve të rajonit tonë me madhësinë e ekonomive të vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian, kuptohet që numri mbetet i lartë dhe si rrjedhojë, lë hapësirë për një konsolidim të mëtejshëm. Ndoshta ka ardhur koha që të përballemi me një proces shkrirjesh dhe përvetësimesh, të cilin mund ta nxisim nëpërmjet kërkesave për një kapitalizim më të madh dhe nëpërmjet një konkurrence gjithnjë e në rritje.

- Zhvillimet në sektorin bankar kanë kontribuar në një rritje domethënëse dhe të vazhdueshme të ndërmjetësimit financiar në rajon. Ky proces shoqëron nga afër përparimin e përgjithshëm të arritur në tranzicionin ekonomik dhe në zhvillimin e rajonit. Sidoqoftë, rritja e kreditimit është e drejtuar kryesisht drejt konsumatorëve dhe më pak drejt sektorit të korporatave.

Sektorët bankarë të vendeve të rajonit mbeten ende relativisht të vegjël, krahasuar me vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian. Në vendet e rajonit, sektori bankar përbën 46.9 për qind të PBB-së rajonale, ndërsa për vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian kjo shifër ishte 64 për qind e PBB-së për vitin 2002. Sidoqoftë, ka një rritje të ndërmjetësimit financiar në rajon, edhe pse nuk ka rritje të dukshme në asetet e përgjithshme të sektorit bankar.

Raporti kredi/depozita vazhdon të rritet nga njëri vit në tjetrin, fakt ky që tregon gatishmërinë në rritje të bankave për të zgjeruar veprimtarinë krediduese me ritme më të shpejta se sa rritja e kursimeve. Megjithatë, mesatarja e raportit kredi/depozita për rajonin është ende poshtë niveleve të vendeve të reja anëtare të Bashkimit Evropian (76.2 për qind për Ballkanin Perëndimor dhe 111 për qind për vendet e reja anëtare në Bashkimin Evropian).

Kredidhënia ka pësuar rritje në pjesën më të madhe të tregjeve të rajonit midis viteve 2001 dhe 2003.

Rritja në kredidhënie në përgjithësi është shoqëruar me një rritje të shpejtë në kredinë konsumatore, ndërkohë që kredidhënia për korporatat është rritur më ngadalë. Megjithatë, për shkak të nivelit të ulët fillestar të kredisë konsumatore, kredidhënia për korporatat në vitin 2003 ende përfaqësonte mbi 75 për qind të portofolit të kredisë së bankave për sektorin privat dhe kjo shumë është dhënë kryesisht në valutë. Një tjetër ndryshim strukturor në

portofolet e kredisë ka të bëjë me prirjen në rritje drejt kredive afatgjata, të cilat në të paktën tre vende të rajonit (Shqipëri, Maqedoni dhe Bosnjë) përbënin 50 për qind ose më shumë të totalit të kredive.

Pavarësisht rritjes së kredidhënies në të gjithë rajonin, totali i kredisë në vitin 2003 ishte vetëm sa gjysma e përqindjes së kredisë në vendet e reja anëtare në Bashkimin Evropian (23.5 për qind krahasuar me 47.5 për qind të PBB-së). Kjo do të thotë se megjithë zgjerimin e tyre të shpejtë të kohëve të fundit, sektori bankar në Ballkanin Perëndimor ende luan një rol të kufizuar në financimin e nevojave të ekonomive për investime.

Një nga arsyet kryesore, që pengon rritjen e ndërmjetësimit financiar, është niveli i lartë i ndryshimit ndërmjet normave të interesit të depozitave dhe atyre të kredive. Ka shumë shpjegime për këtë situatë si për shembull, mungesa e eficiencës dhe e konkurrencës midis bankave, rreziku i lartë i kreditimit të ekonomive në këtë fazë të tranzicionit, problemet me kolateralin, funksionimi i sistemit ligjor etj.. Megjithatë, vlen të theksohet se ndryshimi midis normave të interesit të depozitave dhe kredive ka pësuar ulje vitet e fundit, duke treguar një përmirësim gradual të gjendjes.

- Sektori bankar, sipas standardeve ndërkombëtare, është ende i vogël dhe i brishtë. Fakti që qëndrueshmëria ekonomike dhe politike ka qenë një çështje gjithnjë në pikëpyetje, ka ndikuar negativisht në kreditimin afatgjatë të ekonomisë. Në të njëjtën kohë, kreditë e këqija, veçanërisht në disa tregje, janë ende të larta dhe norma e fitimit nga aktivitetet kryesore bankare është e ulët. Në të njëjtën kohë, disa dobësi të sistemit gjyqësor pengojnë zbatimin e kontratave dhe përdorimin e kolateralit dhe për pasojë, pengojnë rritjen e mëtejshme të aktivitetit kreditues.

Reforma në sektorin bankar në rajon po përparon, me një fokus të veçantë mbi përmirësimin e rregullimit dhe të mbikëqyrjes së këtij sektori. Përpjekjet tani po zhvendosen nga përmirësimi i legjislacionit në lidhje me veprimtarinë e bankave drejt një fokusi më të gjerë, mbi rreziqet ndaj të cilave bankat janë të ekspozuara si dhe mbi mënyrën se si do të adoptohet një përqasje më e orientuar drejt rrezikut, si brenda vetë bankave ashtu edhe për sa i përket mbikëqyrjes së sektorit bankar. Në kuadër të forcimit të sektorit bankar dhe në kontekstin e një besueshmërie të ulët ndaj sektorit bankar të trashëguar nga e kaluara , ka pasur zhvillime të rëndësishme në lidhje me zbatimin e plotë të skemave të sigurimit të depozitave pothuajse në të gjitha vendet e rajonit.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive të reformave në sektorin bankar, mbetet akoma shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. Reformat strukturore nuk duhet të mbeten thjesht slogane. Gjithësecili duhet të gjejë brenda tyre listën e prioriteteve të momentit dhe të perspektivës, që karakterizojnë ekonomitë e ndryshme të çdo vendi të rajonit. Duke iu referuar Shqipërisë, mendoj se shumë pengesa burojnë nga mungesa e regjistrit të kolateralit, nga pasaktësitë nëpër hipoteka, nga mosnjohja dhe mosfunksionimi korrekt i sistemit gjyqësor dhe atij të drejtësisë, veçanërisht në lidhje me problemet teknike që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e kolateralit.

Për këtë qëllim, mendoj se ndërmarrja e reformave në këtë drejtim është shumë e rëndësishme. Zgjidhja e këtyre problemeve do të ndihmonte jo vetëm sistemin bankar që të jetë më i sigurtë në procesin e kredidhënies, por edhe sektorin shumë të rëndësishëm bujqësor që të rrisë kontributin e tij në totalin e prodhimit të përgjithshëm.

Përqindja e kredive të këqija mbetet ende e lartë, me një mesatare rajonale prej 14 për qind të të gjithë portofolit të kredive për vitin 2003, megjithëse ka patur një përmirësim të vazhdueshëm krahasuar me vitet e mëparshme, si pasojë e privatizimit të këtij sektori si dhe e uljes së ndikimit politik në dhënien e kredive.

Sidoqoftë, norma e fitimit ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, përveç një vendi, norma e fitimit ishte pozitive kudo gjatë vitit 2003. Në disa vende, të ardhurat nga aktivitetet kryesore bankare ishin ende të ulëta ose negative në vitin 2003, dhe kryesisht janë kompensuar nga fitimi i bërë nga operacionet jobankare.

Niveli i lartë i rrezikut në veprimet bankare pasqyrohet gjithashtu, edhe në raportet e larta të mjaftueshmërisë së kapitalit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Mesatarja rajonale prej 27.5 për qind në vitin 2003 është e lartë në krahasim me mesataren prej 14 për qind të vendeve të reja anëtare në Bashkimin Evropian. Megjithëse këto norma të larta mund të krijojnë një siguri për sa i përket pasjes së një sistemi bankar të shëndoshë, ato konfirmojnë nivelin e lartë të rrezikut të kreditimit, të shkallës së lartë të likuiditetit dhe të përbërësve jobankarë në bilancet e bankave. Sidoqoftë, bankat e vogla dhe vendase kanë një normë më të lartë krahasuar me bankat në pronësi të huaj dhe në të njëjtën kohë, raporti mesatar i mjaftueshmërisë është ulur tre vitet të fundit, duke pasqyruar një administrim më të mirë të rrezikut të kreditit.

- Ekonomitë e rajonit, vetëm vonë kanë, filluar të integrohen më nga afër me tregjet financiare ndërkombëtare. Huamarrja ose huadhënia ndërkufitare, ose forma të tjera të flukseve financiare ndërkombëtare, janë ende relativisht të vogla.

Me stabilizimin e ekonomisë dhe me riklasifikimin e borxheve, vendet së bashku me sektorët e tyre financiarë kanë filluar të integrohen gradualisht në tregjet botërore. Indeksimi i aftësisë së shërbimit të borxhit nga qeveria për këto vende, ka shoqëruar dhe ka përshpejtuar në disa raste këto zhvillime.

Ndërkohë që sektorët financiarë, dhe veçanërisht bankat tregtare, kanë forcuar lidhjet e tyre ndërkombëtare dhe si rezultat edhe janë integruar gradualisht në tregjet financiare botërore, konkurrenca e drejtpërdrejtë nga veprimtaritë bankare ndërkufitare mbetet ende e kufizuar. Huadhënia ndërkufitare është rritur ngadalë në vendet e rajonit. Megjithatë, edhe në këtë fushë ka hapësira për të lëvizur më shpejt. Depërtimi i kapitalit të huaj në vendet që po i referohem është ende i ulët dhe, në një masë të madhe, pasqyron edhe paaftësinë e sistemeve tona financiare për të lehtësuar thithjen e investimeve të huaja nga ana e ekonomive tona kombëtare. Shqipëria

ende nuk ka një vlerësim të pavarur duke vështirësuar shumë perceptimin e saktë të saj nga tregu ndërkombëtar. Për këtë qëllim, personalisht po ushtroj gjithë influencën time në mënyrë që pas përfundimit të FSAP-it vendi ynë t'i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur prej ndonjërës prej agjencive të specializuara.

Kryerja e reformave të përshpejtuara, shoqëruar me hapa të shpejtë në drejtim të modifikimit të legjislacionit, do të bënte që ëndrra e rajonit për një anëtarësim në Evropë të jetë më e vërtetë. Në qoftë se vendet tona do të miratojnë ligjet, jo thjesht për forcë zakoni por për të krijuar një inventar të plotë dhe tërësor, atëherë mendoj se ato pjesërisht do të paraqiten në dyert e Brukselit me "detyra shtëpie të zgjidhura". Kjo do të rriste besueshmërinë e rajonit, duke hapur kështu rrugën për më shumë investime të huaja të drejtpërdrejta, dhe për më shumë investitorë cilësorë. Këta të fundit do të ndikojnë tregun vendas por do të rrisin atraktivitetin e të gjithë rajonit. Mendoj se pasqyrim i kësaj çka thashë më sipër është dhe interesimi i aktorëve të fuqishëm ndërkombëtarë financiarë për letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare.

Të nderuar pjesëmarrës,

Nga sa thashë më sipër, natyrshëm më lind ideja se trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre sfidave mund dhe duhet ta inkuadrojmë në një plan veprimi të përbashkët rajonal. Këtë ide e kam prekur edhe në disa takime të tjera ndërkombëtare si dhe në takime të ndryshme dypalëshe me guvernatorët e bankave qendrore të rajonit. Në parim, të gjithë janë pro intensifikimit të bashkëpunimit rajonal dhe ka edhe hapa konkretë në këtë drejtim siç janë marrëveshjet në fushën e mbikëqyrjes bankare të nënshkruara me Bankën Kombëtare të Maqedonisë dhe me Bankën Qendrore të Malit të Zi. Ndërkohë, jemi në proces negocimi me Bankën Kombëtare të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me atë të Serbisë. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve po hedhim hapat e parë në drejtim të një mbikëqyrjeje më moderne veçanërisht, kur është fjala për veprimtarinë e operatorëve të fuqishëm të biznesit që e kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në të gjithë rajonin.

Ky informacion do të ishte shumë i rëndësishëm dhe do të ndihmonte për një mbikëqyrje efektive të bazuar në parimin host to host country (vendi mikpritës tek vendi tjetër mikpritës), një detaj ky i cili mendoj se nuk është prekur nga marrëveshjet përkatëse të Baselit. Mendoj se në kushtet e rajonit tonë kjo ka një rëndësi shumë të madhe, veçanërisht kur është fjala për banka, të cilat janë të pranishme në të gjitha vendet e rajonit dhe pesha që ato zënë në sektorin bankar të çdo vendi është e konsiderueshme.

Jam i mendimit se bashkëpunimi rajonal është një pararendës i rëndësishëm i procesit të integrimit të rajonit me pjesën tjetër të Evropës, prandaj nuk do të rresht së punuari për të nxitur krijimin e standardeve të larta në bashkëpunimin rajonal midis sistemeve financiare të vendeve të Ballkanit.

Për këtë problem kam mbështetjen e plotë të Bankës Qendore Evropiane dhe Komisionit Evropian. Kjo gjithashtu është në përputhje dhe me programin

e ndërtuar nga Banka Botërore, i cili është titulluar me një emër shumë kuptimplotë Konvergjencë, ku roli i bankave qendrore dhe e shoqatave të bankave mund dhe duhet të fitojë përmasa të reja.

Në përfundim të fjalës time edhe një herë do të doja të falenderoja organizatorët dhe mikpritësit e këtij takimi për mundësitë e shkëlqyera që na kanë ofruar gjatë tij. Unë sinqerisht besoj në rolin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim dhe shpresoj se roli i saj në të ardhmen mund të jetë akoma më i madh në promovimin e bashkëpunimit midis vendeve anëtare, në nxitjen e tregtisë rajonale si dhe financimin e projekteve që i shërbejnë të gjithë rajonit.

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI

Seminar "Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave"
Tiranë, 22 qershor 2003

Të nderuar pjesëmarrës,

Tema e parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit është kthyer në një çështje të ditës, në një shqetësim të madh global, i cili ka tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e shumë vendeve perëndimore dhe të agjencive të ndryshme ndërkombëtare të specializuara apo jo qofshin ato. Në këtë kontekst, edhe vendi ynë është angazhuar në mënyrë shumë serioze në përmbushjen e të gjitha detyrimeve, që burojnë nga legjislacioni aktual dhe aktet e tjera të lidhura nënligjore.

Më vjen mirë që në funksionin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë të konstatoj se sistemi bankar, por njëkohësisht edhe vetë Banka e Shqipërisë, janë të angazhuara në mënyrë të kënaqshme në plotësimin e detyrimeve, që rrjedhin nga qenia e tyre si subjekte të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Në vazhdim të fjalës time do të dëshiroja të ndaja me ju disa mendime lidhur me rëndësinë e madhe që ka parandalimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit. Ndër të tjera do të doja që veçanërisht të trajtoj një koncept të ri, të ndryshëm nga standardet shabllone, me të cilin kuptoj krijimin e një edukate të re apo kulture të re në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Dëshiroj të bëj një sqarim të vogël se gjatë fjalës time në vazhdim, referimet e mija për sistemin bankar duhet të nënkuptojnë edhe institucionet jobanka, të cilat licencohen dhe mbikëqyren prej Bankës së Shqipërisë. Kur flas për një edukatë të re apo kulturë të caktuar në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave, nuk kam parasysh vetëm ekzistencën në institucion të strukturave përgjegjëse dhe të procedurave përkatëse.

Më konkretisht, e kam fjalën për krijimin e një mentaliteti të ri të të menduarit dhe të të vepruarit; për rritjen e shqetësimit moral dhe qytetar në çdo institucion financiar; për krijimin e një presioni të vazhdueshëm mbi strukturat përkatëse në mënyrë që të sigurohemi se ato janë duke vepruar drejt dhe se zbatojnë të gjitha procedurat e miratuara. Nga ana tjetër, në mënyrë që ky mentalitet i ri të jetë i suksesshëm ai duhet të jetë mbizotërues, duke u manifestuar në një rol proaktiv të të gjithë aktorëve në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndërinstitucionale, për t'iu larguar formalizmit dhe shablloneve deklamative. Duke iu drejtuar komunitetit të bankierëve të pranishëm në këtë sallë, dëshiroj t'ju kujtoj se unë vij nga rradhët tuaja. Për vite me rradhë kam qenë drejtuesi i një banke të nivelit të dytë, ashtu sikurse për shumë kohë kam drejtuar edhe shoqatën e bankave.

Gjatë gjithë kësaj kohe, kam diskutuar dhe ndarë me ju opinione dhe shqetësime të njëjta lidhur me problemet që sot po diskutojmë. Kohë më parë zhvilluam konsultime të gjithanshme dhe ndërmorëm takime të shumta në

vigjilje të hartimit dhe miratimit të ligjit aktual për parandalimin e pastrimit të parave. Po kështu, ne patëm objeksionet tona, veçanërisht për mënyrën se si u miratua ai. Edhe sot në funksionin e drejtuesit të bankës qendrore vazhdoj të besoj se një ligj është i mirë kur kërkesat e tij janë lehtësisht të zbatueshme në praktikë dhe nga ana tjetër, nuk sjell kosto të pajustifikueshme për subjektet që i nënshtrohen atij. Në këtë kontekst mendoj se ligji ekzistues i parandalimit të pastrimit të parave, ka nevojë të rishikohet, duke i bërë modifikimet e rastit në drejtim të standardizimit më të përshtashëm të kontributit të sistemit bankar në këtë fushë. Mendoj se kjo përshtatje, do të krijojë një nxitje më shumë në drejtim të objektivit tjetër madhor të reduktimit të ekonomisë informale dhe pakësimit të cash-it në ekonomi.

Megjithatë, duke iu kthyer edhe një herë këtij agumenti, të cilin e kam elaboruar shumë herë kohët e fundit, dua të theksoj se nevojitet një angazhim ndërinstitucional, pasi do të ishte utopike të mendonim se kjo detyrë i takon vetëm sistemit bankar, aktualisht i rregulluar, transparent dhe i mbikëqyrur. Një rol jo më pak të rëndësishëm, kanë edhe institucione të tjera ku përfshihen ato të taksave dhe të tatimeve apo institucionet e ndryshme të shërbimeve. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet edhe mbikëqyrjes së segmenteve të tregut jashtë bankave por brenda sferës së ligjit. Kushtet e kryerjes së pagesave të ndryshme, në nivel individi apo kompanie, duhet të favorizojnë përdorimin e instrumenteve bankare (si kartat elektronike, lëvizjet në llogari etj.) dhe në disa transaksione të caktuara (ku lëvizin vlera të mëdha), pagesat në *cash* duhet të ndalohen plotësisht. Janë pikërisht këto transaksione, të cilat përmbajnë edhe rrezikun më të madh të pastrimit të parave që rrjedh nga veprimtari të paligjshme, ku përfshihen edhe mashtrimet apo evazioni fiskal. Konstatoj, se preferenca e mbajtjes së *cash*-it, lidhet edhe me mentalitetin e shoqërisë sonë, edhe me nivelin relativisht të ulët të pagës mesatare në vend. Si rezultat, mund të thuhet me një nivel të kënaqshëm sigurie se pjesa dërrmuese e sasisë së parasë që qarkullon në *cash*, zotërohet nga shumë njerëz, pra përfaqëson një rrezik relativisht të ulët për pastrim të parave.

Me tej, kemi qenë dëshmitarë të një dialogu jo rrallë të vështirë, që ka ekzistuar me strukturat që zbatojnë ligjin. Nga njohja që kam për këtë çështje, mendoj se probleme të tilla ekzistojnë pothuaj në çdo juridiksion të huaj, pavarësisht se kultura superiore e tyre në zbatimin e ligjit, e bën më të lehtë zgjidhjen e problemeve.

Të nderuar drejtues të bankave,

Kam dëshirë ta trajtoj problemin nga këndvështrimi i asaj çfarë ne mund të kontribuojmë më tepër në këtë proces, pavarësisht vështirësive objektive që mund të kemi. Për më tepër, historia e rasteve të huaja tregon se kostot e këtyre vështirësive, sado të mëdha në kohë normale, mund të tejkalohen lehtë në raste ngjarjesh të jashtëzakonshme që lidhen me skandale të pastrimit të parave.

Fillimisht, dua të them se duhet të jemi të kujdesshëm të mos lejojmë që këto vështirësi të zhvendosin përqendrimin tonë nga thelbi i diskutimit; për t'u siguruar që në çdo kohë, institucionet tona financiare janë të pastra, ku paraja e pisët dhe krijuesit apo përfituesit e saj, nuk mund të hyjnë.

Nëse nuk veprojmë në këtë mënyrë, mund të kemi pasoja të pallogaritshme. Rrezikojmë realisht reputacionin e institucioneve të veçanta si edhe të sistemit bankar dhe financiar në përgjithësi; jemi bërë pa dashur instrumente në duart e krimit për të përdorur paratë e rrjedhura nga veprimtari të paligjshme; kemi vendosur reputacionin e klientelës sonë të shëndetshme në një pozitë të vështirë; kemi humbur besimin tek lojtarët e ndershëm të tregut si edhe kemi errësuar imazhin tonë pozitiv pranë partnerëve ndërkombëtarë si edhe partnerëve të klientëve tanë; do të kemi në të ardhmen një kosto më të lartë të realizimit të biznesit bankar, jo vetëm nëpërmjet pasojave që mund të vijnë nga largimi i klientelës (të cilat mund të jenë deri fatale) por dhe nga vështirësitë që do të hasim në zgjerimin e veprimtarisë, mund të provojmë veprime ndëshkimore rregullative dhe ligjore. Dëmi është i shumanshëm dhe kapërcen çdo lloj përfitimi sasior në nivelin e vëllimit të biznesit që mund të kemi patur nga pranimi "pa kushte" i çdo lloj oferte për të kryer biznes bankar me ne.

Në fund të fundit, nëpërmjet zbatimit rigoroz të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave, ne kemi ruajtur institucionin tonë nga një dëm i pallogaritshëm. Ky është një element thelbësor i punës tonë, tipar i një bankieri të mirë. Duke qenë aktivë në parandalimin e pastrimit të parave, kemi bërë thjesht punën tonë. Çdo neglizhencë në këtë drejtim, nënkupton se ne nuk jemi të denjë për detyrën që kryejmë.

Duhet të theksojmë se elementi kyç, është vullneti i mirë për të kuptuar dhe për të zbatuar procesin, në thelbin e tij. Ky vullnet është i rëndësishëm të manifestohet nga strukturat drejtuese më të larta në institucion. Nëse ky vullnet mungon, kjo do të ndihet menjëherë në strukturat e bankës, të cilat ndjekin drejtpërsëdrejti procesin e parandalimit të pastrimit të parave, veprimtaria e të cilave do të jetë neglizhuese dhe përgjithësisht formale. Brenda institucionit, angazhimi i strukturave drejtuese duhet të manifestohet nëpërmjet hartimit dhe miratimit të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave, krijimit të njësive të nevojshme dhe caktimit të personave përgjegjës me cilësitë e duhura profesionale dhe hierarkike, ndarjes së saktë të të drejtave dhe të përgjegjësive brenda këtyre njësive si edhe për segmente të caktuara të biznesit bankar, mbështetjes materiale, morale si edhe trainimit të vazhdueshëm të personelit, veçanërisht të asaj pjese që realizon kontaktin me klientin dhe analizën e profilit të rrezikut të tij, ruajtjen e një presioni të vazhdueshëm dhe pozitiv për këto procese në bankë, në mënyrë të vazhdueshme. Me një fjalë, klima që duhet të ekzistojë brenda institucionit për këtë çështje, duhet të favorizojë në çdo rast veprimet e përgjegjshme, që merren në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave, nga personeli i gjerë i bankës.

Në një nivel ndërinstitucional, vullneti për të vepruar për parandalimin e pastrimit të parave, shkon përtej zbatimit rigoroz të kërkesave rregullative. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm për rolin që kemi në strukturën e institucioneve, që veprojnë në procesin e parandalimit të pastrimit të parave. Përveç kësaj, duhet të jemi të ndjeshëm dhe ndihmues ndaj rolit të institucioneve të tjera që veprojnë në këtë kuadër, për më tepër kur jemi të njohur me vështirësitë që ata kanë në zbatimin e funksioneve të tyre. Më konkretisht, unë nuk besoj se industria bankare dhe institucionet e tjera jobanka, japin kontributin e

tyre më të mirë, nëse mjaftohen me respektimin rigoroz vetëm të kërkesave sasiore të ligjit, duke anashkaluar disa kërkesa cilësore të tij. Kështu, aktualisht raportohet në Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave një vëllim shumë i madh i transaksioneve mbi minimumin e shumës së kërkuar nga ligji (kërkesë detyruese), por fare pak raporte dërgohen për raste të transaksionevë të dyshimta nën këtë kufi (kërkesë jodetyruese). Në këtë rast, është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit, por nuk është vepruar në frymën e tij. Përsa kohë biem dakord që në realitet është objektivisht e pamundur që strukturat e parandalimit të pastrimit të parave në bankë dhe drejtuesit e saj t'i njohin një për një të gjithë klientët e saj, aq mirë sa të vënë "dorën në zjarr" për pastërtinë e secilit prej tyre, atëherë duhet të pranojmë që mungesa e raportimeve për transaksione të dyshimta nënkupton që një bankë:

- ka vështirësi në ngritjen e strukturave të brendshme, për të siguruar analizën reale të profilit të klientit;
- nuk ka një kuptim të mirë të problemit dhe ka zgjedhur një mënyrë formale për t'iu përgjigjur kërkesave sasiore të ligjit;
- nuk merr një rol proaktiv, në kuptimin e vështirësive që kanë institucionet e tjera dhe në përshtatjen e mënyrës së trajtimit të këtij procesi nga vetë banka.

Nëse një bankë ka zgjedhur t'i përshtatet kërkesave të ligjit në mënyrë formale, dhe nëse kjo përqasje gjen vend edhe në institucione të tjera, mendoj se rrezikohet realisht që ky trajtim të kthehet në dëm të vetë industrisë financiare. Do të ishte normale që në këtë rast të mendohej se mënyra e vetme për të rritur shanset e identifikimit të pastrimit të parave në kushtet e një formalizmi të tillë, është ulja e nivelit minimal të raportimit të kërkuar nga ligji, me shpresën se në këtë mënyrë "do të kapen" rastet e dyshimta nën këtë kufi. Për më tepër, këto mendime mund të mbështeten edhe në nivelet relativisht të larta të nivelit minimal të raportimit që përmban ligji ynë për parandalimin e pastrimit të parave. Ne rrezikojmë në këtë mënyrë, t'i imponojmë vetes një zgjidhje me një kosto më të lartë përputhshmërie, por edhe me një formalizëm më të lartë, në kushtet kur vështirësitë që lidhen me analizën e informacionit që raportohet nga institucionet e tjera, janë të njohura.

Në këtë kontekst do të theksoja se formalizmi në zbatimin e ligjit është i papranueshëm dhe mjaft i dëmshëm. Formalizmi në këtë rast barazohet me kryerjen e detyrës dhe vë në gjumë strukturat kontrolluese ose ndalon mirëfunksionimin e tyre. Për këtë, thelbësore është që vetë ligji dhe aktet rregullative duhet të jenë sa më të qarta dhe të zbatueshme, në mënyrë që të krijojmë konfidencialitet dhe lehtësi në zbatimin e tyre.

Kalimi në një analizë sipas profilit të rrezikut të klientit, është i vetmi hap që siguron zbatimin e ligjit sipas frymës së tij. Kjo mënyrë ofron avantazhe, së pari për realizimin e qëllimit të këtij procesi dhe në vijim për vetë institucionet që janë subjekte të ligjit apo ato të ngarkuara për zbatimin e tij. Kjo mënyrë, mbështetet në një njohje bazë të klientit, të cilën banka duhet ta vendosë si standard në kryerjen e veprimtarisë së saj. Më tej, ajo lejon shpërndarjen më të mirë të burimeve njerëzore dhe financiare në kuadër të ngritjes së të gjithë

sistemit të brendshëm të parandalimit të pastrimit të parave, duke rezultuar në një reduktim të kostove. Njëkohësisht, ajo iu mundëson institucioneve që merren me analizën e informacionit që vjen nga subjektet e ligjit, të fokusojnë punën e tyre në ato transaksione të cilat paraqesin një shkallë më të lartë rreziku për të qenë pastrim paraje. Të gjitha institucionet do të kenë më pas më tepër nxitje, për t'i ndjekur rastet e dyshimta, si edhe për të dhënë informacion mbi rezultatin e hetimit të tyre.

Një element tjetër mjaft delikat që dua të veçoj në fjalën time është ruajtja e konfidencialitetit në dhënien dhe në administrimin e informacionit për transaksione të dyshimta. Praktika jonë ka treguar se problemet në këtë pikë, janë komplekse. Kemi patur raste të daljes në publik të raporteve për transaksione të dyshimta, të nesërmen e ditës së raportimit të tyre. Në një rast tjetër, punonjësit e bankës janë hetuar, sikur të ishin ata personat që kishin pastruar paranë dhe jo ata që kishin raportuar për një transaksion të dyshimtë. Subjektet raportuese dhe institucionet që implementojnë ligjin, brenda kuadrit të ligjit dhe në frymën e tij, duhet të përcaktojnë mes tyre procedura që mundësojnë eliminimin e rasteve të tilla dhe që sigurojnë ruajtjen e konfiencialitetit të personave në subjektet raportuese, që raportojnë mbi rastet e transaksioneve të dyshimta. Për sa kohë ky element nuk është siguruar plotësisht, çdo diskutim tjetër shndërrohet në një trajtim teorik pa vlera të mirëfillta praktike.

Në përfundim, si Guvernator më duhet të them se do të inkurajoja një klimë më të mirë bashkëpunimi mes institucioneve që janë subjekte të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe institucioneve që ngarkohen me zbatimin e tij. Njëkohësisht, Banka e Shqipërisë si institucion mbikëqyrës i subjekteve që licencohen prej saj dhe që janë subjekte të ligjit, do të nxisë një lëvizje më të fuqishme në drejtim të dhënies së një kontributi më të madh nga bankat në parandalimin e pastrimit të parave. Në ushtrimin e funksionit tonë, nuk do të mjaftohemi vetëm me verifikimin e ekzisencës së strukturave të brendshme të bankës dhe të procedurave përkatëse, por do të thellohemi më tej në drejtim të vlerësimit të mbështetjes, që strukturat drejtuese i japin sistemit të brendshëm të parandalimit të pastrimit të parave. Pozicioni i një banke qendrore sipas ligjit është mjaft komod, por duke patur rolin proaktiv të një banke qendrore të përgjegjshme, dhe duke parë zbatimin konkret të kësaj përgjegjeshmërie, do të intensifikojmë punën tonë së bashku me aktorët e tjerë të interesit, për një zbatim sa më korrekt të ligjit për pastrimin e parave.

Më lejoni që ta mbyll këtë fjalë, duke falenderuar bashkëorganizatorët e këtij seminari, Zyrën e FSVC në Tiranë si edhe Shoqatën Shqiptare të Bankave. Falenderoj specialistët e bankave të nivelit të dytë dhe të institucioneve jobanka që marrin pjesë në këtë seminar dhe që japin një kontribut të paçmuar në parandalimin e pastrimit të parave në institucionet e tyre. Falenderoj gjithashtu edhe ekspertët e huaj, z.Farrell dhe z.Burnside, të cilët pranuan të ndajnë me ne përvojën e tyre të vyer. Uroj që ky seminar të jetë edhe për ta një ngjarje e veçantë.

Faleminderit!

FJALA E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË DYTË TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. LIMOS MALAJ

Seminar "Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave"
Tiranë, 21 qershor 2003

Të nderuar pjesëmarrës,

Në kuadrin e masave për forcimin e luftës kundër pastrimit të parave, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me FSVC dhe Shoqatën e Bankave të Shqipërisë organizon këtë seminar me temë: Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave.

Sikurse dihet Shqipëria, mbështetur edhe nga asistenca e organizmave ndërkombëtarë si : FMN dhe Bashkimi Evropian, ka punuar intensivisht për krijimin e bazës ligjore, ngritjen e strukturave të nevojshme për parandalimin e pastrimit të parave, si edhe po punon për trainimin dhe aftësimin e personelit të angazhuar në këtë punë. Banka e Shqipërisë si autoriteti i mbikëqyrjes së bankave dhe institucioneve finaciare jobanka, ka vlerësuar rëndësinë e këtij sektori nisur edhe nga roli i veçantë që këto institucione kanë në luftën kundër pastrimit të parave.

Praktika ka treguar se pastrimi i parave paraqitet si fenomen me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për faktin që paratë e pista e kanë origjinën nga krimi dhe në shumë raste destinacioni i tyre përfundimtar është financimi i krimit. Po kështu, pastrimi i parave nuk është një problem i kufizuar në kohë dhe në hapësirë. Ai ka një origjinë të largët në kohë dhe në vende e kohë të ndryshme është zhvilluar në përmasa dhe me intensitet të ndryshëm. Përvoja ka treguar se lufta kundër tij kërkon një angazhim dhe bashkërendim të punëve nga faktorë të brendshëm të një vendi, por edhe të forcimit të bashkëpunimit me autoritete, përkatëse të vendeve të tjera.

Sistemi bankar tek ne, si subjekt i ligjit të pastrimit të parave, ndodhet në procesin e zhvillimit dhe të konsolidimit të tij. Në praktikën tonë bankare është forcuar baza ligjore dhe rregullative edhe në drejtim të luftës për parandalimin e pastrimit të parave. Masat e marra konsistojnë në krijimin e procedurave dhe të praktikave të qarta për identifikimin, regjistrimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta pranë autoriteteve shtetërore të ngarkuara me investigimin e mëtejshëm të tyre. Masat për parandalimin e pastrimit të parave kanë qenë gjithashtu, objekt monitorimi e vlerësimi jo vetëm nga autoritetet mbikëqyrëse brenda vendit, por edhe nga institucionet ndërkombëtare të specializuara. Por, sikurse theksuam në fillim, ky proces kërkon që të thellohen më tej masat e marra, edhe nga vetë institucionet financiare e bankare.

Në sfidat që po ballafaqohet sistemi bankar dhe Banka e Shqipërisë mund të përmendim:

Së pari: Përpjekjet për reduktimin e ekonomisë në *cash*. Sikurse duket, Shqipëria karakterizohet nga kryerja e një pjese të mirë të transaksioneve financiare jo nëpërmjet bankave, por me lekë në dorë, gjë e cila krijon premisa për filtrimin e parave të pista.

Së dyti: Rrjeti bankar, po zgjerohet e shtrihet gjithnjë e më shumë. Kjo kërkon edhe masa më të forta për kualifikimin dhe trainimin e personelit që punon në këta sektorë.

Së treti: Sistemi bankar po ofron gjithnjë e më shumë produkte të reja, të cilat nuk kanë qenë prezente më parë, duke filluar nga shumëllojshmëria e kartave të kreditit dhe deri në kryerjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike – sipas të cilit kryerja e veprimeve në bankë bëhet pa qenë prezent vetë klienti.

Të gjitha këto kërkojnë të rishikohen në vazhdimësi rregullat dhe procedurat e hartuara, por edhe të punohet për aftësimin dhe trainimin e punonjësve të bankave. Këtij qëllimi i shërben edhe organizimi i këtij seminari, të cilin Banka e Shqipërisë dhe Shoqata e Bankave e konsiderojmë si një çështje të përbashkët midis Bankës Qendrore dhe bankave të nivelit të dytë.

Me këtë rast dëshiroj të falenderoj edhe një herë agjencinë amerikane "Financial Services and Volounteer Corps" për asistencën që po na jep, duke siguruar specialistë me eksperiencë të gjerë në fushën bankare dhe veçanërisht në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Më në fund , do të falenderoj lektorët si aseti më i vlefshëm në aktivitete të tilla, duke shprehur mirënjohjen e Bankës së Shqipërisë për ardhjen e tyre për të na asistuar në zhvillimin e këtij seminari.

VLERËSIMI I STANDARDEVE TË SHPËRNDARJES SË STATISTIKAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË*,**

Ky material ka për qëllim të japë një vlerësim mbi cilësinë e praktikës së shpërndarjes së të dhënave statistikore duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave financiare dhe të bilancit të pagesave, nëpërmjet krahasimit të tyre me standardet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

HYRJE

Kompilimi dhe shpërndarja e të dhënave ekonomike është bërë gjithnjë e më shumë një faktor përcaktues në vendimmarrjen ekonomike. Për më tepër, vendet që kërkojnë të hyjnë në tregjet ndërkombëtare të kapitaleve këshillohen të përmirësojnë shpërndarjen e të dhënave statistikore, pasi nëpërmjet tyre krijojnë siguri tek investitorët. Për rëndësinë që paraqet, procesi i shpërndarjes së të dhënave është bërë objekt vëmendjeje nga organizatat ndërkombëtare, të cilat kanë ndërtuar standarde bazuar në praktikat më të mira të vendeve lidhur me këtë proces.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në tetor të vitit 1995 filloi punën mbi ngritjen e standardeve lidhur me shpërndarjen e të dhënave ekonomike dhe financiare. Këto standarde konsistojnë në dy nivele: standardet e GDDS-it (Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave)[1], në të cilin mund të merrnin pjesë të gjitha vendet anëtare të FMN-së dhe standardet e SDDS-it (Standardet Speciale të Shpërndarjes së të Dhënave)[2], për ato vende që operojnë ose që kërkojnë të hyjnë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Të dyja standardet synojnë të përmirësojnë shpërndarjen e të dhënave të plota statistikore në kohën e duhur dhe kështu të nxisin ndjekjen e politikave të mira makroekonomike. Përveç kësaj, standardet e SDDS-it pritet të nxisin një përmirësim në funksionimin e tregjeve financiare.

Shqipëria është anëtare e Projektit të GDDS-it që prej vitit 1999, duke u klasifikuar si vend pilot në këtë projekt. Nëpërmjet këtij sistemi është arritur përmirësimi i transparencës së institucioneve që prodhojnë statistika (ku përfshihen Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe INSTAT), janë vendosur prioritetet dhe planet për përmirësim lidhur me mangësitë që ekzistonin si dhe është përftuar asistenca e nevojshme në këtë drejtim. Për të vlerësuar praktikat lidhur me shpërndarjen e të dhënave statistikore shërbyen

**Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.*

*** Kliti Ceca, Hilda Shijaku, Endrita Xhaferaj, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, Banka e Shqipërisë.*

[1] Referenca përkatëse jepet në: http://dsbb.imf.org/Applications/web/gdds/gddshome/

[2] Referenca përkatëse jepet në: http://dsbb.imf.org/Applications/web/sddshome/

misionet e ROSC[3] (Raporti mbi Standardet dhe Kodet), të cilat kanë vizituar Shqipërinë për herë të fundit në maj të vitit 2000. Përveç vlerësimeve pozitive, ndërtimi i një sistemi të llogarive kombëtare, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe mbulimi i aktiviteteve ekonomike sidomos për statistikat e sektorit real dhe atij të jashtëm, si dhe përdorimi eficient i burimeve të informacionit ishin disa nga domosdoshmëritë që u evidentuan nga ky mision.

Ky material ka për qëllim të japë një vlerësim mbi cilësinë e praktikës së shpërndarjes së të dhënave duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe të statistikave të bilancit të pagesave, nëpërmjet krahasimit të tyre me praktikat më të mira botërore.

Për këtë vlerësim janë përdorur standardet e Projektit DQAF[4] (Kuadri i Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave) të FMN-së, standarde të cilat mbulojnë mjedisin institucional, proceset statistikore dhe karakteristikat e produkteve statistikore. Një paraqitje e përmbledhur në formë tabelore e treguesve standardë të përdorur nga DQAF, jepet në aneksin bashkëlidhur.

Materiali është i ndarë në 6 pjesë të cilat përbëjnë dhe dimensionet e vlerësuara në lidhje me shpërndarjen e të dhënave. Qëllimi i paraqitjes është vlerësimi i efektshmërisë së shpërndarjes së statistikave të sektorit financiar dhe të sektorit të jashtëm në Shqipëri.

1. KUSHTET PARAPRAKE TË CILËSISË SË TË DHËNAVE

Kushtet paraprake të shpërndarjes së të dhënave statistikore cilësore janë ekzistenca e një mjedisi ligjor dhe institucional që mbështet statistikat, ekzistenca e burimeve njerëzore dhe materiale të përshtatshme, dobishmëria e të dhënave që publikohen dhe administrimi i mirë i cilësisë së të dhënave.

1.1 EKZISTENCA E NJË MJEDISI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL QË MBËSHTET STATISTIKAT:

i) Së pari, një mjedis mbështetës për statistikat nënkupton që ligji të shprehet në mënyrë të qartë mbi përgjegjësinë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e një kategorie të dhënash.

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", i jep qartësisht të drejtën dhe përgjegjësinë Bankës së Shqipërisë për të prodhuar dhe shpërndarë statistikat e sektorit financiar dhe statistikat e bilancit të pagesave si dhe i detyron të gjitha bankat, institucionet, personat fizikë dhe juridikë të raportojnë të dhënat statistikore në Bankën e Shqipërisë. Në këtë kuadër përfshihet gjithashtu dhe ligji "Për statistikat zyrtare"[5].

[3] *ROCS – Reports on the Observance of Standards and Codes.*
[4] *DQAF – Data Quality Assessment Framework. DQAF siguron një strukturë fleksibël për vlerësimin cilësor të shpërndarjes së statistikave dhe mund të përdoret në kontekste të ndryshme, përfshirë dhe vetëvlerësimin nga agjencitë kombëtare statistikore.*
[5] *Ligji nr.9180, datë 05.02.2004.*

ii) Së dyti, koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive që prodhojnë të dhënat duhet të jenë të përshtatshëm.

Ky tregues nënkupton si ekzistencën e procedurave të shkëmbimit të informacionit ashtu edhe mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme (nëpërmjet takimeve të rregullta dhe seminareve) me agjencitë e tjera që prodhojnë statistika me qëllim njohjen e kërkesave të statistikave, shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta dhe marrjen parasysh të kostos së raportimit. Në Bankën e Shqipërisë ekzistojnë procedura të tilla të përshkruara në rregulloret përkatëse të cilat mbulojnë, për momentin, fluksin e statistikave që janë subjekt i punës aktuale. Për të ulur koston e raportimit të subjekteve është synuar koordinimi i raportimeve të bankave të nivelit të dytë dhe shoqërive të kursim - kreditit për qëllime të mbikëqyrjes, të statistikave të bilancit të pagesave dhe të statistikave financiare.

Aktualisht, Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare është në fazën e fundit të përfshirjes së "institucioneve të tjera financiare" në treguesit statistikorë. Për këtë, është synuar të shfrytëzohen të dhënat ekzistuese të institucioneve që mbikëqyrin apo licencojnë grupe institucionesh të tjera financiare, siç është për shembull Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Një eksperiencë e tillë pozitive është ndjekur dhe për raportimet nga ShKK-të, duke i marrë këto raportime nga unionet përkatëse (në të cilat ShKK-të janë anëtare). Njësoj po veprohet për grumbullimin e informacionit për nevoja të statistikave të bilancit të pagesave.

Vlen të theksohet që praktika të tilla pune për shkëmbim informacioni statistikor janë të vendosura në bashkëpunimin me INSTAT dhe me Ministrinë e Financave.

iii) Së treti, të dhënat individuale të raportuara duhet të jenë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.

Një pohim i tillë është veçanërisht i rëndësishëm për ato subjekte që nuk mbikëqyren apo licencohen nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk mund të jenë subjekt i penalizimeve për vonesat apo për mungesat në raportim. Banka e Shqipërisë siguron konfidencialitetin e të dhënave individuale në bazë të: ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", "Kodit të etikës të Bankës së Shqipërisë" dhe "Rregullores për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë".

Krahas mbrojtjes nga ligji, ekzistojnë gjithashtu procedura që parandalojnë shpërndarjen e informacioneve individuale. Këta rregulla sigurojnë shpërndarjen jo të ligjshme të informacionit, si për shembull duke garantuar sigurinë e bazave të të dhënave, duke kufizuar numrin e personelit që konsulton të dhënat individuale etj.. Ndërkohë që është mbajtur parasysh mosshpërndarja indirekte e informacionit individual. Përsa i përket mbrojtjes rregullative, ligji i Bankës së Shqipërisë si dhe rregulloret e përmendura më lart ruajnë konfidencialitetin e të dhënave individuale, duke i ndaluar punonjësit e Bankës së Shqipërisë të shpërndajnë apo të transferojnë të dhënat

individuale një pale të tretë, për çdo qëllim. Megjithatë, në bazën rregullative duhet specifikuar dhe "parandalimi i shpërndarjes indirekte të informacionit konfidencial", si për shembull në rastin kur një bankë ose grup bankash ka një pozicion mbizotërues në një instrument të caktuar dhe që mundëson marrjen e këtij informacioni edhe kur të dhënat janë në nivel të agreguar.

iv) Së katërti, raportimi statistikor nga subjektet duhet mbështetur nga një mandat ligjor ose në masa të tjera që nxisin përgjigjen.

Raportimi statistikor mund të jetë i detyruar ose jo. Konkretisht, për statistikat monetare subjektet që raportojnë deri tani janë të detyruara me ligj të raportojnë në Bankën e Shqipërisë. Ndërkohë që aty përfshihen dhe penalitetet përkatëse në rast se evidentohen probleme. Në ligjin e Bankës së Shqipërisë parashikohet gjithashtu që çdo institucion, person fizik apo juridik është i detyruar të raportojë në Bankën e Shqipërisë (neni 27, ligji i Bankës së Shqipërisë), por nuk ekzistojnë cilësime se çfarë ndodh në të kundërtën (për shembull, penalizimi i atyre subjekteve që nuk plotësojnë këtë kërkesë).

Në rast se ligji nuk ka fuqi t'i detyrojë subjektet të raportojnë, atëhere agjencia është e detyruar të marrë një sërë masash për të bërë sa më të lehtë dhe me kosto të ulët raportimin nga subjektet. Konkretisht, me institucionet e tjera financiare (për pasqyrimin në statistikat financiare) po punohet për ngritjen e një sistemi raportues duke shfrytëzuar jo vetëm bazën ekzistuese ligjore, por edhe duke ofruar bashkëpunim me subjektet apo duke përshtatur nevojat e statistikave me sistemet ekzistuese kontabile të tyre.

1.2 BURIMET – BURIMET DUHET TË JENË TË MJAFTUESHME PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË PROGRAMEVE STATISTIKORE.

i) Burimet njerëzore duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Numri i punonjësve të statistikës dhe përgatitja e tyre janë në përputhje me detyrat aktuale që kanë njësitë e statistikës. Kualifikimi i tyre bazë është realizuar, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me FMN-në (kurset e kualifikimit të organizuara prej tyre, misionet, asistenca në distancë), përvojës në punë, si dhe seminareve të ndryshme të organizuara nga institucione të tjera ndërkombëtare. Kjo ka bërë të mundur edhe krijimin e një stafi të aftë për të përballuar drejtimin e punës në njësitë e statistikës. Mbetet akoma për t'u bërë për forma trainimi më të organizuara, për të përballuar detyrat në të ardhmen.

Gjithashtu duhet menduar plotësimi i personelit për të përballuar plotësimin e spektrit të statistikave, bazuar në standardet ndërkombëtare, si pozicioni ndërkombëtar i investimeve, statistikat e borxhit të jashtëm, statistikat e tjera të ekonomisë.

Njësitë e statistikës kanë një numur të kufizuar individësh me edukim të mirëfilltë statistikor. Duhen sqaruar idetë që lidhen me zhvillimet cilësore të burimeve njerëzore në të ardhmen.

Ndërkohë, pagat për këta specialistë për momentin, mendohet që janë të një niveli të krahasueshëm me administratën në përgjithësi.

Rivlerësime që lidhen me forma të strukturës së statistikave dhe plotësime të saj mund të merren në konsideratë.

ii) Teknologjia – niveli i saj për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Në zhvillimin e teknologjisë që lidhet me statistikat, këto vitet e fundit janë realizuar projekte për implementimin e zgjidhjeve për informacionin statistikor. Aktualisht, teknologjia në dispozicion është ajo e nevojshme për kërkesat e statistikës (përfshirë këtu kompjuterat, programet dhe ruajtjen e informacionit) dhe në nivelet e duhura deri tani për kërkesat që shtrojnë programet statistikore[6]. Ndërkohë, duhet vazhduar më tej puna për zhvillimin e teknologjisë, në arritjen e standardeve të zhvilluara[7].

iii) Lehtësitë fizike dhe burimet e tjera, si transporti, komunikimi etj. – niveli i tyre për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Gjykohet që për momentin kushtet fizike të punës, lënë për të dëshiruar si për sa i përket gjendjes fizike të zyrave, ashtu dhe përsa i përket vendosjes së punonjësve nëpër zyra në bazë të funksionit që ata kryejnë. Përmirësimi i tyre pa dyshim që do të sjellë mundësi më të mira për cilësinë e punës me statistikat. Ndërkohë, ekzistojnë kushte normale të komunikimit dhe të transportit për realizimin e detyrave.

iv) Financimi për kompilimin e statistikave – plotësimi i kërkesave për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.

Financimi për statistikat është realizuar sipas kërkesës së bërë dhe detyrave të shtruara. Ka ide të qarta lidhur me buxhetet e nevojshme për mbështetjen e statistikave, në një periudhë afatmesme.

v) Vendosja e mekanizmave për një përdorim eficient të burimeve.

Janë vendosur mekanizma për matjen në mënyrë periodike dhe me disa mënyra vlerësimi të cilësisë së punës së personelit të statistikave. Nga ana tjetër, janë marrë një sërë masash për të përmirësuar aspektet organizative të personelit të statistikave, si bashkimi i këtyre njësive në të njëjtin department, përmirësimi i dokumentacionit rregullativ etj.. Në kuadrin e përdorimit më efektiv të burimeve të informacionit, po bashkëpunohet më ngushtë me INSTAT për rritjen e cilësisë së vrojtimeve statistikore. Në nivel kombëtar mbetet akoma shumë për të bërë për t'i siguruar vendimmarrjes informacion statistikor efektiv dhe të mjaftueshëm[8].

---

[6] *Këtu përmendim zgjidhjet: SARS – Sistemi Automatik i Raportimit Statistikor dhe "Seritë kohore".*
[7] *Për referencë përmendim standardet e Projektit SDDS; për hollësi shiko: http://dsbb.imf.org*
[8] *Si objektiv për këtë në nivel ndërkombëtar merren standardet e SDDS-it; për hollësi shiko: http://dsbb.imf.org*

Nga ana tjetër, për detyra të veçanta është bashkëpunuar me ekspertë të huaj, si specialistë të Fondit dhe FSVC-së.

1.1 DOBISHMËRIA E TË DHËNAVE:

i) Dobishmëria praktike e statistikave ekzistuese duhet të monitorohet.

Në prodhimin dhe shpërndarjen e të dhënave, çdo agjenci statistikore duhet të marrë parasysh kërkesat e përdoruesve dhe për këtë duhen gjetur mënyrat dhe rrugët përkatëse (për shembull, nëpërmjet vrojtimeve, seminareve ose të vlerësojë reagimin e publikut nëpërmjet personave të kontaktit). Në këtë kuadër, statistikat në Bankën e Shqipërisë u përgjigjen nevojave të përdoruesve të brendshëm, FMN-së dhe në mungesë të një reagimi aktiv nga publiku, synojnë t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare të prodhimit dhe të shpërndarjes së tyre. Kështu, punonjësit e statistikave në Bankën e Shqipërisë marrin pjesë në takimet statistikore dhe në seminaret e organizuara nga institucionet ndërkombëtare si dhe janë aktivë në kërkimin e eksperiencave të vendeve të tjera për karakteristikat e statistikave që kompilohen.

Nga ana tjetër, organizimi i takimeve periodike me përdorues të jashtëm si institucionet akademike, mediat dhe sektorin privat vlerësojmë se do të ishte një test i mirë për dobishmërinë e statistikave të publikuara. Me krijimin e kësaj përvoje, gradualisht do të ishte i nevojshëm dhe përcaktimi i disa procedurave përkatëse për realizimin e një procesi periodik dhe të strukturuar për konsultimin me përdorues të ndryshëm (përfshi këtu organizata rajonale dhe ndërkombëtare).

1.1 Cilësi të tjera të administrimit – cilësia e informacionit, si një moment themelor në punën me statistikat.

Së pari, në Bankën e Shqipërisë ekziston një mentalitet tashmë i formuar për administrimin e statistikave, në faktin që "cilësia krijon besimin" dhe që kjo është një moment themelor në ndërtimin e punës me statistikat. Kështu, Banka e Shqipërisë është e ndjeshme ndaj cilësisë së informacionit dhe është kërkuese për një administrim më të mirë të tij. Njësitë e statistikës së Bankës së Shqipërisë kanë në përdorim dokumentacion dhe informacion për përmirësimin e cilësisë së statistikave. Gjithashtu, ka procedura rishikimi të informacionit, duke marrë konsideratat nga përdoruesit[9] ose dhe rishikime të parashkruara nga burimet e informacionit.

2. INTEGRITETI I TË DHËNAVE

Për të siguruar integritetin e të dhënave të shpërndara, agjencia që publikon të dhënat duhet të garantojë profesionalizëm, transparencë dhe ndjekjen e standardeve të etikës.

[9] *Normalisht merren vlerësime apo kërkesa nga përdoruesit kryesorë të informacionit, siç janë: Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Kërkimeve dhe FMN-ja. Në disa raste të tjera vlerësime apo kërkesa janë bërë dhe nga përdorues të tjerë jashtë institucionit.*

1.1. PROFESIONALIZMI:

i) Statistikat prodhohen në mënyrë të paanshme:

Së pari, termat dhe kushtet në të cilat prodhohen dhe shpërndahen statistikat duhet të jenë në përputhje me pavarësinë profesionale. Një gjë e tillë duhet garantuar me ligj ose në mungesë të tij duhet të ekzistojë një traditë e njohur në respektimin e pavarësisë profesionale (shembull tipik në këto raste përmendet fakti që institucionet qeveritare të kuptojnë rëndësinë e mosndërhyrjes në pavarësinë e agjencisë që prodhon statistika). Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë me ligj gëzon të drejtën e prodhimit dhe të shpërndarjes së statistikave monetare dhe financiare dhe të statistikave të bilancit të pagesave. Pra, ajo garanton pavarësinë profesionale, si dhe parandalon ndërhyrjen nga palë të tjera, përfshirë institucionet qeveritare.

Së dyti, profesionalizmi duhet promovuar dhe mbështetur brenda agjencisë që prodhon statistika.

Në këtë kriter përfshihet fillimisht zhvillimi profesional i punonjësve të statistikave të Bankës së Shqipërisë. Kjo është realizuar nëpërmjet trajnimeve gjatë procesit të punës ose nëpërmjet seminareve të organizuara nga FMN-ja për çështje të metodologjisë së kompilimit të treguesve statistikorë, si dhe për shumë aspekte të tjera që lidhen me statistikat. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me specialistë të statistikave të FMN-së ka bërë të mundur sigurimin e literaturës më të fundit në lidhje me standardet bashkëkohore. Në këtë kuadër është dhe mbështetja e specialistëve të FMN-së për disa nga planet e sektorit të statistikave si arritja e standardeve të SDDS, përfshirja e institucioneve të tjera financiare në statistikat financiare, përshtatja e metodologjisë së re për të dhënat financiare të Shqipërisë të publikuara në FMN etj..

Gjithashtu, lidhur me promovimin dhe mbështetjen për punonjësit e statistikës, njësitë e statistikës janë klasifikuar në kategorinë e dytë të strukturës së pagave, ndryshe nga disa vite më parë (që shpreh dhe shkallën e rëndësisë që i ka kushtuar Banka e Shqipërisë). Vlen të theksohet që punësimi i specialistëve si dhe ngritja e tyre në përgjegjësi në strukturat e statistikës është bazuar në korrikulën e tyre në fushat e statistikës. Gjithashtu, janë mbështetur iniciativat për kërkim, analizë dhe zgjedhje të metodologjive të përshtatshme.

ii) Përzgjedhja e burimeve dhe e teknikave statistikore duhet të bazohet vetëm në konsiderata statistikore. Pavarësisht nevojave të vendimmarrjes, njësia që prodhon dhe shpërndan statistikat duhet të gëzojë pavarësi në ndjekjen e standardeve të veta në metodologjinë që përdor, në periodicitet dhe në mënyrën e shpërndarjes.

Njësitë statistikore në Bankën e Shqipërisë gëzojnë pavarësi pothuaj të mjaftueshme në këtë drejtim. Përgjithësisht edhe këtu synohet të ndiqen standardet e pranuara gjerësisht, të cilat kanë hapësira për të kënaqur nevojat e përdoruesve.

Rivlerësime që lidhen me forma të strukturës dhe plotësime të saj mund të merren në konsideratë. Vendimet mbi shpërndarjen e statistikave, kohën dhe tipin e shpërndarjes janë bazuar vetëm mbi konsiderata statistikore dhe mbi përvojën ndërkombëtare.

iii) Së treti, kriter tjetër i profesionalizmit është mundësia e institucionit për të reaguar ndaj keqinterpretimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të tyre.

Për këtë qëllim, të dhënave u bashkangjitet gjithnjë një komentar orientues (metodologji, metadata) gjë që përgjithësisht aplikohet në publikimet e Bankës së Shqipërisë. Keqinterpretimi i të dhënave të publikuara mund të mënjanohet gjithashtu, nëpërmjet kontakteve me grupe të përzgjedhura të publikut si për shembull mediat, institucionet akademike dhe shkencore etj.. Megjithëse në vitet e fundit është rritur ndjeshëm prania e Bankës së Shqipërisë në publik, proceset statistikore në Bankën e Shqipërisë njihen pak, duke patur parasysh këtu edhe kulturën e pakët të publikut në përgjithësi për statistikat.

Në kushtet e ndryshimeve të shpeshta të metodologjisë statistikore, të ndërtimit të historisë së të dhënave dhe të rishikimit të vazhdueshëm të tyre është shumë e lehtë të keqinterpretohen treguesit statistikorë. Si ndër iniciativat e rëndësishme që janë marrë në këtë drejtim mund të përmenden: seminaret me gazetarët, programet e ndryshme në bashkëpunim me median dhe sidomos, Konferenca e Parë "Informacioni statistikor në Shqipëri"[10].

Banka e Shqipërisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme përdorimin e publikimeve të saj në media. Në përgjigje të shkrimeve publike, sipas problematikës së ngritur janë përgatitur artikuj shpjegues dhe informues për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, artikuj sqarues kur ka keqkuptime, pjesëmarrje në debate për çështje ekonomike e financiare etj..

1.1. TRANSPARENCA E PROCESEVE STATISTIKORE:

i) Së pari, kushtet dhe termat në të cilat të dhënat statistikore mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen duhet të publikohen.

Aktualisht, në faqen internetit të Bankës së Shqipërisë ekziston një informacion i plotë mbi bazën rregullative mbi të cilën kryhet i tërë procesi statistikor. Për më tepër, përgatitja për SDDS kërkon jo vetëm listimin dhe publikimin e këtyre rregulloreve, por ndoshta edhe rishikimin në këtë këndvështrim të tyre.

ii) Së dyti, publiku duhet të njoftohet paraprakisht mbi njësitë qeveritare që kanë të drejta përdorimi mbi informacionin para se ai të bëhet publik.

Për statistikat monetare dhe statistikat e bilancit të pagesave njësitë qeveritare nuk kanë të drejta përdorimi paraprak në të dhënat që publikohen.

[10] *Konferenca I, "Informacioni statistikor në Shqipëri", organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe INSTAT, është mbajtur në Tiranë, në 2-3 nëntor, 2000. Për hollësi shiko: www.bankofalbania.org*

iii) Së treti, agjencia duhet të identifikojë të dhënat statistikore që prodhon dhe shpërndan, në mënyrë që publiku të ketë të qartë se për çfarë mban përgjegjësi agjencia.

Të dhënat statistikore në Bankën e Shqipërisë mbajnë emrin (logon) e Bankës së Shqipërisë kur shpërndahen. Veçanërisht, në rast publikimesh të përbashkëta duhet identifikuar në mënyrë të qartë ajo pjesë që i takon statistikave të Bankës.

iv) Ndryshimet kryesore në metodologji, në burim të dhënash dhe në teknikat statistikore duhet të njoftohen paraprakisht.

Aktualisht, për statistikat në Bankën e Shqipërisë nuk ekziston një praktikë e tillë. Përdoruesve u lajmërohen dhe u shpjegohen ndryshimet në statistikat e shpërndara në publikimin e rradhës.

2.3. STANDARDET E ETIKËS – POLITIKAT DHE PRAKTIKAT JANË TË UDHËHEQURA NGA STANDARDET ETIKE

i) Së pari, çdo agjenci që përgatit dhe shpërndan informacion statistikor, ka standarde të plota etike, të miratuara nga institucioni. Në Bankën e Shqipërisë ekziston një rregullore etike sipas standardeve. Nga ana tjetër, nga punonjësit kërkohet një nivel i plotë formimi në ruajtjen e standardeve të etikës dhe në shmangien e interferencave politike.

ii) Gjithashtu, këto standarde etike duhet të njihen mirë nga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit.

3. METODOLOGJIA

Ky dimension në statistikat monetare dhe financiare vlerësohet nëpërmjet krahasimit të praktikave të vendit me praktikat më të mira ndërkombëtare. Së pari, përmenden metodologjitë e shpërndara nga FMN[11]. Megjithatë, përmenden dhe standarde të tjera të praktikës më të mirë botërore[12]. Kriteret e krahasimit përfshijnë konceptet dhe përkufizimet, mbulimin, sektorizimin dhe klasifikimin e instrumenteve financiare dhe rregullat e kontabilizimit. Në mbështeteje të standardeve të FMN-së, Banka e Shqipërisë miratoi "Metodikën e statistikave monetare dhe financiare, BSH, Korrik 2003". Bazuar në këto standarde, që nga dhjetori i vitit 2002 ka filluar kompilimi i statistikave monetare sipas standardit të ri. Aktualisht, po punohet për publikimin në internet të këtyre statistikave si dhe për krijimin e tabelave "urë" për të mundësuar lidhjen e standardit të vjetër me atë të ri. Nga ana tjetër në bashkëpunim me FMN, janë përgatitur tabelat për t'u publikuar në IFS[13] sipas standardit të ri[14]. Së fundi, vlen të përmendet që megjithëse sistemi i

[11] *Këtu kryesisht përfshihen "Monetary and financial statistics manual, IMF" botime të viteve 1984, 2000, "Balance of Payments Manual, IMF. Fifth edition, 1993" si dhe dokumentacion tjetër plotësues.*
[12] *Këtu përfshihen standarde si: "Europian system of accounts 1995 (1995 ESA).*
[13] *International Financial Statistics, publikime të FMN-së.*
[14] *Shtojmë se në këtë bashkëpunim Shqipëria është zgjedhur si vend pilot, vlerësuar për punën cilësore të realizuar.*

vlerësimit DQAF, si dhe standardet e SDDS dhe GDDS mjaftohen vetëm me mbulimin e sektorit të "Korporatave depozituese", po punohet për përfshirjen e "Institucioneve të tjera financiare" në statistikat monetare dhe financiare.

Bilanci i pagesave hartohet sipas kuadrit metodologjik të përcaktuar në standardet ndërkombëtare të FMN-së në manualin e bilancit të pagesave BPM5. Në këtë kuadër, komponentet standarde të bilancit të pagesave janë klasifikuar dhe sektorizuar në përputhje me ato të rekomanduara në manual. Tabela statistikore e bilancit të pagesave bazohet në parimin e regjistrimit të dyfishtë duke respektuar, për të gjitha rastet, konceptin e rezidencës. Parime uniforme përdoren edhe për vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të transaksioneve që regjistrohen në këtë bilanc si dhe përfshirjen e të gjitha transaksioneve (shkëmbimeve e transfertave pa shpërblim). Megjithatë, në praktikë, si pasojë e kufizimeve në burimet e informacionit, regjistrimi i transaksioneve në vlerën dhe në kohën e duhur nuk është gjithmonë i mundur. Edhe devijimet nga kategorizimet më të detajuara të manualit, janë gjithmonë subjekt revizionimi e përmirësimi. Në këtë kuadër, përmendim futjen e formës së re të raportimit të bankave, si rrjedhim detajimin e zërave të bilancit të pagesave dhe plane të sektorit për detajime shtesë dhe azhornim të formularit të raportimit në të ardhmen.

Bilanci i pagesave të Shqipërisë mbulon në parim të gjitha transaksionet mes rezidentëve e jorezidentëve, por disa aktivitete ilegale mbeten të pambuluara. Për importet joformale të të mirave (kontrabandë) në Shqipëri bëhen vlerësime.

4. BESUESHMËRIA DHE KORREKTËSIA

Ky dimension ka të bëjë me vlerësimin e besueshmërisë dhe korrektësisë së burimit të të dhënave dhe teknikave statistikore të përdorura.

4.1. BURIMI I TË DHËNAVE:

i) Të dhënat duhet të merren nëpërmjet programeve gjithëpërfshirëse që marrin parasysh kushtet specifike të vendit.

Ekzistenca e një numri relativisht të vogël bankash dhe grupimi i ShKK-ve në dy unione[15], ka mundësuar një kontroll të mirë të statistikave monetare mbi burimet e informacionit. Si të tilla për statistikat monetare shërbejnë regjistrimet kontabile (në formën e bilancit kontabël) të bankave të nivelit të dytë, Bankës së Shqipërisë dhe ShKK- ve. Në krijimin e këtyre pasqyrave janë marrë parasysh kërkesat kryesore të statistikave monetare dhe financiare që kanë të bëjnë me sektorizimin dhe me klasifikimin e instrumenteve financiare. Në lidhje me institucionet e tjera financiare, është synuar që raportimi të ketë detajet e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të statistikave, por njëkohësisht të jetë brenda mundësive aktuale të raportimit të institucioneve.

[15] *Sipas raportimit të fundvitit 2004, në Bankën e Shqipërisë janë të licencuara dy unione. Unioni "Jehona", me 42 ShKK anëtarë dhe "Unioni shqiptar i kursim – kreditit" me 90 ShKK anëtarë.*

Ekzistenca e një zyre që administron raportimet dhe që i kontrollon ato në bazë të një dokumentacioni të plotë të miratuar dhe përdorimi i të njëjtit informacion edhe për mbikëqyrjen bankare, jo vetëm mundëson konsistencën në raportim, por edhe krijon hapësirë për sinjalizimin në kohë të statistikave monetare qoftë për saktësinë e raportimeve, qoftë për situata të reja të shfaqura në bilancet e bankave.

Përsa i përket statistikave të bilancit të pagesave nuk ka një rregull të ngurtë që përcakton qartë burimet nga të cilat duhet të rrjedhë informacioni statistikor për mbushjen e tabelës së bilancit të pagesave. Burimet variojnë nga një vend në tjetrin në varësi të veçorive të secilës ekonomi dhe kuadrit ligjor e rregullator të përshtatur nga vende të ndryshme. Aktualisht, Zyra e Bilancit të Pagesave mbledh informacion nga doganat për import – eksportin e mallrave, nga KESH për atë të energjisë elektrike, nga disa forma raportimi nga bankat për zëra të ndryshëm si shërbimet, të ardhurat, transfertat private e llogaria financiare, plotësuar këto nga raportime të disa agjencive publike e private. Gjithashtu, informacion merret nga Ministria e Financave për transfertat shtetërore e borxhin e qeverisë, nga Ministria e Ekonomisë për grantet etj.. Vrojtimet statistikore janë burimi më i gjerë i informacionit dhe si të tilla ato kryhen në përputhje praktikat më të mira. Përgjithësisht, synohet që zgjedhja e marrë për të kryer vrojtimin të jetë përfaqësuese e popullsisë së synuar dhe sa më e azhornuar.

i) Të dhënat përafrojnë në mënyrë të arsyeshme përkufizimet, mbulimin, klasifikimin, vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të kërkuar për statistikat.

Përgjithësisht për statistikat monetare të dhënat janë të përshtatshme në lidhje me kriteret e përmendura më sipër. Duke qenë se për institucionet e tjera financiare po shfrytëzohen të dhënat ekzistuese të këtyre institucioneve (pra pa kërkuar ndryshime në rregullat e kontabilizimit apo të vlerësimit), rëndësi i është kushtuar identifikimit të ndryshimeve nga standardi dhe përdorimit të teknikave alternative statistikore për rregullimin e tyre.

Përsa i përket statistikave të bilancit të pagesave, megjithëse metodat e grumbullimit të të dhënave që përdoren (si ato bazuar në forma raportimi ashtu dhe vrojtimet), janë në përputhje me udhëzimet e manualit BPM5 të FMN-së, të dhënat që ato sigurojnë nuk janë gjithmonë të mjaftueshme për të përballuar një mbulim më të madh. Kështu mbetet gjithmonë problem grumbullimi i informacionit për sektorin privat për sa i përket një pjese të shërbimeve, flukseve të detyrimeve, të ardhurat nga emigrantët, investimi i huaj direkt etj..

ii) Të dhënat duhet të raportohen në kohë.

Vendosja e afateve të raportimit për subjektet që raportojnë në Bankën e Shqipërisë, bëhet duke marrë parasysh mundësitë reale të tyre si dhe kërkesat e standardeve statistikore për shpërndarjen në kohë të statistikave. Në statistikat monetare kjo realizohet pothuajse plotësisht për të dhënat e bankës qendrore (bilanci kontabël), por herë pas here ka vështirësi në arritjen e afatit nga

bankat e nivelit të dytë, sidomos për fundin e vitit. Gjithashtu, nga SHKK-të kërkohet të raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo tremujor. Duke u nisur nga pesha e tyre në aktivitetin kredidhënës dhe depozitues, është gjykuar se periodiciteti aktual është i mjaftueshëm si për qëllimet statistikore edhe për ato mbikëqyrëse.

4.2. VLERËSIMI I BURIMIT TË TË DHËNAVE:

i) Të dhënat që raportohen nga subjektet duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet e këtij kontrolli monitorohen për të drejtuar proceset statistikore.

Për statistikat monetare një gjë e tillë realizohet nëpërmjet Zyrës së Administrimit të Raportimeve. Gjithashtu, nëpërmjet bazës së të dhënave SARS realizohet kontrolli automatik i konsistencës së raportimeve individuale. Dokumentacioni i kontrollit mbahet në mënyrë të rregullt nga kjo zyrë dhe i vihet në dispozicion çdo muaj Departamentit të Mbikëqyrjes.

Gjithashtu, çdo tremujor monitorohet nga Departamenti i Kontrollit kompilimi i të dhënave mujore të autoritetit monetar.

5. DOBISHMËRIA

5.1. PERIODICITETI DHE AFATI I PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE NGA DATA E REFERENCËS:

i) Periodiciteti.

Periodiciteti i pranimit të raportimeve për bankat dhe ShKK-të dhe shpërndarja e tyre është mujore dhe përputhet me standardet e shpërndarjes së të dhënave SDDS dhe GDDS të FMN-së. Ndërkohë, SHKK-të raportojnë me periodicitet tremujor. Statistikat e bilancit të pagesave shpërndahen në bazë tremujore dhe ky periodicitet është në përputhje me standardet e GDDS dhe SDDS.

ii) Afati i publikimit të të dhënave nga data e referencës[16].

Përsa i përket kohës ndërmjet datës së referencës dhe datës së publikimit, të dhënat për sistemin bankar raportohen si rregull 40 ditë kalendarike nga data e fundit të muajit. Megjithëse brenda standardeve të GDDS (2-3 muaj), akoma nuk është arritur koha sipas standardit SDDS (një muaj) sidomos për të dhënat e muajit dhjetor, ndërkohë që të dhënat mbi bankën qendrore shpërndahen në kohë. Vlen të përmendet se nëpërmjet përdorimit të faqes së internetit si mjet publikimi është arritur shkurtimi i kohës së shpërndarjes së treguesve statistikorë. Të dhënat e bilancit të pagesave, si rregull raportohen në rreth 2 muaj nga data e referencës, duke qenë kështu brenda standardeve GDDS dhe SDDS.

[16] *Në origjinal: timeliness.*

5.2. INTEGRITETI:

Integriteti i treguesve të statistikave monetare dhe financiare dhe statistikave të bilancit të pagesave, vlerësohet brenda një grupi treguesish të statistikave në një moment të caktuar, brenda një periudhe kohe ose ndërmjet burimeve të ndryshme, si për shembull ndërmjet treguesve të bilancit të pagesave, të qeverisë apo të statistikave monetare dhe financiare.

i) Statistikat duhet të kenë integritet brenda grupit.

Në statistikat monetare, duke qenë se ende nuk kompilohen të dhëna për sektorin financiar në lidhje me kontrollin e integritetit brenda një grupi treguesish, kontrolli i integritetit kufizohet vetëm në krahasimin e të dhënave të bankave të nivelit të dytë me të dhënat e Bankës së Shqipërisë.

Përsa i përket bilancit të pagesave konceptet , përkufizimet e klasifikimet janë të njëjta si në kompilimin e statistikave tremujore dhe të atyre vjetore. Një kriter i mirë kontrolli do të ishte krahasimi i flukseve të bilancit me ndryshimet e gjendjeve në "Pozicionin Ndërkombëtar të Investimit", i cili akoma nuk kompilohet në Bankën e Shqipërisë.

ii) Statistikat duhet të kenë integritet brenda një periudhe të arsyeshme kohe (si rregull pesë vjet).

Konsistenca brenda një periudhe kohore nënkupton shtrirjen mbrapa në kohë të ndryshimeve në metodologji apo në burimin e të dhënave, shpjegimin e detajuar të këputjeve kryesore të serive kohore, duke përfshirë shkaqet e tyre dhe axhustimet e nevojshme që duhen bërë, për të siguruar konsistencën në kohë dhe shpjegimin e ndryshimeve të pazakonta në prirjen e treguesve statistikorë. Duke qenë se është e pamundur të ndërtohen seritë e reja për periudha më të hershme, është në proces puna për ndërtimin e tabelave "urë" të detajuara, të cilat do të mundësojnë vazhdueshmërinë e treguesve pas ndryshimeve metodologjike. Për treguesit e statistikave monetare dhe financiare ka përfunduar një analizë e parë, e cila ka qëllim të përshkruajë prirjen e treguesve, të kapë "ngjarjet" në vite etj..

5.3. EKZISTENCA E NJË POLITIKE PËR RISHIKIMIN E TË DHËNAVE SI DHE PUBLIKIMI I SAJ:

i) Rishikimet duhet të ndjekin një kalendar të rregullt dhe të jenë transparente.

Përdoruesit e statistikave duhet të njohin praktikat e rishikimit të të dhënave. Gjithashtu duhet ditur nëse të dhënat janë paraprake apo përfundimtare. Rishikimet në statistikat monetare dhe financiare si rregull, ndodhin për arsye të rishikimit të bilanceve të bankave të nivelit të dytë pas kontrollit nga kontrollorët e jashtëm ose nga mbikëqyrja (on site) e Bankës së Shqipërisë. Në statistikat monetare ndryshimet përfshihen në publikimin e rradhës. Për rrjedhojë, të dhënat quhen përfundimtare në momentin e parë që publikohen

dhe rishikohen nëse është e nevojshme. Meqë akoma nuk ekziston një metodologji e qartë dhe e miratuar për rishikimin e të dhënave nuk mund të dihet paraprakisht se kur pritet rishikimi i tyre. Dokumentacioni i rishikimeve, që përfshin arsyet e ndryshimit, masën e ndryshimit etj., megjithëse mbahet rregullisht nga zyra e statistikave monetare dhe financiare nuk publikohet bashkë me të dhënat. Për statistikat e bilancit të pagesave, revizionime bëhen në mënyrë të rregullt në lidhje me vlerësime paraprake, azhornime, ndryshime metodologjie etj.. Tabelat e revizionuara publikohen, por jo dokumentacioni i revizionimeve përkatëse.

Në këtë kuadër, do të ishte i nevojshëm publikimi i një kalendari që do të mbulojë ndryshimet dhe arsyet përkatëse.

6. E DREJTA E PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE.

Ky dimension nënkupton që të dhënat dhe shpjegimet për to (metadatat) të mund të gjenden lehtësisht nga përdoruesi.

1.1. E drejta e përdorimit të të dhënave.

i) Statistikat duhet të prezantohen në mënyrë që të interpretohen dhe të krahasohen lehtësisht (nëpërmjet tabelave, grafikëve etj.).

Përgjithësisht, statistikat e publikuara nga Banka e Shqipërisë tashmë shpërndahen në mënyrë të qartë dhe në nivele të ndryshme agregimi për t'iu përgjigjur kategorive të ndryshme të përdoruesve. Buletinet statistikore gjithashtu përmbajnë komente mbi zhvillimet e periudhave korente.

ii) Mjetet dhe format e shpërndarjes duhet të jenë të përshtatshme.

Statistikat e prodhuara në Bankën e Shqipërisë shpërndahen nëpërmjet internetit dhe në letër. Ato mund t'i përdorë çdo i interesuar, pa asnjë dallim. Mënyra aktuale e shpërndarjes si dhe nivelet e ndryshme të detajimit të treguesve statistikorë të publikuar në internet, janë lehtësisht të përdorshme për grupe të ndryshme përdoruesish.

iii) Statistikat duhen shpërndarë sipas një kalendari të paracaktuar.

Për statistikat e publikuara nga Banka e Shqipërisë ekziston një kalendar që tregon paraprakisht datat e publikimit të treguesve. Si kërkesë e SDDS është që një kalendar i tillë t'i bëhet i ditur përdoresve, si rregull, tre muaj para datës së shpërndarjes së të dhënave.

iv) Statistikat u duhen shpërndarë të gjithë përdoruesve[17] në të njëjtën kohë.

Nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, që është dhe mënyra më e hershme që u bëhet të dhënave statistikore, realizohet

[17] *Këtu bëhet fjalë për përdoruesit e jashtëm, të cilët mund të përdorin informacionin për qëllime biznesi. Ky kriter synon parandalimin e favorizimit të një përdoruesi (ose grupi përdoruesish) të veçantë nëpërmjet dhënies së përparësisë në kohë.*

dhe shpërndarja e njëkohshme e statistikave tek të gjithë përdoruesit e interesuar.

6.2. E DREJTA E PËRDORIMIT TË METODOLOGJISË SË INFORMACIONIT (METADATAT):

i) Dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin, metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore duhet të publikohet. Po njësoj duhet të publikohen dhe ndryshimet nga standardet ndërkombëtare.

Për statistikat monetare dhe financiare mund të thuhet se ekziston një informacion i plotë mbi mënyrën e kompilimit të treguesve statistikorë. "Metodika e statistikave monetare dhe financiare, BSh, Korrik 2003", që përbën bazën e punës metodologjike të statistikave monetare dhe financiare dhe metadatat analitike për kompilimin e treguesve është e publikuar në internet. Në lidhje me statistikat e bilancit të pagesave, metodologjia e kompilimit të statistikave – një përshtatje e manualit BPM5 të FMN-së - ekziston për përdorim të sektorit; ajo nuk është e publikuar në internet.

ii) Nivelet e detajimit u duhen përshtatur nevojave të auditorit të synuar.

Krahas "Metodikës së statistikave monetare dhe financiare, BSh, Korrik 2003", në bazën e të dhënave "Seri kohore", për çdo tabelë dhe tregues jepet përmbajtja dhe domethënia e tyre. Këto metadata janë të përshtatura për një kategori më të gjerë përdoruesish. Përshkrime (metadata) analoge ekzistojnë edhe për statistikat e bilancit të pagesave.

6.3. NDIHMA NDAJ PËRDORUESVE:

Duhen vendosur persona kontakti për çdo fushë dhe duhet të ekzistojnë katalogë të publikimeve dhe të shërbimeve të tjera për përdoruesit e statistikave.

Në lidhje me statistikat që shpërndan Banka e Shqipërisë, ekzistojnë persona kontakti për çdo grup statistikash. Gjithashtu, nëpërmjet faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë publikohet lista e të gjitha publikimeve periodike dhe joperiodike të Bankës së Shqipërisë, përfshirë dhe ato që kanë lidhje me statistikat. Duhet vlerësuar ndihma që ka dhënë përfshirja në Projektin GDDS të Fondit në këtë drejtim, që ka rritur numrin e konsultuesve për statistikat shqiptare, si dhe për faktin që në standardet publikuese përkatëse kërkohet publikimi i personave të kontaktit sipas sektorëve të statistikës.

Në tabelën e dhënë në aneksin bashkëngjitur jepen treguesit e cilësisë së të dhënave sipas standardeve të Projektit DQAF të Fondit.

Aneks: Treguesit e cilësisë së të dhënave:

Dimensionet:	Elementet e dimensioneve:	Kriteret:
1. Kushtet paraprake të cilësisë së të dhënave	1.1. Ekzistenca e një mjedisi ligjor dhe institucional që mbështet statistikat	i) Ligji shprehet në mënyrë të qartë mbi përgjegjësinë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e një kategorie të dhënash.
		ii) Koordinimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet agjencive që prodhojnë të dhënat duhet të jenë të përshtashme.
		iii) Të dhënat individuale të raportuara duhet të jenë konfidenciale dhe të përdoren vetëm për qëllime statistikore.
		iv) Raportimi statistikor nga subjektet duhet mbështetur nga një mandat ligjor ose masa të tjera që nxisin përgjigjen.
	1.2. Burimet – burimet duhet të jenë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të programeve statistikore	i) Burimet njerëzore duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		ii) Niveli i teknologjisë të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		iii) Lehtësitë fizike dhe burimet e tjera, si transporti, komunikimi etj. duhet të jenë në nivelin e duhur për të përmbushur detyrat në përputhje me programet statistikore.
		iv) Financimi për kompilimin e statistikave – përmbushja e kërkesave për të plotësuar detyrat në përputhje me programet statistikore.
		v) Vendosja e mekanizmave për një përdorim eficient të burimeve.
	1.3. Dobishmëria e të dhënave	i) Dobishmëria praktike e statistikave ekzistuese duhet të monitorohet.
	1.4. Cilësi të tjera të administrimit – cilësia e informacionit, si një moment themelor në punën me statistikat	
2. Integriteti i të dhënave	2.1. Profesionalizmi	i) Statistikat prodhohen në mënyrë të paanshme.
		ii) Përzgjedhja e burimeve dhe e teknikave statistikore duhet të bazohet vetëm në konsiderata statistikore.
		iii) Mundësia e institucionit për të reaguar ndaj keqinterpretimit të të dhënave dhe keqpërdorimit të tyre.
	2.2. Transparenca e proceseve statistikore	i) Kushtet dhe termat në të cilat të dhënat statistikore mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen duhet të publikohen.
		ii) Publiku duhet të njoftohet paraprakisht mbi njësitë qeveritare që kanë të drejta përdorimi mbi informacionin para se ai të bëhet publik.
		iii) Agjencia duhet të identifikojë të dhënat statistikore që prodhon dhe shpërndan, në mënyrë që publiku të ketë të qartë se për çfarë mban përgjegjësi agjencia.
		iv) Ndryshimet kryesore në metodologji, në burimin e të dhënave dhe në teknikat statistikore duhet të njoftohen paraprakisht.
	2.3. Standardet e etikës – politikat dhe praktikat janë të udhëhequra nga standardet etike.	i) Ekzistojnë standarde të plota etike, të miratuara nga institucioni.
		ii) Gjithashtu, këto standarde etike duhet të njihen mirë nga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit.
3. Metodologjia		
4. Besueshmëria dhe korrektësia	4.1. Burimi i të dhënave:	i) Të dhënat duhet të merren nëpërmjet programeve gjithëpërfshirëse që marrin parasysh kushtet specifike të vendit.
		ii) Të dhënat përafrojnë në mënyrë të arsyeshme përkufizimet, mbulimin, klasifikimin, vlerësimin dhe kohën e regjistrimit të kërkuar për statistikat.
		iii) Të dhënat duhet të raportohen në kohë.
	4.2. Vlerësimi i burimit të të dhënave:	iv) Të dhënat që raportohen nga subjektet duhet të kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet e këtij kontrolli monitorohen për të drejtuar proceset statistikore.
5. Dobishmëria	5.1. Periodiciteti dhe afati i publikimit së të dhënave nga data e referencës	i) Periodiciteti.
		ii) Afati i publikimit të të dhënave nga data e referencës.
	5.2. Integriteti	i) Statistikat duhet të kenë integritet brenda grupit.
		ii) Statistikat duhet të kenë integritet brenda një periudhe të arsyeshme kohe (si rregull pesë vjet).
	5.3. Ekzistenca e një politike për rishikimin e të dhënave si dhe publikimi i saj	i) Rishikimet duhet të ndjekin një kalendar të rregullt dhe të jenë transparente.
6. E drejta e përdorimit të të dhënave	6.1. E drejta e përdorimit të të dhënave	i) Statistikat duhet të prezantohen në mënyrë që të interpretohen dhe të krahasohen lehtësisht (nëpërmjet tabelave, grafikëve etj.).
		ii) Mjetet dhe format e shpërndarjes duhet të jenë të përshtatshme.
		iii) Statistikat duhen shpërndarë sipas një kalendari të paracaktuar.
		iv) Statistikat u duhen shpërndarë të gjithë përdoruesve në të njëjtën kohë.
	6.2. E drejta e përdorimit të metodologjisë së informacionit (metadatat)	i) Dokumentacioni mbi konceptet, mbulimin, klasifikimin, metodat e regjistrimit, burimet e informacionit dhe teknikat statistikore duhet të publikohet. Po njësoj duhet të publikohen dhe ndryshimet nga standardet ndërkombëtare.
		ii) Nivelet e detajimit u duhen përshtatur nevojave të auditorit të synuar.
	6.3. Ndihma ndaj përdoruesve	i) Vendosen persona kontakti për çdo fushë dhe ekzistojnë katalogë të publikimeve dhe shërbimeve të tjera për përdoruesit e statistikave.

REFERENCAT:

Kuvendi Popullor, (1997). Ligji "Për Bankën e Shqipërisë", nr. 8296, datë 23.12.1997.

Kuvendi Popullor, (2004). Ligji "Për Statistikat Zyrtare", nr.9180, datë 5.2.2004.

Banka e Shqipërisë, (2003). "Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare, Korrik 2003".

Banka e Shqipërisë, 2000, rregullorja"Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë" nr. 53, datë 21.06.2000.

Banka e Shqipërisë, (2003) "Kodi i Etikës së Bankës së Shqipërisë", nr.46, datë 25.06.2003.

Banka e Shqipërisë, rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" (së bashku me ndryshimet përkatëse).

Banka e Shqipërisë, rregullorja "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre".

IMF, (Korrik 2003). "Data Quality Assessment Framework".

IMF, (2000). "Manual of Montary and Financial Statistics, IMF".

IMF, (1993). "Balance of Payments Manual, 5th edition, IMF".

IMF, (1999). "Special Data Dissemination Standards, IMF".

IMF, (1999). "General Data Dissemination System, IMF".

BANKA E SHQIPËRISË DHE ANGAZHIMI I SAJ NË KUADËR TË PROCESIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT*,**

"Integrimi evropian", "procesi i Stabilizim-Asociimit", "negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit": këta janë vetëm disa nga termat me të cilët qytetarët shqiptarë përballen çdo ditë, jo vetëm në median e shkruar dhe në atë vizive, por edhe në fjalorin e politikanëve dhe pse jo, edhe në bisedat e përditshme. Qëllimi i këtij artikulli të shkurtër është që të japë një informacion të përgjithshëm dhe sa më të kuptueshëm për lexuesin e thjeshtë, në lidhje me rolin e Bankës së Shqipërisë, si një institucion mjaft i rëndësishëm monetar dhe financiar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka detyrimet e veta në kuadër të procesit të integrimit evropian në përgjithësi, dhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në veçanti.

HAPI I PARË DREJT NJË BALLKANI PERËNDIMOR EVROPIAN: PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Vitet '90 shënuan një periudhë të konflikteve të dhunshme etnike dhe të një paqëndrueshmërie të theksuar politike pothuajse në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këto kushte, Komisioni Evropian ra dakord në muajin maj të vitit 1999, për parimet kryesore që do të udhëhiqnin një strategji më ambicioze të Bashkimit Evropian (BE) në marrëdhëniet e kësaj organizate me vendet e rajonit. Këto parime konsistonin në:

- mendimin e Komisionit Evropian se motivimin kryesor për kryerjen e reformave në këto vende – duke përfshirë vendosjen e sundimit të ligjit, të institucioneve të qëndrueshme demokratike dhe të një ekonomie të lirë dhe të hapur tregu – do ta përbënte ofrimi i një perspektive të besueshme për anëtarësim të vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian sapo që të përmbusheshin kushtet e vendosura nga kjo organizatë. Kjo perspektivë e qartë për anëtarësim në të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, u ofrua për herë të parë në Samitin e Feiras në qershor 2000 dhe u rikonfirmua më me shumë forcë në Samitin e Selanikut, të mbajtur në qershor 2003.
- nevojën për vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet vendeve të rajonit, gjë që do të krijonte mundësi për më shumë qëndrueshmëri politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor.
- nevojën për një përqasje më fleksibël, e cila do të lejonte çdo vend që të ecte në rrugën e tij drejt Bashkimit Evropian në mënyrë të pavarur, edhe pse do të ekzistonte një grup i kushteve ekonomike dhe politike, që do të zbatohej për të gjitha këto vende. Në të njëjtën kohë, programet e asistencës financiare dhe teknike do të duhet të hartoheshin në bazë të nevojave specifike të secilit vend.

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

** Ina Kraja, Niuton Mulleti, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, Banka e Shqipërisë.

Të gjitha këto parime të vendosura nga Komisioni Evropian u konkretizuan në Samitin e Zagrebit të datës 24 nëntor 2000, ku u paraqitën edhe elementet përbërëse të Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA). Në këmbim të perspektivës së qartë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, bazuar në Traktatin e Mastrihtit dhe kriteret e Kopengahenit si dhe në përgjigje të asistencës të ofruar nga Bashkimi Evropian, vendet e rajonit u angazhuan që të përmbushnin kushtet e vendosura nga kjo organizatë dhe të përdornin Procesin e Stabilizim-Asociimit e në veçanti Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA), në mënyrë që të përgatiteshin për një anëtarësim të ardhshëm në Bashkimin Evropian.

Procesi i Stabilizim-Asociimit konsiston në këto elemente të mëposhtme:

a) Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit: Këto marrëveshje përbëjnë si thelbin e PSA-së, ashtu edhe një hap mjaft të rëndësishëm drejt realizimit të plotë të këtij procesi. Nënshkrimi i MSA-ve përfaqëson angazhimin dhe vullnetin e palëve nënshkruese për të përfunduar brenda një periudhe kalimtare një asociim formal me BE-në. MSA-të ofrojnë mekanizmat formalë dhe pikat e referimit, që e lejojnë BE-në të punojë me secilin vend në mënyrë që t'i sjellë ato më afër standardeve të BE-së.

MSA-të përqendrohen në respektimin e parimeve themelore demokratike si dhe të elementeve bazë të tregut unik të BE-së. Përmes krijimit të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, shoqëruar edhe me fushat (rregullat e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, pronësia intelektuale etj.) dhe përfitimet (për shembull, e drejta e vendosjes në vendet e BE-së) e lidhura me këtë treg, ky proces do të lejojë ekonomitë e gjithë rajonit që të fillojnë të integrohen gradualisht me atë të BE-së. Për ato fusha ku marrëveshjet nuk vendosin detyrime specifike në lidhje me *acquis communautaire* (legjislacioni komunitar) të BE-së, ekzistojnë dispozita që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e detajuar me BE-në, me synim kryesor dhënien e ndihmës këtyre vendeve për t`u afruar me standardet e BE-së.

MSA-të janë të përgatitura sipas rrethanave specifike të secilit vend. Sidoqoftë, siç u tha më sipër, synimi i çdo MSA-je është arritja e një asociimi zyrtar ndërmjet çdo vendi të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, dhe ky asociim do të realizohet përmes zbatimit të një sërë detyrimesh të cilat janë të njëjta për secilin vend.

Vetë mekanizmat e krijuar nga këto marrëveshje, duke filluar nga nënkomitetet e specialistëve dhe teknicienëve e deri tek organet e nivelit politik, siç është Këshilli i Stabilizim-Asociimit, do të lejojnë që BE t'i kushtojë rëndësi reformave sipas përparësive që ato paraqesin si dhe t'i formësojë ato sipas modeleve të BE-së, të zgjidhë problemet e mundshme dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga vendet nënshkruese. Zbatimi i plotë i MSA-ve është një parakusht për vlerësimin e mundësisë që një vend ka për t'u anëtarësuar në BE.

b) Asistenca e BE-së: Programi i BE-së CARDS (Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim) i ka shtuar asistencës për vendet e PSA-së një përbërës që synon lehtësimin e rrugës së tyre drejt BE-së. Kjo asistencë përdoret

kryesisht për të mbështetur financiarisht dhe teknikisht kryerjen e reformave dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale që parashikohen në MSA.

c) Dimensioni rajonal: PSA nuk është thjesht një proces dypalësh ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, por në të njëjtën kohë, ai i jep një rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal. MSA-të përmbajnë dispozita të posaçme, që parashikojnë një angazhim të qartë të secilit vend për të bashkëpunuar nga afër me vendet e tjera të përfshira në PSA. Në të njëjtën kohë, edhe CARDS ka një përbërës të rëndësishëm rajonal.

Më konkretisht, dimensioni rajonal i PSA-së parashikon që vendet e rajonit të firmosin me njëri-tjetrin konventa të bashkëpunimit rajonal si dhe të krijojnë një rrjet të marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë (si pjesë e konventave të mësipërme). Kjo do të thotë që nuk do të ekzistojnë më pengesa për lëvizjen e lirë të mallrave ndërmjet vendeve të rajonit ashtu si edhe me BE-në. Edhe integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor me rrjetet evropiane të infrastrukturës (transporti, energjia, administrimi i kufijve) përbëjnë një tjetër element të rëndësishëm të dimensionit rajonal të PSA-së.

SHQIPËRIA DHE PROCESI I STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Marrëdhëniet e para kontraktuale midis Shqipërisë dhe BE-së u vendosën në vitin 1992, nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Menjëherë pas adoptimit të PSA-së, në vitin 2001, Komisioni Evropian vendosi që të procedonte me negociatat për nënshkrimin e MSA-së me Shqipërisë, ndërsa direktivat për negociatat me vendin tonë u miratuan nga BE, në tetor 2002. Këto negociata u hapën më 31 janar 2003 dhe deri më tani janë zhvilluar 6 raunde zyrtare dhe 9 raunde teknike, ku edhe janë negociuar dhe mbyllur pjesa më e madhe e neneve të marrëveshjes.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2004, ashtu si edhe për të gjitha vendet e rajonit, Komisioni Evropian paraqiti Dokumentin e Partneritetit Evropian për Shqipërinë. Ky dokument përcaktonte konkretisht fushat në të cilat duhet të kryheshin reforma, shoqëruar kjo edhe me afatet përkatëse. Në përgjigje të këtij dokumenti, Qeveria Shqiptare miratoi në shtator 2004 Planin e Veprimit për Zbatimin e Përparësive të Parneritetit Evropian. Ky Plan i Veprimit përmbante, në formë tabelore, të gjitha masat që institucionet shqiptare (përshirë edhe Bankën e Shqipërisë) do të duhet të ndërmerrnin në kuadër të detyrimeve që rridhnin nga Dokumenti i Partneritetit Evropian. Sidoqoftë, megjithë miratimin e këtij Plani të Veprimit, bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit Evropian dhe në përvojën e vendeve që kanë kaluar më parë përmes një procesi të ngjashëm, Qeveria Shqiptare vazhdoi punën për hartimin dhe adoptimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA, i cili do të plotësonte dhe do të përmirësonte angazhimet e ndërmarra në Planin e Veprimit.

Ky Plan Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit (PKPL), i cili u miratua në maj të vitit 2005, ka si pikësynim kryesor sigurimin e përshtatjes dhe përafrimit

të legjislacionit vendas me atë komunitar si dhe zbatimin rigoroz të tij. Në të njëjtën kohë, ky Plan ofron një kalendar të qartë, me afate të përcaktuara (në periudhë afatshkurtër, afatmesme ose afatgjatë), mbi të cilin çdo institucion përgjegjës do të mbështesë punën e tij në të ardhmen, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

BANKA E SHQIPËRISË DHE MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT.

Që nga fillimi i negociatave për nënshkrimin e MSA-së në janar 2003, Banka e Shqipërisë ka qenë e përfaqësuar në grupin negociator shqiptar, duke marrë pjesë në të gjitha raundet zyrtare dhe teknike të negociatave, të cilat janë zhvilluar deri tani. Banka e Shqipërisë ka qenë sidomos e angazhuar në negociimin e periudhave tranzitore të disa neneve të marrëveshjes, prej të cilëve dy janë të një rëndësie të veçantë: nenet 57 dhe 61.[1]

Neni 57, i cili mbulon fushën e ofrimit të shërbimeve, parashikon që palët nënshkruese do të marrin masat e nevojshme që të lejojnë progresivisht ofrimin e shërbimeve nga kompani ose shtetas të BE-së ose të Shqipërisë në vendet përkatëse. Në të njëjtën kohë, ky nen parashikon që duke filluar nga viti i tretë pas hyrjes në fuqi të MSA-së, Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar progresivisht detyrimet e ndërmarra si më sipër.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve bankare në Shqipëri nga operatorët komunitarë, fushë kjo ku sipas këtij neni Banka e Shqipërisë është drejtpërdrejt përgjegjëse, duhet theksuar që mbështetur në legjislacionin ekzistues vendas, nuk ka asnjë pengesë, kufizim apo diskriminim në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve në territorin e Shqipërisë. Për këtë arsye, zbatimi i këtij neni nuk pritet të paraqesë ndonjë problem të madh për Bankën e Shqipërisë.

Neni 61, i cili mbulon liberalizimin e llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave mbart një rëndësi mjaft të madhe.

Bazuar në këtë nen:

- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet direkte të bëra nga kompani, që janë themeluar në përputhje me ligjet e vendit pritës së bashku me likuidimin apo riatdhesimin e këtyre investimeve si dhe të çdo fitimi që rrjedh nga këto investime.
- duke filluar nga hyrja në fuqi e MSA-së, palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me kreditë e lidhura me transaksionet tregtare apo ofrimin e shërbimeve, si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të madh se një vit.

[1] *Duke qenë se MSA nuk është nënshkruar ende, duhet patur parasysh që dispozitat e këtyre neneve që do të diskutohen më poshtë përfaqësojnë versionin më të fundit dhe jo domosdoshmërisht atë përfundimtar.*

- duke filluar nga fillimi i periudhës së dytë kalimtare (pesë vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-së), palët do të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investimet e portofolit si dhe të huave dhe kredive financiare me maturitet më të vogël se një vit.
- për sa i përket blerjes së pasurive të paluajtshme nga shtetas të BE-së, Shqipëria është e detyruar që brenda një periudhe dhjetëvjeçare nga hyrja në fuqi e MSA-së, të sigurojë progresivisht blerjen e tokës bujqësore, të kullotave, të tokës bregdetare dhe pyjeve nga shtetasit e huaj, sipas të njëjtave kushte dhe procedura që zbatohen edhe për shtetasit shqiptarë.

Legjislacioni shqiptar në fushën e lëvizjeve të kapitalit përfaqësohet nga rregullorja "Për veprimtarinë valutore", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në korrik 2003. Sipas kësaj rregulloreje, flukset hyrëse të kapitalit në Shqipëri janë tërësisht të liberalizuara, ndërsa për sa i përket daljes së kapitalit, ky proces nuk kërkon më autorizim nga Banka e Shqipërisë, por ky transferim kryhet nga subjekte të licencuara nga Banka e Shqipërisë, pra banka dhe jobanka, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar. Me qëllim liberalizimin total të këtij procesi dhe përputhjen e plotë me *acquis*-in e BE-së, si dhe të faktit që transaksionet e llogarisë kapitale nuk janë në varësi të drejtpërdrejtë vetëm të Bankës së Shqipërisë, por ekzistojnë edhe institucione të tjera që kanë detyrimet e tyre si lidhur me shitblerjen e tokës, veprimet e lëvizjes fizike të kapitalit, investimet direkte etj., është gjykuar i nevojshëm nga Banka e Shqipërisë hartimi i ligjit "Për regjimin e këmbimeve valutore", i cili do të pasqyrojë *acquis*-in e BE-së në këtë fushë.

Hartimi dhe miratimi i këtij ligji kaq të rëndësishëm sigurisht që është përfshirë në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL), së bashku edhe me një sërë ligjesh (si për shembull, ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë") dhe aktesh normative (kryesisht në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe të sistemit të pagesave), të cilat do të duhet të amendohen nga Banka e Shqipërisë dhe të përshtaten me *acquis*-in, brenda afateve të përcaktuara në këtë Plan.

RRUGA DREJT BE-SË: ÇFARË NA PRET NË TË ARDHMEN?

Siç e thamë edhe më lart, me nënshkrimin e MSA-së ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, midis palëve do të jetë krijuar një asociim formal, i cili sigurisht që do të përbëjë një rritje në nivelin e marrëdhënieve dypalëshe. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, fokusi do të jetë mbi zbatimin e saj në praktikë. Banka e Shqipërisë, ashtu si edhe institucionet e tjera përgjegjëse, detyrimet e saj për zbatimin e dispozitave përkatëse do t'i kryejë bazuar në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit.

Në të njëjtën kohë, duhet përmendur një zhvillim i ri që ka të bëjë me përgatitjen e Instrumentit për Para-Anëtarësim (Instrument for Pre-Accession) nga ana e Komisionit Evropian. Pika më e rëndësishme dhe domethënëse e këtij instrumenti është konsiderimi i Shqipërisë (së bashku me Bosnjë-

Hercegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë-Malin e Zi) si një "kandidat potencial për anëtarësim", një status ky që konfirmon dhe përforcon perspektivën e qartë për anëtarësim, që iu ofrua vendeve të rajonit tonë në Samitin e Feiras dhe sidomos në atë të Selanikut, në vitin 2003.

Duke u bazuar edhe në përvojën e deritanishme të vendeve të rajonit (Bullgari, Rumani dhe Kroaci), të cilat ose pritet të anëtarësohen së shpejti në BE ose të fillojnë negociatat për anëtarësim, mund të parashikojmë edhe serinë e ngjarjeve që do të pasojnë hyrjen në fuqi të MSA-së. Vijimi i hapave të mëtejshëm të procesit të integrimit do të jetë i tillë: aplikimi për statusin e vendit kandidat për anëtarësim, pranimi i këtij statusi nga ana e BE-së, fillimi i negociatave për anëtarësim, negociimi dhe mbyllja e të 31 kapitujve të *acquis*-it, mbyllja zyrtare e negociatave për anëtarësim, nënshkrimi i traktatit të anëtarësimit të vendit në BE, ratifikimi i këtij traktati nga të gjitha vendet e BE-së dhe së fundmi, anëtarësimi i mundshëm në BE. Kohëzgjatja e këtij procesi varet, në masën më të madhe, nga ritmi i kryerjes së reformave prej vendit që aspiron për anëtarësim, por në të njëjtën kohë, edhe vendimi i vendeve anëtare të BE-së se me çfarë shpejtësie do të mundësojnë pranimin e vendeve të reja anëtare në gjirin e organizatës, është një faktor me ndikim të konsiderueshëm.

Sidoqoftë, ajo çfarë mund të themi si përfundim është fakti që procesi i integrimit evropian kërkon një angazhim mjaft të madh nga vendi aspirues për anëtarësim, i cili jo vetëm që duhet të ketë dëshirë dhe të tregojë vullnet për anëtarësim në BE, por në të njëjtën kohë duhet të zotërojë aftësi të mjaftueshme institucionale, financiare dhe profesionale për të realizuar reformat rrënjësore të nevojshme për një anëtarësim me të drejta të plota në BE. Në këtë kuadër, edhe Banka e Shqipërisë me siguri që do të jetë e angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit të saj institucional, operacional dhe ligjor, gjë që do të mundësonte një përafrim dhe përputhshmëri me sa më pak probleme të Bankës së Shqipërisë me standardet, me modelet dhe me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, në përgjithësi dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në veçanti.

INDEKSI I AFTËSISË SË SHËRBIMIT TË BORXHIT SOVRAN: A KA ARDHUR KOHA QË SHQIPËRIA TA SIGUROJË ATË?*,**

(SOVEREIGN CREDIT RATING)

Shqipëria është i vetmi vend në Evropë i cili nuk ka një Indeks të Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran (IASHBS). Megjithëse ka pasur disa përpjekje për të siguruar një indeks të tillë, për shkak të një numri faktorësh, analiza e të cilëve nuk është objekt i këtij shkrimi, vendi ynë ende nuk ka lëvizur konkretisht në këtë drejtim. Ndërkohë, sektori privat tashmë ka një institucion në sistemin bankar, i cili ka siguruar këtë indeks (megjithëse nëpërmjet grupit qendror). Banka Procredit në Shqipëri e ka siguruar këtë indeks që nga data 15 dhjetor 2004.

ÇFARË ËSHTË IASHBS?

Ky indeks është një vlerësim mbi aftësinë e kredimarrësit për ta shërbyer dhe kthyer përfundimisht borxhin ose mbi mundësinë e falimentimit. Në rastet kur borxhi merret nga qeveritë e shteteve atëherë i gjithë procesi i indeksimit është më i gjerë se sa për një kompani të caktuar, private apo shtetërore. Kompanitë kryesore në botë të cilat ofrojnë shërbimin e indeksimit janë, Standard & Poors, Moody's dhe Fitch Ratings. Këto kompani e ofrojnë këtë shërbim kundrejt një pagese dhe indeksi i përcaktuar prej tyre njihet botërisht nga investitorët për shkak se puna e tyre gëzon, thjeshtësi dhe krahasueshmëri, besueshmëri, transparencë dhe pavarësi. Për këtë arsye, ky indeks luan një rol mjaft të rëndësishëm nga pikëpamja e reklamës për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Ja si e përkufizojnë këto firma këtë indeks:

S&P- "Vlerësim i aftësisë dhe dëshirës së një qeverie për të shërbyer borxhin e saj në vlerë dhe në kohë."

FITCH- "Opinion mbi besueshmërinë e një borxhi të emetuar…Nuk është një rekomandim për të blerë apo për të shitur një letër me vlerë…"

Moody's…"Deklarime opinioni dhe jo deklarime faktesh…"

Pra, indeksi nuk duhet marrë si rekomandim në lidhje me aftësinë e një vendi për të shërbyer borxhin në të ardhmen, por vetëm si një nga treguesit që një investitor duhet të ketë parasysh para se të marrë një vendim në lidhje me një investim të mundshëm në një letër me vlerë të një vendi të caktuar, të emetuar në tregjet ndërkombëtare të parasë.

*Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

** Laert Dogjani, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, Banka e Shqipërisë.

VLERAT E INDEKSIT

Secila prej kompanive ka mënyrën e saj për të shprehur vlerën e indeksit. Ai paraqitet në trajtën e shkronjave duke filluar nga A e deri në shkronjën D. Konkretisht, vlerësimi më i lartë për Standard & Poors shprehet në trajtën AAA. Kjo trajtë paraqet mundësinë më të vogël të emetuesit të borxhit për të falimentuar. Megjithëse caktimi i shkronjave është i ndryshëm për të treja kompanitë, fare thjesht mund të bëhen paralelizma të këtyre indekseve si në tabelën më poshtë:

Fitch	Standard & Poor's	Moody's
AAA	AAA	Aaa
AA+	AA+	Aa1
AA	AA	Aa2
AA-	AA-	Aa3
A+	A+	A1
A	A	A2
A-	A-	A3
BBB+	BBB+	Baa1
BBB	BBB	Baa2
BBB-	BBB-	Baa3
BB+	BB+	Ba1
BB	BB	Ba2
BB-	BB-	Ba3
B+	B+	B1
B	B	B2
B-	B-	B3
CCC	CCC	Caa
CC	CC	Ca
C	C	C
D	D	D
NR	NR	NR

Indeksi NR (not rated) do të thotë që kompania apo vendi nuk është indeksuar.

KUR DUHET SIGURUAR NJË INDEKS I TILLË?

Në Memorandumin Shtesë të Politikave Ekonomike dhe Financiare, janar 2004, Qeveria Shqiptare i premton Fondit Monetar Ndërkombëtar se, "ne do të kërkojmë zyrtarisht një *sovereign rating* përpara fundit të vitit 2004." Në fakt është e vështirë të argumentosh se në ditët e sotme të globalizimit dhe të integrimit një vend të mund të plotësojë nevojat e tij për kredi pa iu drejtuar tregjeve financiare ndërkombëtare. Edhe debati në lidhje me kohën se kur një vend duhet të fillojë të tërheqë fonde nga tregjet ndërkombëtare nuk është shumë i gjerë, por për shkak se Qeveria Shqiptare e ka tejkaluar premtimin e dhënë ndaj FMN-së le të ndalojmë pak te kjo pikë.

Sigurisht, përgjigja e pyetjes është fare e thjeshtë, indeksi duhet siguruar atëherë kur të jetë i nevojshëm. Por, të thuash se indeksi nuk është i nevojshëm për sa kohë që Shqipëria mund të sigurojë fonde nga burime të tjera (FMN, BB, BERZH, grante të qeverive të ndryshme) me kosto më të ulët se ajo e tregjeve

ndërkombëtare, nuk është tërësisht e vërtetë. Vlera e indeksit ka lidhje direkte me normën e interesit që kërkohet nga investitorët e huaj mbi një borxh të emetuar pasi ai tregon mundësinë e mosshërbimit të borxhit (riskun e kreditit) të një vendi të caktuar. Edhe në qoftë se një vend kërkon që t'i caktohet një indeks përpara kohës kur do të fillojë emetime të letrave me vlerë në tregjet ndërkombëtare, kosto e vetme për t'u përballuar është pagesa vjetore ndaj kompanisë që e ofron shërbimin. Në rastin kur ky shërbim do të kërkohej pranë njërës prej këtyre kompanive (siç ndodh në vendet fqinje) kostoja nuk do ta kalonte vlerën e 50 mijë dollarëve amerikanë në vit. Ndërkohë, Qeveria Shqiptare do të dinte saktësisht vlerën e indeksit, do të kishte mjaft të qartë hapat që duhen ndërmarrë për ta përmirësuar atë, në mënyrë që kur të vijë koha për të emetuar borxh në tregjet ndërkombëtare të parasë norma e interesit që do të duhej të paguanim të ishte sa më e ulët. Në të vërtetë, parametrat që duhen përmirësuar në mënyrë që të përmirësohet indeksi janë të shumtë.

Parametrat që vlerësohen (rivlerësohen) gjatë procesit të caktimit të indeksit.

Kompanitë mbledhin të dhëna dhe zhvillojnë takime me një numër të konsiderueshëm institucionesh shtetërore dhe institucione joqeveritare. Të dhënat që kërkohen prej tyre gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut të borxhit sovran mund të grupohen si më poshtë:

- Rreziku politik.
- Të ardhurat dhe struktura ekonomike.
- Parashikimet për rritje ekonomike.
- Fleksibiliteti fiskal.
- Borxhi i përgjithshëm i qeverisë.
- Detyrimet dhe shëndeti i sektorit financiar.
- Fleksibiliteti monetar.
- Likuiditeti i jashtëm.
- Borxhi i jashtëm i sektorit publik.
- Borxhi i jashtëm i sektorit privat.

Kompanitë e listimit dhe të renditjes së borxhit, secilën prej këtyre fushave e ndajnë në nëngrupe gjatë analizës së tyre. Sa më të mirë të jenë parametrat në secilën prej këtyre fushave aq më e lartë do të jetë edhe vlera e indeksit dhe, si rrjedhim aq më e ulët norma e interesit që do të duhej të paguanim ndaj investitorëve të huaj, të cilët do të investonin në borxhin e emetuar prej qeverisë tonë.

Shteti Shqiptar deri tani ka plotësuar nevojat për fonde në valutë të huaj për të kryer investime (kryesisht në infrastrukturë rrugore dhe energjitikë) nëpërmjet granteve të ndryshme dhe kredive me terma të zbutur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe qeveri të huaja. Por për herë të parë, në fund të qershorit të këtij viti Qeveria Shqiptare miratoi financimin nëpërmjet një kredie bankare me terma tregtarë të hekurudhës së re Tiranë-Durrës. Pa dashur të argumentojmë mbi kthimin e këtij investimi (megjithëse kredia ka terma tregtarë libor +5 dhe është kundërshtuar nga FMN dhe BB) apo nëse

këto para mund të siguroheshin nga BERZH, BEI apo ndonjë institucion tjetër me terma më të ulët, le ta marrim këtë fakt si dëshmi se Shqipëria tashmë nuk mund të marrë më kredi (ose nuk mund t'i plotësojë të gjitha nevojat) me terma të zbutur.

Sidoqoftë, edhe në qoftë se vendi ynë ka mundësi që për një periudhë të shkurtër të vazhdojë të sigurojë kredi me terma të zbutur, IASHBS duhet të ishte porositur pranë një ose dy kompanive që e ofrojnë këtë shërbim. Arsyet po i radhisim më poshtë:

1) Efekti marketing.

Eshtë arsyeja kryesore për të siguruar IASHBS edhe në qoftë se një vend i caktuar mund të sigurojë financime me terma jotregtare. Aktualisht, Shqipëria është vendi i fundit në Evropë i cili nuk ka një IASHBS. Vendet e rajonit e kanë siguruar një indeks të tillë gjatë 2 viteve të fundit megjithëse edhe ato vazhdojnë të marrin grante dhe kredi me terma të zbutur. Edhe Moldova, vendi më i varfër në Evropë, ka një IASHBS të cilin e ka siguruar vite më parë. Një reklamë çerek faqe në gazetën "Financial Times" kushton 15,456£ ndërkohë që sigurimi i indeksit kushton rreth 50,000 USD në vit, në varësi të specifikave të porosisë. Duket qartë që nga pikëpamja reklamuese kostoja e sigurimit të këtij indeksi është mjaft e justifikueshme. Në qoftë se do të shtojmë këtu edhe problemet në besueshmërinë e të dhënave dhe kohëzgjatjen e shkurtër të serive kohore ekonomiko-financiare shqiptare, një indeks i tillë i besueshëm dhe i pavarur do të shtonte praninë e Shqipërisë në analizat ekonomike e financiare të institucioneve të huaja. Me pak fjalë, do të shtohej një tregues në sytë e investitorëve të huaj dhe do të hidhej hapi i parë drejt pranisë tonë në tregjet ndërkombëtarë të fondeve.

Pas sigurimit fillestar të indeksit, rregullisht çdo vit ose edhe më shpesh me kërkesë të qeverisë bëhet një rivlerësim i tij. Tashmë, vlera e indeksit do të shtohej pasi duke pasur parasysh reformat pozitive të kryera në Shqipëri, indeksi gjatë këtyre viteve do të kishte shënuar rritje dhe të paktën një herë në vit do t'i kishte siguruar Shqipërisë prani në rrjetet globale të lajmeve ekonomiko-financiare të tipit "Moody's rrit indeksin e borxhit të Shqipërisë me një pikë." Pavarësisht faktit nëse Shqipëria të kishte shitur ose jo letra me vlerë në tregjet ndërkombëtare, kjo prani apo reklamë e justifikon mjaft mirë koston e saj.

Për më tepër, do të kishim një tregues të pavarur e të besueshëm nga kompani të huaja private të vlerësimit të punës së qeverisë, në drejtim të besueshmërisë dhe aftësisë financiare të Shtetit Shqiptar për të marrë dhe për të shërbyer kredi të huaja. Një numër institucionesh ndërkombëtare nxjerrin renditje të ndryshme të vendeve në këtë fushë (BERZH dhe banka të tjera investimi) por indeksi i këtyre kompanive (Moody's, Standard & Poors dhe Fitch) është indeksi kryesor për tregjet e huaja ndërkombëtare të fondeve. Puna në drejtim të përmirësimit të këtij indeksi kryesor (reformat në fushat e përrmendura më sipër) do të reflektohej menjëherë edhe në indekset e institucioneve të tjera, pasi nuk është indeksi qëllim në vetvete por reformat

të cilat e përmirësojnë atë dhe si rrjedhojë aftësinë e vërtetë të shtetit tonë për të marrë fonde në tregjet e huaja ndërkombëtare, për t'i përdorur ato në fusha me interes drejt zhvillimit afatgjatë e të qëndrueshëm sidomos në infrastrukturë e më tej.

2) Eksperienca e përfituar gjatë procesit të llogaritjes së indeksit.

Prania në tregje të huaja ndërkombëtare të parasë sjell nevojën për një grup ekspertësh lokalë. Këta specialistë përfshihen gjatë gjithë vitit në analizat dhe sigurimin e informacioneve për agjencitë e listimit si dhe në një të ardhme të afërt, në procesin e emetimit të borxhit (letrave me vlerë) në tregjet e huaja ndërkombëtare, kryesisht nëpërmjet një konsulenti të specializuar në këtë fushë.

3) Historiku i besueshmërisë në shlyerjen e kredive (Credit Worthiness).

Duhet theksuar se indeksi përbën vetëm njërin prej faktorëve që analizohet nga investitorët e huaj gjatë procesit të blerjes së borxhit të një vendi të caktuar. Një faktor tjetër mjaft i rëndësishëm është historiku i shlyerjes së borxheve të vendit. Në rastin kur një vend i caktuar tregohet mjaft i rregullt në shërbimin e borxhit, ai mund të përfitojë kredi me norma më të ulëta se sa normalisht duke konsideruar IASHBS. Paralelizmi më i thjeshtë që mund të bëhet në këtë rast është ai i kartave të kreditit në nivel mikro. Kështu, pas vlerësimit të parë të besueshmërisë së individit në kthimin e borxhit, kompanitë e kartave të kreditit në rast se borxhet shlyhen në kohë rrisin shumën që një individ mund të shpenzojë dhe ulin interesin apo pagesat mbi këtë borxh.

MANGËSITË E INDEKSIT

- Indeksi përcakton vetëm mundësinë e mosshërbimit të borxhit (probability of default). Konkretisht, AAA 5-vjet 0.10 për qind, BBB-5-vjet 3.02 për qind, B 5-vjet 30.23 për qind.
- Testimet e deritanishme statistikore janë të pamjaftueshme (mungesë të dhënash në kohë).
- Nuk është në gjendje të parashikojë kriza (1997-2002, Pakistani, Rusia, Ekuadori, Ukraina, Moldova dhe Argjentina, kriza në Azi (mosshërbim i borxhit në monedhë vendase).

Si përfundim, analiza e mësipërme mbështet tezën se vendi ynë është mjaft prapa në kohë drejt sigurimit të Indeksit të Aftësisë së Shërbimit të Borxhit Sovran. Në qoftë se Shqipëria do ta siguronte tani indeksin, ai do të ishte në bandën Ba2 – B2 (sipas Moody's). Procesi për sigurimin e këtij indeksi zgjat rreth 3 muaj. Ndërkohë, populli shqiptar ka filluar të shërbejë kredinë e parë me terma tregtarë.

BURIME TË KONSULTUARA:

1) www.fitchratings.com
2) www.moodys.com
3) www.stadardandpoors.com
4) www.bis.org
5) Ashok Vir Bhatia - IMF working papers (WP/02/170)
6) Poste elektronike me stafin e kompanive te permendura me siper
7) www.biznesi.com.al
8) www.setimes.com
9) Memorandumi Shtesë i Politikave Ekonomike dhe Financiare

BANKA E SHQIPËRISË NË HARKUN KOHOR PRILL-QERSHOR 2005

Seminari me temë "Testimi i sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut"

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar organizoi në Tiranë një seminar me temë "Testimi i sistemit bankar mbi situatat ekstreme të rrezikut". Qëllimi i organizimit të këtij seminari ishte njohja e punonjësve me përmirësimin e metodave Stress-Test, që kryhen për analizën e sistemit bankar në përgjithësi dhe për banka të veçanta, si edhe njohja me përvojën e vendeve të ndryshme në këtë fushë.

Takimi me Anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Në datën 06.04.2005, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani organizoi një takim pune me anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë takim, u prezantuan vlerësimet e Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike të vitit 2004, pikëpamjet e bankës për perspektivën e ekonomisë shqiptare, si dhe prezantimi i aspekteve të tjera të rëndësishme të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë në këtë periudhë. Theksi u vu në faktin se Banka e Shqipërisë është një institucion me një rol kyç në fushën e vendimmarrjes së politikave ekonomike dhe financiare, si dhe në drejtim të krijimit dhe të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit.

Mbledhja Vjetore e Pranverës

Në datat 16-17 prill 2005, në Uashington, u zhvillua Mbledhja Vjetore e Pranverës, e organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Në këtë takim merrte pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Guvernator i Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, z. Ardian Fullani, i cili zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, të Federal Reserve, të FSVC dhe të FDIC. Temat e diskutimit ishin zhvillimet më të fundit të ekonomisë shqiptare, me problemet dhe me perspektivën e zhvillimit të vendit, masat që po ndërmerren në drejtim të procesit të integrimit evropian, angazhimi i Bankës së Shqipërisë për reduktimin e *cash*-it në ekonomi dhe përfundimi në kohë i projektit të kleringut të pagesave në shuma të vogla.

Në të gjitha takimet u vlerësua pozitivisht roli i Bankës së Shqipërisë në drejtim të stabilitetit makroekonomik si dhe hapat e ndërmarrë prej saj për konsolidimin dhe zhvillimin e sektorit bankar financiar. Nga përfaqësuesit e lartë të institucioneve të mësipërme u shpreh gatishmëria për të asistuar dhe për të ndihmuar më tej në të ardhmen Bankën e Shqipërisë me projekte si edhe me asistencë teknike.

Gjatë zhvillimit të Mbledhjes së Pranverës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë së bashku me Ministrin e Financave, z. Arben Malaj dhanë një intervistë të përbashkët, e cila u pasqyrua në gazetën e njohur "Financial Times".

Zgjidhet anëtari i nëntë i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

Në datën 21.04.2005, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi me vendimin nr. 182 "Zgjedhjen e zotit Adrian Civici anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, z. Adrian Civici emërohet në këtë detyë në vend të zotit Andis Harasani, i cili ka dhënë dorëheqjen.

Mbi takimet me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane

Në datat 20-21 prill, një delegacion i Bankës Qendrore Evropiane vizitoi Bankën e Shqipërisë. Kjo vizitë zhvillohet në kuadrin e nxitjes së marrëdhënieve midis Bankës Qendore Evropiane dhe bankave qendrore të Evropës Juglindore. Qëllimi i takimeve ishte prezantimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet më të fundit në sistemin financiar dhe bankar, si dhe vendosja e kontakteve për fillimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve. Në këtë kuadër, u fol edhe për nismën e Bankës së Shqipërisë për organizimin dhe mbajtjen e forumit të hapur "Qeverisja e Bankës Qendrore", që do të mbahet në fillim të dhjetorit 2005, për të cilin Banka Qendrore Evropiane do të ofrojë asistencën e saj.

Takim me Komisionerin e Çështjeve Ekonomike dhe Monetare në Komisionin Evropian

Në datë 25 prill 2005, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim pune me z. Joaquin Almunia, Komisioner i Çështjeve Ekonomike dhe Monetare në Komisionin Evropian, në Bruksel. Takimi u përqendrua kryesisht në sfidat me të cilat përballet Shqipëria në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit dhe në veçanti, në rolin dhe kontributin e Bankës së Shqipërisë në këtë proces.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në Fushën e Mbikëqyrjes Bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Malit të Zi

Në datën 27 prill 2005, në mjediset e Bankës së Shqipërisë në Tiranë, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit në Fushën e Mbikëqyrjes Bankare midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Qendrore të Malit të Zi. Ky memorandum përfaqëson një dokument me parimet mbi të cilat këto dy institucione mund të ndërtojnë marrëdhëniet e tyre, në drejtim të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit rreth situatës së sistemeve bankare në vendet përkatëse. Këto parime do të zbatohen në funksion të legjislacioneve përkatëse në Shqipëri dhe në Malin e Zi. Kjo marrëveshje hap rrugën për një bashkëpunim dypalësh në fushën e mbikëqyrjes (dhe në fusha të tjera), si edhe në trajtimin e përbashkët të rasteve të bashkëpunimit midis sistemeve bankare respektive.

Vizitë pune në Bundesbank

Gjatë javës së parë të muajit maj 2005, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani zhvilloi një vizitë pune në Bankën Qendrore të Gjermanisë. Në takimin me Guvernatorin e Bankës Qendrore, Prof. Weber, biseda u përqendrua kryesisht mbi zhvillimet e tregut financiar dhe bankar në vend, si dhe mbi arritjet e Bankës së Shqipërisë në këtë kuadër. Prof. Weber u shpreh se Shqipëria është një vend, që ka bërë progres në reformat ekonomike dhe ato të zhvillimit bankar në veçanti, por ka akoma për të bërë në reformat strukturore. Ndër të tjera ai shprehu edhe angazhimin, që në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane dhe Komisionin Evropian, të mbështesë këto zhvillime, duke u konsideruar një partner potencial afatgjatë.

Intervistë e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhënë Agjencisë See-News

Në datën 9 maj 2005, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani dha një intervistë për agjencinë bullgare të lajmeve See-News. Guvernatori iu përgjigj interesimit të kësaj agjencie të huaj për zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare dhe në veçanti në sistemin bankar.

Konferenca e 33-të ekonomike e Bankës Kombëtare të Austrisë

Në datat 12-13 maj 2005, Banka Kombëtare e Austrisë organizoi Konferencën e saj të 33-të me temë "Politika monetare dhe stabiliteti financiar", në të cilën ishte i ftuar dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani. Gjatë qëndrimit në Vjenë, z. Fullani zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të lartë të institucioneve financiare austriake. Zyrtarët më të lartë austriakë, midis të cilëve edhe Guvernatori i Bankës Kombëtare të Austrisë, z. Klaus Liebscher, u shprehën të gatshëm për të ndihmuar dhe asistuar Bankën e Shqipërisë në procesin reformues të saj.

Mbledhja Vjetore e BERZH

Në datat 22-23 maj 2005, u zhvillua mbledhja vjetore e BERZH-it në Beograd, me temë "Ndërtimi i urave dhe nxitja e prosperitetit", në të cilën ishte i pranishëm dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani. Në prezantimin dhe promovimin e Shqipërisë, Guvernatori Fullani foli rreth zhvillimeve dhe konsolidimit të sistemit bankar, si edhe për rëndësinë e integrimit dhe të bashkëpunimit rajonal. Gjatë qëndrimit në Beograd, z. Fullani zhvilloi një sërë takimesh me guvernatorë të vendeve të Rajonit, tema më e rëndësishme e diskutimit të të cilave ishte rritja e bashkëpunimit si një faktor i rëndësishëm në rrugën e përbashkët drejt integrimit evropian.

Mbledhja Vjetore e Klubit të Guvernatorëve

Në datat 26 – 29 maj 2005, në Shën Peterburg, u zhvillua takimi i radhës së Klubit të Guvernatorëve. Klubi është një nismë, që mbledh rregullisht guvernatorët e 16 bankave qendrore për të diskutuar rreth problemeve të ndryshme, si dhe për të prezantuar idetë dhe eksperiencat e vendeve që ata përfaqësojnë. Në këtë takim të radhës merrte pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani. E veçanta e kësaj mbledhjeje konsiston në takimin informal që u realizua midis pesë guvernatorëve të rajonit, ku u diskutua edhe ideja e z. Fullani për krijimin e një Klubi të Guvernatorëve të Vendeve të Evropës Juglindore.

Mbledhja Vjetore e Bankës për Tregti dhe Zhvillim e Detit të Zi

Në datën 6 qershor 2005 u zhvillua Mbledhja Vjetore e Bankës për Tregti dhe Zhvillim e Detit të Zi, në Yerevan, Armeni. Në këtë mbledhje merrte pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z Ardian Fullani, i cili mbajti një diskutim mbi gjendjen aktuale të sistemeve financiare të vendeve të Evropës Juglindore.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Komisionit të Letrave me Vlerë, në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes financiare

Në datën 2 qershor 2005, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis autoriteteve të përmendura. Zhvillimet aktuale të tregut si dhe shfaqja e elementeve që kërkojnë mbikëqyrje të kujdesshme, sollën në rendin e ditës hartimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja krijon mundësi reale që brenda kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullativ përkatës, institucionet nënshkruese të rrisin

bashkëpunimin në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe të ekspertizës, të koordinimit më të mirë në veprimtarinë mbikëqyrëse.

Seminari me temë "Bankat dhe roli i tyre në luftën kundër pastrimit të parave"

